

INSTITUTI PËR DEMOKRACI DHE NDËRMJETËSIM

---

**KONTROLI DEMOKRATIK DHE MARRËDHËNIET CIVILO-USHTARAKE**  
- NJË ÇËSHTJE E PAPËRFUNDUAR -



INSTITUTI PËR DEMOKRACI DHE NDËRMJETËSIM

**KONTROLI DEMOKRATIK  
DHE MARRËDHËNIET CIVILO-USHTARAKE  
- NJË ÇËSHTJE E PAPËRFUNDUAR -**

*Botimi pasqyron punimet e konferencës kombëtare “Kontrolli Demokratik dhe Marrëdhëniet Civilo-Ushtarake: Një çështje e papërfunduar” të organizuar nga Qendra për Çështje Europiane dhe te Sigurisë (pranë Institutit për Demokraci dhe Ndërmjetësim), më 20-21 nëntor 2009.*

*Anketimet dhe punimet e konferencës u mbështetën nga DCAF (Qendra e Gjenevës për Kontrollin Demokratik të Forcave të Armatosura), si dhe nga FES (Friedrich Ebert Stiftung)*

*Publikimi i këtij botimi u mundësua nga Friedrich Ebert Stiftung*

Botimi ne gjuhën shqipe përmbledh të gjitha diskutimet dhe studimet e realizuara në lidhje me këtë konferencë, ndërsa në anglisht janë përfshirë vetëm studimet dhe raportet e çdo paneli të konferencës.

IDN falënderon DCAF dhe FES për mbështetjen dhe partneritetin.

IDN falënderon, njëkohësisht, një numër ekspertësh të lartë që u konsultuan në hartimin e pyetësorëve dhe problematikës së aktivitetit.

Redaktuan:  
Sotiraq Hroni  
Gjergji Vurmo

Përgatiti materialet për botim:  
Mariola Qesaraku

Ndihmuan në përgatitje:  
Marsida Bandilli  
Bruna Bardhaj  
Besiana Kuçi

Korrektore letrare:  
Majlinda Toçi

Përkthimi në anglisht:  
Urita Dokle



## PËRMBAJTJA

<b>I. Fjalimet përshëndetëse .....</b>	<b>7</b>
SOTIRAQ HRONI (DREJTOR EKZEKUTIV I IDN-së) .....	7
ARBEN IMAMI (MINISTËR I MBROJTJES I SHQIPËRISË) .....	12
PANDELI MAJKO (ish-MINISTËR I MBROJTJES I SHQIPËRISË) .....	14
BARD B. KNUDSEN (EKSPERT I LARTË I DCAF-së - QENDRA E GJENEVËS PËR KONTROLLIN DEMOKRATIK TË FORCAVE TË ARMATOSURA) .....	16
<b>II. Cili është përgjegjësi për Sigurinë dhe Forcat e Armatosura: Sfidat për rolet dhe përgjegjësitë për menaxhimin e sigurisë dhe mbrojtjes (konteksti i (jo)sukseseve konstitucionale, mësimet e nxjerra dhe idetë për sfidat e ardhshme).....</b>	<b>19</b>
<b>PANELI I</b>	
Prof. Dr. REXHEP MEIDANI (ish-PRESIDENT I SHQIPËRISË) .....	19
Gjen. Brig. MAKSIM MALAJ (SHEF I SHTABIT TË PËRGJITHSHËM I FORCAVE TË ARMATOSURA) .....	38
ARIAN DYRMISHI (EKSPERT I LARTË I IDN-së) .....	45
<b>III. Sfidat për një kontroll efektiv demokratik dhe mbikëqyrja parlamentare në sektorin e mbrojtjes .....</b>	<b>66</b>
<b>PANELI II</b>	
LEONARD DEMI (KRYETAR I KOMISIONIT PARLAMENTAR I SIGURISË KOMBËTARE) .....	66
WALTER KOLBOW (ISH-ANËTAR I PARLAMENTIT DHE ISH-ZËVENDËSMINISTËR I MBROJTJES SË GJERMANISË) .....	74
ARIAN DYRMISHI (EKSPERT I LARTË I IDN-së) .....	
<b>IV. Transparenca dhe hapja ndaj shoqërisë (roli i shoqërisë civile, medias, akademikëve).....</b>	<b>89</b>

**PANELI III**

ENRI HIDE (KËRKUES SMN, LEKTOR NË UET) .....	89
Dr. SIMON GEGA .....	106
BESART LIKMETA (GAZETAR SMN) .....	113

**V. Praktikrat më të mira ndërkombëtare, Forcat e Armatosura Shqiptare dhe kontrolli civil: raport mbi situatën aktuale .....** 115

**PANELI IV**

BARD B. KNUDSEN (EKSPERT I LARTË I DCAF-së) .....	115
GJERGJI VURMO (IDN) .....	

**VI. Konkluzione dhe rezultate .....** 135

**PANELI V**

ARIAN DYRMISHI: Raport i Panelit "Cili është përgjegjësi për sigurinë dhe Forcat e Armatosura: Sfidat për rolet dhe përgjegjësitë për menaxhimin e sigurisë dhe mbrojtjes" (Konteksti i (jo)sukseseve konstitucionale, mësimet e nxjerra dhe idetë për sfidat e ardhshme) .....	135
GJERGJI VURMO: Raport i Panelit "Sfidat për një kontroll efektiv demokratik dhe mbikëqyrja parlamentare në sektorin e mbrojtjes" .....	139
GERON KAMBERI: Raport i Panelit "Transparenca dhe hapja ndaj shoqërisë (roli i shoqërisë civile, medias, akademikëve)" .....	142
DR. ARSHI ÇELA: Raport i Panelit "Perceptimet e përfaqësuesve të Forcave të Armatosura dhe Ministrisë së Mbrojtjes mbi marrëdhëniet civilo-ushtarake" .....	146
Kol. JERONIM BAZO: Koment për panelin II: "Cili është përgjegjësi për sigurinë dhe forcat e armatosura: Sfidat për rolet dhe përgjegjësitë për menaxhimin e sigurisë dhe mbrojtjes" (Konteksti i (jo)sukseseve konstitucionale, mësimet e nxjerra dhe idetë për sfidat e ardhshme) .....	149

# I

## Fjalimet përshëndetëse

### SOTIRAQ HRONI

(DREJTOR EKZEKUTIV I IDN-së)

## A JANË ME TË VËRTETË MARRËDHËNIET CIVILO-USHTARAKE NJË ÇËSHTJE E PAPËRFUNDUAR?

(Nga fjala gjatë punimeve të Konferencës Kombëtare  
mbi Marrëdhëniet Civilo-Ushtarake).

Pikësëpari, dëshiroj t'ju falënderoj që pranuat të jeni sot të pranishëm, por edhe kontribuues në këtë Konferencë Kombëtare mbi Marrëdhëniet Civilo-Ushtarake, një çështje kjo, që mendoj, se meriton një vëmendje në rritje nga aktorët institucionalë të interesuar për mirëqeverisjen në sektorin e sigurisë dhe konkretisht në fushën e mbrojtjes.

Prania e drejtuesve të lartë të institucioneve, por edhe komentet e dëgjuara nga aktorët e interesuar dhe të përfshirë në punën përgatitore të kësaj Konference, mendoj se dëshmojnë përgjegjshmëri për një ecuri më të mirë të problematikës së marrëdhënieve civilo-ushtarake. Njëkohësisht kjo dëshmon një qëndrim mbizotërues se anëtarësimi i Shqipërisë në NATO nuk është thjesht realizimi i një objekti, por fillimi i një procesi për një pjekuri më të madhe demokratike për reformimin dhe funksionimin demokratik e transparent të qeverisjes edhe në këtë sektor.

Arsyeja pse Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim, e më konkretisht Qendra për Çështje Europiane dhe të Sigurisë pranë kësaj organizate ndërmori këtë iniciativë për të rithirrur një Konferencë Kombëtare mbi këtë problematikë është e shumëfishtë. Në media dhe shtypin e përditshëm janë transmetuar apo publikuar deklarime të ndryshme në mënyrë të veçantë pas ngjarjes së Gërdecit që kapin të gjithë komponentët përbërës të marrëdhënieve civilo-ushtarake duke lënë të kuptohet se ende ka shumë për të bërë për të rregulluar këto raporte në të gjitha planet e tyre. Më konkretisht, pikënisje për këtë projekt u bë një letër e dhjetorit 2007 drejtuar Kryeministrit të vendit nga ana e ish-Shefit të Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura botuar në “Gazetën Shqiptare”, më 21 maj 2009. Analiza e kësaj letre në njëfarë mënyre ngrinte një sërë problemesh që më vonë do të mbushnin faqet e shtypit pas tragjedisë së Gërdecit dhe do të vazhdojnë të trajtohen për aq kohë sa çështja e ushtarakëve të thirrur nga Prokuroria ende nuk është mbyllur nga një proces gjyqësor. Aq më tepër, që në shtyp nuk kanë munguar edhe shkrime të tjera që kapin kompetencat e emërimeve në Forcat e Armatosura.

Një arsye tjetër për këtë sipërmarrje mbetet edhe qasja jonë drejt problematikës. Për ne si organizatorë, por edhe për partnerët në mënyrë të veçantë për Qendrën e Gjenevës për Kontrollin Demokratik të Forcave të Armatosura (DCAF) inicimi dhe realizmi me sukses i kësaj konference për t’i shërbyer qëllimit dhe për të ndihmuar në analizën e situatës e përmirësimin e gjendjes është mbështetur në domosdoshmërinë e njohjes së gjendjes reale dhe në mënyrë sa më objektive. Pikërisht, përmes njohjes së problematikës dhe prezantimit të praktikave më të mira europiane synohet të nxitet një proces diskutimi publik apo institucional për hapa të mëtejshëm që do t’i shërbenin konsolidimit të qeverisjes së mirë në sektorin e sigurisë.

Prandaj, çdo panel i kësaj konference dyditore përpiqet të nxisë diskutime mbështetur në arritjet apo mosarritjet e viteve të fundit duke iu referuar veçmas çdo komponenti përbërës të praktikës më të mirë europiane në Teorinë e Marrëdhënieve Civilo-Ushtarake. Pra, një e veçantë tjetër e këtij aktiviteti është se sikundër asnjëherë më parë diskutimet nuk do të jenë thjesht teorike apo të praktikës së mirë, e cila megjithatë nuk do të mungojë. Çdo panel i këtij aktiviteti mbështetet



mbi një punë studimore, sondazh apo anketim për të bërë një vlerësim të situatës aktuale për çdo problematikë, e për të orientuar reflektime të mëtejshme.

Kjo konferencë, mendoj se, përmes gjetjeve dhe diskutimeve, do të sensibilizojë se çështjet e kontrollit demokratik mbi Forcat e Armatosura dhe marrëdhëniet civilo-ushtarake janë në themel të ngritjes dhe marrjes së përgjegjësive për rregullime të nevojshme të praktikës apo legjislacionit për një qeverisje që ndihmon forcimin dhe konsolidimin institucional.

Botimi në një libër të veçantë i gjetjeve të studimeve të realizuara nga grupi i ekspertëve të pavarur pranë Institutit për Demokraci dhe Ndërmjetësim dëshmon jo vetëm një prirje për një evidentim rastësor të problematikës, por edhe një bazë të qëndrueshme për reflektime të mëtejshme dhe të vazhdueshme si dhe një shtysë për të përmirësuar gjendjen duke iu referuar të gjithë komponentëve të një qasje holistike të marrëdhënieve civilo-ushtarake. Panelet e këtij aktiviteti përfshijnë prezantime dhe diskutime mbi:

Së pari, kontekstin ligjor e kushtetues në të cilin mbështetet, rregullohet aktiviteti i Forcave të Armatosura, ku realiteti i ri i vendit si anëtar i Aleancës së Atlantikut të Veriut dhe detyrimet ndërkombëtare në këtë kuadër mund të kërkojnë një rishikim të bazës ligjore. Për më tepër, që ky panel synon gjithashtu të rishikojë dhe të nxisë debatin mbi efektshmërinë e dispozitave kushtetuese në lidhje me Këshillin e Sigurisë Kombëtare dhe rolin e tij në qeverisjen në sektorin e sigurisë dhe veçanërisht në fushën e mbrojtjes.

Së dyti, një çështje thelbësore për përmirësimin e qeverisjes në sektorin e sigurisë në një demokraci parlamentare është kontrolli demokratik dhe mbikëqyrja parlamentare mbi institucionet dhe qeverisjen e sektorit të sigurisë. Më poshtë në këtë botim në shqip dhe anglisht ndodhen rezultatet e një anketimi të zhvilluar për herë të parë me një masë më se të konsiderueshme të anëtarëve të Komisionit Parlamentar të Sigurisë Kombëtare të periudhës 2001-2009. Në këtë fjalë hyrëse të botimit në lidhje me këtë çështje do të doja vetëm të përmendja faktin se rezultatet e anketimit duhet të shihen vetëm pozitivisht nga çdo anëtar i këtij Komisioni, sepse në thelb, pikënisja jonë nuk ka qenë evidentimi i mangësive, por evidentimi i problemeve

dhe sensibiliteti për to me qëllim që të përmirësohet, forcohet dhe evidentohet gjithmonë e më tepër roli i Parlamentit dhe posaçërisht i këtij Komisioni të rëndësishëm në jetën politike e publike të vendit për kontrollin demokratik e mbikëqyrjen parlamentare ndaj institucioneve të sigurisë, në këtë rast në fushën e mbrojtjes.

Objektivi i anketimit ishte relativisht i gjerë dhe mendoj se çështjet e tij duhet t'i nënshtrohen një diskutimi të ftohtë për të arritur standarde sa më demokratike e efikase në zbatim të Kushtetutës dhe ligjit. Për të dëshmuar se vullneti ynë ishte vetëm pozitiv, ne si organizatorë nuk përfshimë në anketim pyetje të tilla që gjithsesi do të ishin logjike dhe me vend: “A ka përgjegjësi morale Parlamenti, posaçërisht Komisioni Parlamentar i Sigurisë Kombëtare për gjithë problematikën që ka shoqëruar tërësinë e shkaqeve dhe faktorëve që dolën në publik dhe media pas ngjarjes së Gërdecit?”

Megjithatë, pa iu përgjigjur kësaj pyetje, vlen të falënderohen gjithë deputetët e legjislaturave që u përfshinë në këtë anketim, përfshirë dhe kryetarin e këtij Komisioni, zotin Leonard Demi. Kjo dëshmon përgjegjshmëri për t'u ballafaquar me arritjet dhe sfidat për të ardhmen.

Çështja e tretë, por nga më të rëndësishmet e kësaj Konference, ishte anketimi, i zhvilluar sërish për herë të parë në vendin tonë, brenda institucioneve të Ministrisë së Mbrojtjes dhe Forcave të Armatosura për marrëdhëniet civilo-ushtarake. Me gjithë arritjet dhe standardet e vendosura edhe për shkak të të cilave vendi ynë është anëtar i NATO-s, problemet aty janë evidente dhe justifikimin më të mirë e gjejnë në pjesën e dytë të vetë titullit të këtij botimi “Marrëdhëniet civilo-ushtarake - *Një çështje e papërfunduar*”. Pritshmëria jonë si organizatorë është që rezultatet e anketimit të realizuar me këtë rast vetëm sa janë bërë publike në Konferencën e datës 20-21 nëntor 2009. Ne kemi bindjen se Presidenti i Republikës, kryeministri, ministri i Mbrojtjes dhe shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, por edhe opozita politike do të gjejnë bonsensin dhe vullnetin për të nxitur diskutimin dhe marrjen e përgjegjësive për të përmirësuar në mënyrë të qëndrueshme problematikën e evidentuar.

Dy problematikat e fundit të marrëdhënieve civilo-ushtarake sipas praktikës më të mirë europiane, e konkretisht raportet e bashkëpunimit

midis Forcave të Armatosura e Ministrisë së Mbrojtjes së pari me shoqërinë civile, median, analistët, qarqet akademike etj., dhe së dyti raportet e tyre me publikun e gjerë u përmbledhën në një panel të kësaj konference. Megjithëse, edhe këtu problematika është evidentuar në dy anketime; respektivisht në pyetësorin e administruar brenda Forcave të Armatosura dhe Ministrisë së Mbrojtjes ku disa pyetje i referoheshin perceptimit mbi rolin e medias e shoqërisë civile, dhe gjetjet janë inkurajuese (vjen në rritje numri i profesionistëve të ushtrisë që kërkojnë partneritetin dhe mbështetjen e aktorëve civilë të pavarur, analistëve etj.) dhe së dyti, në një sondazh të veçantë për perceptimin publik mbi Forcat e Armatosura. Analiza e anketimeve dhe sondazheve të mësipërme duhet bërë me laps në dore, por do të dëshiroja të evidentoja në këto radhë disa probleme të cilat në fakt nuk u analizuan me thellësinë e duhur në diskutimet e Konferencës:

Së pari, me gjithë arritjet ka ende shumë për të bërë për hapjen e Forcave të Armatosura ndaj shoqërisë, dhe për të arritur këtë nuk mjafton informacioni që vjen nga takimet zyrtare apo kronikat me patos të dërgimit të trupave shqiptare në misione në botë, qoftë edhe spotet e veçanta televizive. Profesionin e ushtarakut, megjithëse vendi është anëtar i NATO-s, vështirë se ka ndryshuar në shoqëri. Për më tepër ky profesion ka shumë probleme të brendshme që nuk njihen, që nga pagat, mbështetja sociale e dëshiruar, apo integrimi në shoqëri pas përfundimit të detyrës e shumë të tjera. Madje, edhe vetë ushtarakët janë të ndarë në përgjigjen në atë sesi ka ndikuar ky anëtarësim në Aleancë në moralin e Forcave të Armatosura. Shumë pak gjen profesionistë të ushtrisë në emisione televizive edhe atëherë kur flitet për ushtrinë. Mendoj se edhe publiku i gjerë shumë pak njihet nga ai transformim i qenësishëm i Forcave të Armatosura, aq më pak mund të njihet misioni i tyre pas anëtarësimit. Vështirë se mund të flitet për strategji proaktive të Forcave të Armatosura edhe në komunitetet vendore ku operohet kudo në vend. Pra, përmbledhtazi morali i brendshëm nuk ka arritur një pikë të tillë që të drejtonte vetë ushtrinë për një hapje më të madhe drejt shoqërisë, për të vepruar dhe për të ndikuar që shoqëria të nderojë e të vlerësojë profesionin e respektuar të ushtarit apo ushtarakut të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë.

Se fundmi, si organizator dëshiroj të falënderoj edhe një herë gjithë partnerët që ndihmuan dhe lehtësuan realizimin me sukses të punës sonë, Komisionin Parlamentar të Sigurisë Kombëtare, ministrin e Mbrojtjes dhe shefin e Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, qoftë për realizimin e studimeve tona të sipërpërmendura, qoftë edhe për praninë dhe fjalën e tyre në këtë aktivitet.

Njëkohësisht, dëshiroj të falënderoj Qendrën e Gjenezës për Kontrollin Demokratik të Forcave të Armatosura për mbështetjen dhe partneritetin afatgjatë me IDN-në, bashkëpunim që vazhdon të jetë i mirëpritur nga institucionet e vendit për ndihmesën në reformat në sektorin e sigurisë, sikundër edhe fondacionin gjerman “Friedrich Ebert Stiftung” për mbështetjen në realizimin e kësaj konference dhe këtij botimi, por edhe për mundësimin e pjesëmarrjes në këtë aktivitet të zotit Kolbow (ish-nënkryetar i Grupit Parlamentar Social-Demokrat dhe ish zëvendësministër i Mbrojtjes së Gjermanisë).

Shpresa jonë, si iniciues dhe realizues së bashku me mbështetësit e kësaj Konference dhe të këtij botimi, është që të kontribuohet sadopak, që të reflektohet në atë që vendimet për reforma të jenë sa më të studiara e sa më të mirinformuara, që institucionet të gjejnë vendin e tyre dhe të luajnë rolin e tyre për mirëqeverisjen në dobi të interesave më të qëndrueshme të qytetarëve shqiptarë.

## **ARBEN IMAMI**

**(MINISTËR I MBROJTJES I SHQIPËRISË)**

Kjo konferencë është shumë e rëndësishme, veçanërisht për momentin që po kalojnë Forcat tona të Armatosura, për shkak të ndryshimeve të mëdha që kanë ndodhur brenda kësaj Force në 20 vitet e fundit dhe që në një masë të madhe nuk janë të njohura për publikun e gjerë. Një raport i mirë midis Forcave të Armatosura dhe publikut në tërësinë e tij do të bënte të mundur që publiku të kishte një perceptim më të mirë, më të qartë, më të plotë dhe më të drejtë mbi gjendjen në të

cilën janë Forcat tona të Armatosura, me detyrat që ato faktikisht kryejnë, mbi nivelin e punës së tyre, të operacioneve ku ato marrin pjesë dhe, në veçanti, të rëndësisë që kanë Forcat tona të Armatosura në kuadrin e Aleancës dhe në këtë kuptim për sigurinë e vendit dhe më gjerësisht për politikën e jashtme të këtij vendi.

Marrëdhëniet civilo-ushtarake janë një koncept thuajse i ri për Forcat e Armatosura shqiptare, në fakt ato kërkojnë krijimin e një fryme bashkëpunimi, shkëmbimi dhe besimi midis Forcave të Armatosura dhe publikut. E vërteta është se edhe për NATO-n ka një qasje të re ndaj këtyre marrëdhënieve, veçanërisht në kuadër të angazhimit në misionet ndërkombëtare. Forcat tona duhet të ndjekin këto dinamika zhvillimi në mënyrë që të aftësohen për të kryer operacione jo vetëm thjesht militare, por edhe civile dhe rasti më i fundit i kësaj domosdoshmërie është Afganistani, ku Aleanca e ka përshtatur strategjinë e saj duke gërshetuar elementët ushtarakë me ato civilë.

Shqipëria po merr disa angazhime në kuadër të Aleancës në Afganistan. Përveç aspekteve ushtarake, ku ne kemi dy kompani dhe oficerë në shtabe të ndryshme, këto ditë niset edhe një skuadër mjekësore me 20-22 mjekë dhe infermierë, do të kontribuojmë për ndërtimin e disa shkollave, do të japim bursa për disa studentë afganë, po mendojmë që të ngremë disa kapacitete speciale të ushtrisë që të ndihmojnë në rikonstruksionin e përkohshëm aty ku është edhe fusha e luftimit, gjë e cila rrit besimin dhe krijon marrëdhënie midis ushtrisë dhe popullsisë civile atje.

Ushtarakët duhet të bashkëpunojnë me stafet civile, me institucionet e shoqërisë civile, me mediat dhe me çdo organizëm civil që do të mund të kontribuonte për ndërtimin e një imazhi civil për Forcat e Armatosura, për shkak së Çështjet e Sigurisë nuk janë thjesht dhe vetëm ushtarake, por më gjithëpërfshirëse dhe kanë nevojë edhe për ekspertizë në të gjitha fushat. Nga ana tjetër Forcat tona të Armatosura duhet të afrohen më shumë me komunitetin lokal, përfaqësuesit e Forcave të Armatosura duhet të jenë më shumë prezentë në problemet komunitare, ushtarakët nuk duhet të shikohen, po themi, si të ndryshëm përkundrejt civilëve, por si një pjesë e rëndësishme që kryejnë një funksion të rëndësishëm për shoqërinë shqiptare.

## PANDELI MAJKO

(ish-MINISTËR I MBROJTJES I SHQIPËRISË)

Në marrëdhëniet civilo-ushtarake ose si na pëlqen ne njerëzve të politikës t'i quajmë me shprehjen standard të “kontrollit demokratik të Forcave të Armatosura”, qëndron një nga krizat e fshehura të mbarëvajtjes thelbësore të fushës së sigurisë kombëtare në Shqipëri.

Vendi ynë vjen nga një e kaluar totalitare me një ushtri të madhe, por pa dyshim edhe me një histori traumatike, pjesë e një shoqërie që njëjthe vetëm një piramidë vendimmarrjeje, e cila buronte ekskluzivisht nga politika dhe vetëm ajo. Deri në vitet '90 piramida ushtarake ka ekzistuar vetëm si funksion, por jo si gradë. Emërimet kanë ardhur nga politika dhe shijet e saj.

Kam dëgjuar me vëmendje gjithmonë diskutimet për kontrollin demokratik të Forcave të Armatosura nga interesat civile të shoqërisë, por nuk mund të mos ngre pyetjen e njohur se çfarë ka lënë politika shqiptare deri më sot pa kontrolluar në ushtrinë e vendit qysh nga dita e krijimit të saj(?!). Për arsye të mirëkuptuara historike, strukturat militare në Shqipëri dhe gjuha e forcës kanë prodhuar pushtet për politikën dhe shpesh kanë qenë baza morale e saj në terrenin shqiptar.

Në shoqërinë komuniste, sektori i sigurisë kombëtare u sfidua nga forcimi i linjës së Inteligjencës ose nga emri i Sigurimit të Shtetit me karakteristika të një urdhri fanatik fetar, i vetmi që regjimi i njëjthe logjikën e veprimit pa kufizime ligjore.

Fillimi i historisë së re të demokracisë në Shqipëri ishte një ndërmarrje e paprecedentë për reformimin e një Force të Armatosur ku nuk ekzistonte kultura e gradës dhe ku izolimi e politizimi kishte lënë gjurmë më të thella se në çdo sektor tjetër të shoqërisë shqiptare.

Do të doja të thosha sot se ndërrimi i pushtetit politik nga Zogu te Noli dhe anasjelltas dhe goditja e të ashtuquajturit “grupi armiqësor i ushtrisë” në vitet '70 mbeten precedentët ekstremë të implikimit të fortë të kontrollit të politikës mbi Forcat e Armatosura, por ja që nuk është ashtu.

Vitet e asaj që ne politikanët e quajmë periudha e demokracisë pa dyshim kanë ofruar të tjera fenomene të ndryshme, por që në thelb

ruajnë konstanten e ndërhyrjes së interesave politike në sektorin e sigurisë kombëtare dhe specifikisht në Forcat e Armatosura. Nëse do të donim “piketat” më të dukshme të kësaj historie që nuk ka filluar, sot do të mjaftonte të shikonim rrugëtimin e saj në emërimet dhe largimet e shefave të Shtabit të Përgjithshëm në vite. Ajo për fat të keq qëndron si provë e mëkatit tonë, të politikës dhe njerëzve të saj, ndaj një shtrese sociale si ajo e ushtarakëve që me gjithë të metat e veta mbetet një nga më pak të prekurat nga sëmundjet e kohës që jetojmë.

Për arsyet që vinë nga cilësi të brendshme të Forcave tona të Armatosura të Shqipërisë, ato nuk do përbëjnë subjekt të ndikimit jokushtetues në shoqërinë e nesërme shqiptare. Mendoj se, megjithatë, ka ende vend që të diskutohet për integrimin më të mirë të ushtarakëve në shoqëri dhe nxitjen e përcaktimit që lidh trajtimin e kësaj strukture me kontrollin e saj nga interesat civile në respekt të vlerave dhe institucioneve demokratike.

Nuk besoj se jam teorik duke thënë se mirëqeverisja përfshin edhe rrënjosjen në Forcat e Armatosura të vlerave të shërbimit të publikut dhe të etikës së bindjes ndaj sundimit të ligjit, të respektimit të kushtetutës dhe institucioneve kombëtare. Betimi i ushtarakut është ndërkaq “asnjanës” ndaj qeverisjes. Mbikëqyrja civile duhet, më në fund, të përfshijë vetëdijen për natyrën e përpiktë të betimit ushtarak dhe të asaj çfarë duhet bërë për të siguruar zbatimin e saj.

Ashtu si dhe në vendet e tjera anëtare të NATO-s ushtarakët shqiptarë janë “të rrethuar” nga një varg aktesh ligjore dhe nënligjore, të cilat kufizojnë të drejtat e tyre nëse kjo kërkohet nga detyra të caktuara ushtarake. Mendoj se ka ardhur koha që t’u legalizojmë “të urdhëruarve” ushtarakë në mënyrë më të qartë mosbindjen ndaj urdhrave të kundraligjshëm dhe fyes. Kontrolli demokratik nuk nënkupton veç sjelljen ligjore të ushtarakut, por edhe të urdhërdhënësit. Kjo do të nënkuptonte në çdo rast se asnjë ushtarak nuk mund t’i justifikojë veprimet e veta duke cituar një urdhër, që do të thotë se vetë ushtarakët janë individualisht përgjegjës për veprimet e tyre edhe kur kanë marrë urdhër nga eprorët.

Udhëheqja ushtarake duhet të inkurajohet në mënyrë ligjore që të bëjë të ditur edhe publikisht se urdhrat ose veprimet jodemokratike,

antikushtetuese ose jokushtetuese ndaj ushtarakëve janë të palejueshme.

Të mos harrojmë se pas uniformës të çdo ushtaraku jeton një civil nën betim. Ushtarakët janë njerëzit më guximtarë dhe më të mirë që shteti shqiptar ka në shërbimin e tij, kontrolli civil i të cilëve duhet të fillojë me respektin ndaj tyre dhe misionit që kryejnë.

## **BARD B. KNUDSEN**

(EKSPERT I LARTË I DCAF-së -

QENDRA E GJENEVËS PËR KONTROLLIN DEMOKRATIK TË FORCAVE TË ARMATOSURA)

Më lejoni fillimisht të them se jam shumë i nderuar që ndodhem sot këtu. Tema e konferencës është e rëndësishme dhe kjo është vizita ime e parë në Shqipëri. Gjatë 25 vitesh shërbim në Ministrinë e Mbrojtjes në Norvegji, kam udhëtuar në shumë vende dhe jam marrë me çështje të llojeve të ndryshme. Megjithatë, nuk kam pasur marrëdhënie me vendet e Ballkanit Perëndimor, para se të bëhesha pjesë e DCAF-it një vit më parë. Për mua kjo ka qenë një eksperiencë e çmuar. Më lejoni gjithashtu që t'ju uroj mirëseardhjen, në emër të DCAF-it, si një bashkorganizues i kësaj konference.

Vërejtjet e mia të para do të fokusohen në disa çështje kyçe. Për të vajtur drejt e në temë: Kontrolli demokratik mbi Forcat e Armatosura të një vendi është thelbësor. Ajo është një pjesë integrale dhe shumë e rëndësishme e një qeverisje të mirë të sektorit të sigurisë. Premisat themelore për këtë mund të përmbliidhen në dy parime të thjeshta:

1) Në një vend demokratik, njerëzit janë burimi i legjitimuar i pushtetit. Rrjedhimisht, qeveria e një vendi demokratik është përgjegjëse para njerëzve, nëpërmjet zgjedhjeve si dhe përgjegjëse para përfaqësuesve të zgjedhur të njerëzve - Parlamentit ose Asamblesë Kombëtare. Kjo sigurisht që zbatohet edhe në sektorin e sigurisë, duke përfshirë edhe mbikëqyrjen demokratike mbi Forcat e Armatosura.

2) Forcat e Armatosura janë një instrument i politikës së sigurisë.



Kjo nënkupton që Forcat e Armatosura duhet t'i nënshtrohen udhëheqjes politike civile. Forcat e Armatosura nuk duhet që të ndjekin politikat e tyre të veçanta apo të veprojnë në mënyrë të pavarur si një "shtet brenda shtetit".

Ekzistojnë ndryshime të konsiderueshme në qeverisjen e sektorit të sigurisë midis vendeve - si në Europë, ashtu edhe më gjerë. Këto ndryshime janë rrjedhojë e mungesës së ngjashmërisë në historinë, kulturën, traditën politike si dhe në sistemin kushtetues në secilin prej vendeve. Por, marrëdhëniet civilo-ushtarake përfshijnë shumë më tepër se thjesht kontrollin civilo-politik mbi Forcat e Armatosura. Ato përfshijnë gjithashtu hapjen dhe transparencën. Përfshin jo vetëm institucionet qeveritare, por edhe shoqërinë civile. Cili është pra atëherë, përcaktimi i "shoqërisë civile"? Shoqëria civile përfshin të gjitha ato institucione, organizata qeveritare dhe grupe korporative, që janë më të vogla se shteti, por më të mëdha se familja. Shoqëria civile i referohet sferës së veprimit kolektiv të padetyrueshëm, rreth vlerave, interesave dhe qëllimeve të përbashkëta. Shoqëria civile, në një demokraci, konsiston gjithashtu edhe te qytetarët e interesuar. Në demokraci njerëzit kanë nevojë të marrin informacion të mjaftueshëm dhe të saktë, me qëllim që të formojnë opinionet e tyre si dhe të marrin vendime të edukuara, për shembull, si votues. Sërish, kjo kërkon hapje dhe transparencë. Për të përmbledhur sa më sipër: Sipas këndvështrimit tim, termat kyç, kur ne flasim mbi kontrollin demokratik dhe marrëdhëniet civilo-ushtarake, janë:

- Përgjegjshmëria
- Hapja
- Transparenca

Për të vënë në jetë këto parime, nuk është gjithmonë e thjeshtë - as në ato që quhen demokraci të vjetra, as në ato "të reja". Ekzistojnë gjithashtu vlerësime tërësisht të legjitimuara që, nën kushte të caktuara, mund të modifikojnë parimet e përgjithshme të hapjes dhe transparencës. Shpesh, hapja *versus* fshehtësisë, është çështja më e vështirë, veçanërisht brenda sektorit të sigurisë në lidhje me çështjet

ushtarake. Gjithashtu, në demokraci, politika e sigurisë duhet që të jetë efektive. Jo çdo gjë mund të botohet në internet apo t'u zbulohet gazetarëve. Përgjegjshmëria, gjithësesi, ngelet e domosdoshme.

Si përfundim, në një demokraci, Forcat e Armatosura, ashtu sikurse edhe agjencitë e tjera të sigurimit, duhet të jenë të përgjegjshme para qeverisë së zgjedhur në mënyrë demokratike dhe qeveria nga ana tjetër, duhet të jetë përgjegjëse para parlamentit, si përfaqësuese e zgjedhur e njerëzve. Në një analizë përfundimtare, si qeveria ashtu edhe parlamenti janë përgjegjëse para njerëzve, përmes zgjedhjeve të hapura dhe demokratike. Këto janë edhe vërejtjet e mia hyrëse. Unë e kam shpjeguar rolin tim, së bashku me vërejtjet e tjera hyrëse, duke u përpjekur të përcaktojë kuadrin themelor për diskutimet mbi çështjet e tjera specifike të axhendës së kësaj konference. Do të flas në mënyrë më të detajuar mbi çështjet e Forcave të Armatosura dhe shoqërinë civile gjatë Seksionit IV.

## II

# *Cili është përgjegjësi për Sigurinë dhe Forcat e Armatosura: Sfidat për rolet dhe përgjegjësitë për menaxhimin e sigurisë dhe mbrojtjes (konteksti i (jo)sukseseve konstitucionale, mësimet e nxjerra dhe idetë për sfidat e ardhshme)*

---

## PANELI I

---

**Prof. Dr. REXHEP MEIDANI**  
(ish-PRESIDENT I SHQIPËRISË)

### KONTROLI CIVIL DEMOKRATIK I FORCAVE TË ARMATOSURA

#### **A. STRUKTURAT E KONTROLLIT CIVIL**

***Krijimi i një sensi urgjence.*** Në fakt, në lidhje me kontrollin civil të FA-së apo, në përgjithësi, të strukturave të sigurisë, kërkohet një rritje interesi e preokupimi, jo vetëm nga institucionet politike, por dhe nga vetë shoqëria civile, sidomos nga OJF-të më të specializuara në këtë fushë. Për më tepër, njerëzit duhet të motivohen për të dalë nga “zona e komfortit” ndaj çështjeve të tilla. Me këtë motivim lidhet, po ashtu, garantimi i kontrollit civil dhe nevoja për ndryshime ligjore e strukturore, konceptore e praktike, në funksionimin e instrumenteve kryesore të këtij kontrolli. Madje, *paqartësia e paaftësia, mungesa e*

*informimit dhe e transparencës (jo rregullimi i tij nga struktura shtetërore) apo, për më tepër, status quo mund të jetë mjaft e dëmshme për sektorin e sigurisë. Sidoqoftë, në thelbin e këtyre ndryshimeve duhet të qëndrojë balancimi, që synon ekuilibrin e procesit ekzekutiv dhe atij parlamentar, të procesit politik dhe ushtarak paralelisht me pjesëmarrjen civile. Për më tepër, në këtë proces, sidomos pas ngjarjeve të Gërdecit, kërkohet një sens urgjence!*

***Kushtëzimi demokratik si strategji e BE-së dhe kontrolli civil i FA-së.*** Thelbi i tij është inkurajimi i plotësimit të standardeve të demokracisë dhe të drejtave të njeriut (*kriteret e Kopenhagenit*) në fushën e FA-së apo të sigurisë, në përgjithësi, ku një nga kërkesat bazë është kontrolli demokratik civil i FA-së. Në këtë kuadër, është përfshirë në “skemë” dhe e drejta e asociimit (EUROMIL - *European Organisation of Military Associations*)<sup>1</sup>. Po ashtu, vetë kontrolli parlamentar apo mbikëqyrja parlamentare janë një përbërëse e domosdoshme e kontrollit demokratik dhe civil të FA-së apo e strukturave të tjera të rendit e sigurisë. Si pjesë integrale e shtetit demokratik (në përputhje me standardet e BE-së dhe kushtetutën kombëtare), kërkohet për to një lidhje sa më efektive e transparente midis tyre, por dhe vetë këtyre forcave apo strukturave të tjera të sigurisë e rendit publik dhe segmenteve të organizuara të shoqërisë civile. Madje, më shumë se më parë.

***Nga NATO në BE.*** Shqipëria e ka plotësuar kriterin e kontrollit demokratik civil të FA-së në përputhje me kërkesat e anëtarësimit në NATO. Por, Shqipëria nuk ka qenë nën ndonjë presion të fortë reformimi të marrëdhënieve ushtarake-civile, ndryshe nga ajo që do të kërkohet tashmë me pranimin e kërkesës së saj të një vendi kandidat për BE-në. Ka disa pista kryesore të ndikimit në balancën e raporteve ushtarake-civile. Këto janë:

---

<sup>1</sup> EUROMIL është një organizatë ombrellë e përbërë nga 35 asociacione kombëtare ushtarake apo sindikata, e themeluar në vitin 1972. Ajo promovon interesat sociale dhe profesionale të personelit ushtarak të të gjitha rrangeve në Europë. Për më hollësisht, shihni, ÇËSHTJE TË SIGURISË, *Security Issues*, Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim, Nr. 11, Tiranë, 2009.

- I. Rritja e ndikimit civil (p.sh., e Këshillit të Sigurimit apo Komitetit të Sigurisë);
  - II. Rritja e transparencës (hartimit, diskutimit, miratimit dhe kontrollit) për buxhetin e mbrojtjes dhe sigurisë (FA-së, rendit, SHIK-ut etj.);
  - III. Përmirësimi i mbikëqyrjes parlamentare (për të përmirësuar veprimtarinë apatike në komisionin përkatës parlamentar);
  - IV. Ndryshimi i kulturës së sigurisë dhe i kulturës politike, në marrëdhëniet civile-ushtarake - në shndërrimin e transferimin konceptor e praktik nga siguria tradicionale te siguria njerëzore<sup>2</sup>.
- Kushtetuta: Forcat e Armatosura.** Sipas Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë<sup>3</sup>, disa nene kryesore për FA-të janë:

**Neni 166:**

*Shtetasit shqiptarë kanë për detyrë të marrin pjesë në mbrojtjen e Republikës së Shqipërisë, si parashikohet në ligj. Shtetasi që, për arsye ndërgjegjeje, nuk pranon shërbimin me armë në forcat e armatosura, është i detyruar të kryejë një shërbim alternativ, si parashikohet në ligj.*

**Neni 167:**

1. *Ushtarakët e shërbimit aktiv nuk mund të zgjidhen ose të emërohen në detyra të tjera shtetërore dhe as të marrin pjesë në parti ose në veprimtari politike.*
2. *Pjesëtarët e forcave të armatosura ose personat që kryejnë shërbim alternativ, gëzojnë të gjitha të drejtat dhe liritë kushtetuese, përveç rasteve kur ligji parashikon ndryshe.*

**Neni 168:**

1. *Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë përbëhen nga forcat tokësore, detare dhe ajrore.*
2. *Presidenti i Republikës është Komandant i Përgjithshëm i Forcave të Armatosura.*
3. *Këshilli i Sigurimit Kombëtar është organ këshillimor i Presidentit të Republikës.*

---

<sup>2</sup> R. Meidani, *Probleme të sigurisë njerëzore në Ballkanin Perëndimor*, në "Çështje të Sigurisë (Security Issues)", Nr. 2, 2006, f. 78-92.

<sup>3</sup> Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, *Këtu fillon e ardhmja*, Tiranë, 21 tetor 1998.

**Neni 169:**


1. *Presidenti i Republikës, në kohë paqeje, ushtron drejtimin e Forcave të Armatosura nëpërmjet kryeministrit dhe ministrit të Mbrojtjes.*
2. *Presidenti i Republikës, në kohë luftime, emëron dhe shkarkon Komandantin e Forcave të Armatosura me propozim të kryeministrit.*
3. *Presidenti i Republikës, me propozim të kryeministrit, emëron dhe shkarkon shefin e Shtabit të Përgjithshëm, si dhe, me propozim të ministrit të Mbrojtjes, emëron dhe shkarkon komandantët e forcave tokësore, detare dhe ajrore.*
4. *Kompetencat e Presidentit të Republikës si Komandant i Përgjithshëm i Forcave të Armatosura dhe ato të Komandantit të Forcave të Armatosura dhe varësia e tyre nga organet kushtetuese, caktohen me ligj.*

Po ashtu, Presidenti i Republikës sipas nenit 92, germa f) “*me propozim të kryeministrit, emëron drejtorin e shërbimit informativ të shtetit*”. Kurse, në Paketën Kushtetuese<sup>4</sup> shkruhej se presidenti “*me propozim të kryeministrit emëron dhe shkarkon Komandantin e Gardës së Republikës*”, gjë që u ndryshua pas miratimit të Kushtetutës, disa vjet pas miratimit të saj. Një ndryshim tjetër parimor në kushtetutë ka qenë dhe ai i shndërrimit të Këshillit të Mbrojtjes në atë të Këshillit të Sigurimit Kombëtar.

Nisur nga paragrafi 3 i nenit 168 të kushtetutës, në lidhje me veprimtarinë e Këshillit të Sigurimit Kombëtar, mund të shtrohen aktualisht disa pyetje: A mjafton të funksionojë ai si organ këshillimor, ndryshe nga Këshilli i Mbrojtjes, i përcaktuar nga Paketa Kushtetuese si një organ vendimmarrës<sup>5</sup>? A duhet të ndryshojë përbërja e tij, sipas ligjit? (P.sh., me shndërrimin nga siguria tradicionale tek ajo njerëzore, mund dhe duhet të përfshihen aktorë të tjerë, që mbulojnë një apo disa përbërëse të sigurisë njerëzore si Ministria e Mjedisit etj.).

<sup>4</sup> Ligji nr. 7491, datë 29.4.1991, *Për dispozitat kryesore kushtetuese.*

<sup>5</sup> Ligji nr. 7528, datë 11.12.1991, *Për funksionet e Këshillit të Mbrojtjes dhe të Komandantit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura.*



Në fakt, një çështje e parë është të konceptuarit e vetë Këshillit të Sigurimit Kombëtar. Kështu, në kushtet e një republike parlamentare, janë të pranueshme të dy variantet: 1. të rikoncepohet e rindërtohet ai nën drejtimin e kryeministrit, duke fituar një natyrë (pothuajse) vendimmarrëse, natyrisht me një amendament të domosdoshëm kushtetues, ose 2. të mbahet ai pranë Presidentit të Republikës duke ruajtur natyrën këshillimore, por me një fuqizim të gjithanshëm strukturor, programor e njerëzor të këtij këshilli, në trajtë tashmë të një agjencie, për t'i dhënë asaj një përmbajtje të re analitike-studimore, reflektive - vizionare, rekomanduese e ushqyese konkrete për përmirësime strukturore e legjislative apo përpunime të vazhdueshme të elementëve bazë të strategjisë kombëtare, në kuadër të sigurisë njerëzore. Sidoqoftë, në variantin e parë, kryeministri, në kuadër të Këshillit të Ministrave, e ka kapacitetin e vendimmarrjes në fushën e sigurisë. Pra, në këtë kuptim, duket e tepër një strukturë paralele me kapacitete vendimmarrëse në fushën e sigurisë. Ndërsa, në variantin e dytë, që i përshtatet më shumë situatës së sotme kushtetuese-ligjore, kërkohet të ruhet karakteri këshillimor (duke ripërcaktuar detyrat e tjera, të prekura më sipër me stafin përkatës), nën drejtimin e Presidentit të Republikës. Një gjë e tillë e përfaqëson më mirë karakterin jo partiak (neutral) institucional, për të cilin kanë nevojë vetë çështjet e sigurisë.

***A ka mbulim apo përplasje?*** Siç u theksua më sipër, në fushën e kontrollit civil demokratik të forcave të sigurisë, krahas piramidës së drejtuesve kryesorë të shtetit, funksionojnë këto institucione civile:

- Komisioni Parlamentar (Mbrojtja, Rendi, SHIK-u)
- Këshilli i Sigurimit Kombëtar (Presidenti)
- Komiteti Ndërministror i Politikave të Sigurisë (Kryeministri).

Por, a ka mbulim apo përplasje midis këtyre institucioneve? Pa dyshim që ka, dhe është e pritshme, qoftë nga fryma e kushtetutës, qoftë dhe nga “përvetësimet” apo “lëshimet” individuale, edhe pse nuk janë të “rrezikshme”. Por më problematike është funksionimi i zbehtë i këtyre institucioneve (njëri sipas kushtetutës, tjetri me VKM). Edhe komisioni parlamentar ka, praktikisht, një ndikim relativisht të dobët në fushën e mbrojtjes apo sigurisë, përfshirë aty frymën partiake apo dobësitë njohëse e konceptore. Po ashtu, nuk mund të thuhet se Këshilli i Sigurimit Kombëtar luan një rol të rëndësishëm, madje as nuk e ka pamjen strukturore të një institucioni, veçse një “zbukurim” në detyrën e presidentit si kryetar shteti (apo si Komandant i Përgjithshëm i Forcave të Armatosura). Po ashtu, në shumicën e rasteve mbledhjet e Këshillit kanë pasur më tepër “sens urgjence” sesa programatike?! Madje, në shumicën e rasteve, kanë munguar në këto mbledhje, si diskutimi apo rrahja e problemeve, ashtu dhe rekomandimet mbi vizionin, strategjitë, politikat etj. në fushën e sigurisë. (Një situatë të ngjashme kemi pasur fillimisht dhe për KLD-në, para ndërtimit të strukturimit të plotë të këtij institucioni, krahas bazës ligjore, si staf apo seli e veçantë. Por, ama, ai e ka pasur dhe e ka elementin vendimmarrës brenda tij). Po këtë kuptim “zbukurues” ka dhe Komiteti Ndërministror i Politikave të Sigurisë pranë Kryeministrit. Pra, më shumë se përplasje apo mbulim midis këtyre institucioneve, ka më tepër mungesë efektiviteti dhe shumë më pak vizion e mendim strategjik.

***c. Kufizimi i pushtetit ekzekutiv***<sup>6</sup>. Pushteti ekzekutiv lidhet me përdorimin e fuqisë koercitive. Të tilla janë, p.sh., taksat (qendrore ose vendore). Po ashtu, një nga synimet e qeverisë është dhe garantimi i

---

<sup>6</sup> R. Meidani, *Kushtetuta: Bilanci dhe Perspektiva*, Toena, Tiranë, 2009; *Mbi qeverisjen* (I), Univ. M. Barleti & Dudaj, Tiranë, 2009.



vendit, i rendit social dhe mbrojtja e individit, e jetës së tij, nga sulmi personal apo kolektiv, dhe për këtë shfrytëzohet po ashtu fuqia koercitive. Pra, në një mënyrë apo tjetrën, si ka nënvizuar dhe Veberi, qeveria është një “monopol” i fuqisë koercitive. Megjithatë, në kuadër të ruajtjes së këtij monopoli mund të cenohet dhe vetë siguria, garantimi demokratik i saj. Prandaj, një problem madhor nuk është thjesht e vetëm morali i qeverisjes, por dhe rregullimi e kufizimi i fuqisë së saj koercitive kudo, përfshirë dhe këtë fushë.

Presidenti amerikan Uillson, gati një shekull më parë ka theksuar: “*Historia e lirisë është historia e kufizimit të pushtetit qeverisës dhe jo i rritjes së tij*”<sup>7</sup>. Ky kufizim, në një sistem politik demokratik, realizohet në disa drejtime:

1. *Kufizimi kushtetues-ligjor*. Ky kufizim, apo ndryshe i quajtur dhe kufizimi institucional-ligjor, realizohet, së pari, në mënyrë kushtetuese e ligjore, nëpërmjet ndarjes, nga njëra anë, dhe bashkëpunimit, balancimit dhe kontrollit reciprok të pushteteve të ndryshme, nga ana tjetër.

2. *Kontrolli parlamentar*. Për këtë lloj kontrolli, krahas grupit parlamentar të shumicës, për sqarime, rregullime, ndërhyrje e korigjime, ndryshime kabineti, një rol jo më pak të rëndësishëm duhet të luajë edhe opozita (nëpërmjet interpelancave për çështje konkrete, iniciativave ligjore në mbështetje të zhvillimit apo në shërbim të grupimeve të caktuara qytetare, mocioneve të ndryshme të besimit apo mosbesimit, komisioneve parlamentare, përfshirë dhe ato hetimore për çështje tepër madhore e serioze etj.)

3. *Kufizimi politiko-partiak*. Në kushte normale, kufizimi i pushtetit qeverisës realizohet politikisht si nga forca politike apo koalicioni i partive në qeverisje (sepse një gjë e tillë është në detyrimin programor e interesin e tyre politiko-elektoral), po ashtu dhe nga partitë opozitare nëpërmjet angazhimeve e veprimtarive të larmishme

4. *Kontrolli juridiko-ekonomik*. Ky lloj kontrolli, në përputhje me bazamentin kushtetues e ligjor, realizohet nëpërmjet strukturave të pavarura si: Prokuroria, Gjykatat (Gjykata e Faktit, e Apelit dhe Gjykata

---

<sup>7</sup> Woodrow Wilson, *Address to New York Press Club, September 9, 1912*.

e Larte, Gjykata Kushtetuese), Avokati i Popullit, KLSH-ja, Banka e Shqipërisë, Entet rregullatore (p.sh. për politikat e çmimeve), Inspektorati i Larte i Deklarimit të Pasurisë, Zyra e Konkurrencës etj.

5. *Kontrolli sindikalist dhe i biznesit.* Në kushtet e reja të riorganizimit ekonomik e shoqëror, të rritjes së rolit të prodhimit të vogël e të mesëm, të shoqëruar me shpërndarjen dhe mikrostrukturimin e fuqisë punëtore, janë shfaqur dobësi të theksuara në lëvizjen sindikaliste, në mbrojtje të interesave të punëmarrësve përkundrejt punëdhënësve privatë ose publikë. Për të shmangur dobësitë aktuale të rolit dhe forcës së kësaj lëvizjeje në kufizimin e pushtetit qeverisës del si nevojë si përpunimi i një legjislacioni bashkëkohor, ashtu dhe i një vizioni të ri në reformimin e kësaj lëvizjeje në kushtet e reja. Krahas shmangies së mungesës së energjisë dhe orientimit apo frymën e pranishme të konformizmit. (si, p.sh., “heshtja sindikaliste” në momente të tilla, siç është ai i rritjes së pagave e pensioneve pak mbi inflacionin për të gjitha kategoritë e punonjësve, apo ai i rritjes së tarifave për shërbimet e ndryshme, p.sh., të energjisë etj.). Jo pa vlerë është dhe reagimi i organizmave punëdhënëse private dhe i bashkimeve të tyre, ndaj trysnive e veprimeve të padrejta e arbitrare të pushtetit qeverisës, në dëm të biznesit korrekt me ligjin e sistemin rregullator.

6. *Kontrolli publik, shoqëria civile, media dhe pjesëmarrja qytetare.* Një rol gjithnjë në rritje në një sistem demokratik luan dhe kontrolli e reagimi publik, i sintetizuar si një reagim qytetar apo ai i shoqërisë civile, në përgjithësi. Vetë Xhefersoni, mbi dy shekuj më parë, mbi rolin kontrollues e kufizues të medias së lirë mbi pushtetin qeverisës, ka nënvizuar: “*Asnjë qeveri nuk duhet të jetë pa censurues; dhe aty ku shtypi është i lirë, asnjëra prej qeverive nuk mund të mbetet pa atë*”<sup>8</sup>. Pavarësisht, disa shformimeve të shfaqura dhe në median tonë, disa pozicioneve diku konformiste, diku abuzive apo dhe me lidhje interesi, në mesatare ajo përsëri e ka ruajtur forcën e saj “censuruese” dhe mbetet një zë me vlerë në zhvillimet tona. Po aq i rëndësishëm është shfaqur aty-këtu dhe roli e ndikimi i disa OJF-ve apo i strukturave të tjera të shoqërisë civile.

---

<sup>8</sup> Thomas Jefferson, Letter, 9 Sept. 1792, to George Washington.

Duke ndaluar në analizën e këtyre aspekteve kryesore të kufizimit të pushtetit ekzekutiv, qoftë nga pikëpamja teorike legislative (kushtetuese-ligjore), ashtu dhe ajo praktike, shihet lehtë që Shqipëria është ende larg të qenit vend realisht demokratik, midis shtetit të së drejtës, në përgjithësi, dhe qeverisjes së paanshme, në veçanti.

***Cilat funksionojnë?*** Pas këtij përshkrimi disi të detajuar të funksionimit të këtyre mekanizmave kufizues e kontrollues të fuqisë ekzekutive në tërësi, mund të ndalohet në kontrollin (kufizimin) civil demokratik të FA-ve. Konkretisht, sipas trajtimit të mësipërm, funksionojnë relativisht mirë mekanizmat 1, 2, 4, 6. Pra, kemi:

1. Kufizimi civil kushtetues-ligjor (nëpërmjet Presidentit, Këshillit të Sigurimit Kombëtar, Kryeministrit-Ministrit të Mbrojtjes, Komitetit pranë Kryeministrit)
2. Kontrolli parlamentar-institucional (sidomos nga komisioni parlamentar përkatës)
3. Kontrolli juridik-ekonomik (në tërësi, i pjesshëm, ndërkohë që do të ishte fare i pranueshëm funksionimi i një *ombudsmanni* ushtarak)
4. Kontrolli publik, shoqëria civile, media, reagimi dhe pjesëmarrja qytetare (p.sh., që mund të fuqizohet më tej duke rritur nivelin e transparencës dhe të komunikimit).

Ka probleme, deri diku të arsyeshme, në lidhje me rubrikat e mëposhtme, si:

5. Kufizimi politiko-partiak (vetëm në mënyrë të tërthortë nëpërmjet strukturave ligjore-institucionale, p.sh., nëpërmjet komisionit parlamentar, përndryshe preket thelbi kushtetues neutral i vetë FA-ja apo strukturave të rendit e sigurisë, në përgjithësi)
6. Kontrolli i tipit të asociimit (gjë që është larg funksionimit, qoftë dhe për arsyen e thjeshtë të moskrijimit të këtij asociimi!).

## **B. KONTROLI DEMOKRATIK I FORCAVE TË ARMATOSURA**

***Parime kushtetuese.*** Këto parime mund të adresohen në kushtetutën e çdo vendi demokratik, si, p.sh. në Kushtetutën e USA (1787). Po ashtu, parlamentet kombëtare mund të adoptojnë ligje specifike, që përfshijnë apo fuqizojnë parimet e kontrollit demokratik. Nuk mungojnë dhe iniciativa konkrete për krijimin e mekanizmave

institucionale, që garantojnë respektimin e ligjit, nëpërmjet asistencave të veçanta apo strukturave specifike si p.sh. inspektorët e përgjithshëm apo *ombudsmanët* ushtarakë.

Në këto parime, në përgjithësi, përfshihen: ndarja dhe ndërthurja midis strukturave ushtarake e civile, drejtimi civil dhe kontrolli parlamentar, kundërvënia ndaj “*intelligence state*”, kontrolli prej shoqërisë civile, transparencë, respektimi i lirive dhe të drejtave të njeriut, edukimi jo në duar të vetëm ushtarakëve, struktura të pavarura të prokurorisë dhe të gjykatave (mundësisht jo struktura ushtarake), bashkëpunimi ndërkombëtar. Në linja të përgjithshme, këto parime funksionojnë dhe për Forcat e Armatosura të Shqipërisë, që i nënshtrohen kontrollit civil, në përputhje me nenin 12 të Kushtetutës së Shqipërisë. Ja përmbajtja konkrete e tij:

***Neni 12:***

- 1. Forcat e Armatosura sigurojnë pavarësinë e vendit, si dhe mbrojnë tërësinë territoriale dhe rendin e tij kushtetues.*
- 2. Forcat e Armatosura ruajnë asnjërinë në çështjet politike dhe i nënshtrohen kontrollit civil.*
- 3. Asnjë forcë e huaj ushtarake nuk mund të vendoset dhe as të kalojë në territorin shqiptar, si dhe asnjë forcë ushtarake shqiptare nuk mund të dërgohet jashtë, përveç me një ligj të miratuar me shumicën e të gjithë anëtarëve të Kuvendit.*

Po aq të rëndësishme janë dhe nenet e Kushtetutës së Shqipërisë që kushtëzojnë marrëveshjet ndërkombëtare. Sipas tyre nënvizohet:

***Neni 121:***

- 1. Ratifikimi dhe denoncimi i marrëveshjeve ndërkombëtare nga Republika e Shqipërisë bëhet me ligj në rastet kur ato kanë të bëjnë:*

...

*c) Anëtarësimin e Republikës së Shqipërisë në organizatat ndërkombëtare.*

- 2. Kuvendi, me shumicën e të gjithë anëtarëve, mund të ratifikojë edhe marrëveshje të tjera ndërkombëtare që nuk parashikohen në paragrafin 1 të këtij neni.*

**Neni 122:**

...

2. *Një marrëveshje ndërkombëtare e ratifikuar me ligj ka epërsi mbi ligjet e vendit që nuk pajtohen me të.*

3. *Normat e nxjerra prej një organizate ndërkombëtare kanë epërsi në rast konflikti, mbi të drejtën e vendit, kur në marrëveshjen e ratifikuar nga Republika e Shqipërisë për pjesëmarrjen në atë organizatë, parashikohet shprehimisht zbatimi i drejtpërdrejtë i normave të nxjerra prej asaj.*

**Neni 123:**

1. *Republika e Shqipërisë, në saje të marrëveshjeve ndërkombëtare, u delegon organizatave ndërkombëtare kompetenca shtetërore për çështje të caktuara.*

2. *Ligji me të cilin ratifikohet një marrëveshje ndërkombëtare, si parashikohet në paragrafin 1 të këtij neni, miratohet me shumicën e gjithë anëtarëve të Kuvendit.*

3. *Kuvendi mund të vendosë që ratifikimi i një marrëveshjeje të tillë të bëhet me referendum.*

**Dërgimi jashtë vendit i trupave ushtarake.** Dërgimi i trupave jashtë vendit është një nga vendimet, ndër më të rëndësishmet, që merr një vend. Në raste të tilla, kërkohen të merren parasysh disa konsiderata të karakterit etik dhe juridik, nevojitet të analizohet me kujdes afektimi i marrëdhënieve të jashtme të këtij vendi, jo vetëm me vendin ku dërgohen këto trupa, por dhe vende të tjera, p.sh., ata fqinjë. Gjithashtu, nga ky dërgim vihen potencialisht në rrezik fizik trupat e vendit dërgues dhe konsumohen burime jo të vogla materiale e financiare. Dhe, së fundi, me dërgimin e trupave jashtë vendit lidhet si vendimarrja e këtij operacioni, ashtu dhe kontrolli e mbikëqyrja e kësaj zhvendosjeje.

**Roli i ekzekutivit.** Në shumicën e vendeve demokratike, ekzekutivi vendos dërgimin e trupave jashtë me miratimin e parlamentit. Kjo mund të ndodhë para apo pas dërgimit. Megjithatë, edhe në rastet kur nuk nevojitet konsensusi parlamentar përpara këtij dislokimi trupash (një lloj miratimi parlamentar për këtë dërgim të trupave jashtë), qeveria apo ekzekutivi konsultohet zakonisht me parlamentin për të

garantuar vullnetin e domosdoshëm në autorizimin e këtij misioni apo për të pranuar fondet e domosdoshme për një dislokim të tillë.

<i><b>Funksion</b></i>	<i><b>Instrumentet</b></i>
Bashkëvendim-marrës	Autorizon dërgimin e trupave apo përdorimin e forcës, para ose pas ngjarjes
Operacional	Rishikon, dhe në disa raste vendos, detaje operationale si mandati, numri i trupave, koha e misionit, rregullat e angazhimit
Buxhetor	Aprovon shpenzimet në misionin ushtarak
Censioral	Ruan të drejtën e votës së mosbesimit, censurimit apo “impeachment” në raste të mosmiratimi ndaj vendimeve qeveritare
Investigativ	Mbledh informacionin e duhur dhe monitoron (interpelanca, debate, seanca dëgjimore, hetime etj.), viziton trupat për të konfirmuar gjithçka
Përfaqësues	Ndihmon e lehtëson konsensusin politik për dërgimin e trupave përfshi dhe shmangien e pakënaqësisë popullore

Trupat jashtë, në përgjithësi, vendosen nën *kontrollin operacional* të udhëheqjes ushtarake në terren, por ekzekutivi kombëtar ushtron autoritetin mbi ushtarakët dhe luan një rol të padiskutueshëm në ndikimin e ngjarjeve në terren. Po ashtu, ekzekutivi mbështet udhëheqjen ushtarake në konsultimet me partnerët ndërkombëtarë, lehtëson bashkëpunimin me agjenci të tjera kombëtare si shërbimet sekrete apo inteligjente, e mban të informuar parlamentin dhe publikun. Dhe së fundi, ekzekutivi monitoron aktivitetet ushtarake dhe “kontraktorët” shoqëruar, dhe mbi të gjitha përpiqet të sigurojë respektimin e të drejtave njerëzore dhe angazhimin për zbatimin e ligjit ndërkombëtar.

Një sfidë më vete për ekzekutivin është dhe mbikëqyrja e realizuar prej tij, pa ndërhyrë në detajime për administrimin e operacioneve ushtarake dhe pa prekur efektivitetin e tyre...

**Cilat janë fuqitë e mbikëqyrjes prej parlamentit.** Në tabelën këtu pranë reflektohen funksionet parlamentare të karakterit mbikëqyrës (bashkëvendimmarrës, operacional, buxhetor, censioral, investigativ dhe përfaqësues) për dërgimin e trupave ushtarake jashtë vendit. Vendimi i parlamentit kërkohet edhe për zhvendosjen apo dislokimin e trupave ushtarake jo shqiptare. Sepse Kushtetuta (neni 12, paragrafi 3), siç u përmend dhe më sipër, thekson prerë se: “*Asnjë forcë e huaj ushtarake nuk mund të vendoset dhe as të kalojë në territorin shqiptar, si dhe asnjë forcë ushtarake shqiptare nuk mund të dërgohet jashtë, përveç me një ligj të miratuar me shumicën e të gjithë anëtarëve të Kuvendit*”. Por kjo bëhet problematike, deri penguese në kushtet e reja të Shqipërisë si vend anëtar i NATO-s. Këtë dëshmon dhe një shembull i kohëve të fundit.

**Një shembull i freskët!** Konstatohet një VKM e datës 13 nëntor 2009 me objekt: “*Lejimi kalimi transit të dy autokolonave ushtarake italiane përmes territorit të RSH.*”<sup>9</sup> dhe ndërkohë kalimet transit kanë ndodhur ditë më parë. Aq më tepër pa miratimin e Kuvendit! Një gjë e tillë konstatohet dhe në tekstin e këtij vendimi:

1. *Lejimin e kalimit transit përmes territorit të Republikës së Shqipërisë...në datën 8 nëntor 2009 të një autokolone ushtarake italiane, të përbërë nga 4 (katër) automjete dhe 15 (pesëmbëdhjetë) trupa.*

2. *Lejimin e kalimit transit përmes territorit të Republikës së Shqipërisë..., në datën 10 nëntor 2009 të një autokolone ushtarake italiane të përbërë nga 14 (katërmëdhjetë) automjete dhe 33 (tridhjetë e tre) trupa.*

**Disa komente.** Vendimmarrja konkrete ndryshon nga vendi në vend. Në disa vende, parlamenti duhet të japë autorizimin e aprovimin për të dërgimin jashtë të trupave ushtarake. Sipas sistemit kjo mund të ndodhë si para ashtu dhe pas dislokimit konkret.

---

<sup>9</sup> *Lejimi kalimi transit të dy autokolonave ushtarake italiane përmes territorit të RSH, VKM e datës 13 nëntor 2009.*

Preferohet në mjaft raste parapëlqimi apo miratimi para dërgimit.

Pas dislokimit të trupave jashtë vendit bëhet praktikisht e pamundur për parlamentin që ta hedhë poshtë apo të mos e pranojë këtë vendim të ekzekutivit, sepse një gjë e tillë mund të rrezikojë vetë misionin e nisur, por dhe kredibilitetin e qeverisë. Në disa raste, në lidhje me parapëlqimin, përfshihen dhe disa kushte specifike dislokimi. P.sh., në ligjin japonez të paqeruajtjes, ato lidhen me specifikat pas ndërprerjes së konfliktit, me lejen e vetë vendit, ku bëhet dislokimi etj.

Po ashtu, në shumë vende, p.sh. në Francë, parlamentet nuk kanë kontroll të drejtpërdrejtë mbi trupat menjëherë pas dislokimit të tyre jashtë vendit. Në vende të tjera, kontrolli mbi detajet operacionale mund të përfshijë dhe kompetencat apo fuqinë për të përcaktuar mandatin, vendndodhjen e numrin e trupave, bile dhe detaje specifike për rregullat e angazhimit, zgjatjen e misionit apo tipin e armëve dhe të instalimeve të tjera të planifikuara për shfrytëzim. Megjithëse vendime të tilla realizohen në këshillim të plotë me profesionistët e drejtuesit ushtarakë, roli i parlamentit mund të ndikojë jo pak në kohëzgjatjen e procesit, deri në cilësinë e debatit që mund të vonojë ndryshimet në terren.

**Kontrolli mbi buxhetin.** Si dhe në raste të tjera, kjo është një prerogative e parlamentit. Ai ka të bëjë si për buxhetin e rregullt vjetor, ashtu dhe për shpenzimet suplementare në operacione specifike. Por, edhe ky kontroll buxheti shfaq po ashtu kufizime praktike. Parlamenti mund të modifikojë propozimet e ardhura nga qeveria, por ama nuk mund të iniciojë shpenzime jashtë skemës së pranuar të buxhetit. Nga ana tjetër, shtrëngimet buxhetore mund të lidhen dhe me politika specifike. (Kështu, p.sh., Akti i vitit 1993, në SHBA, theksonte se fondet e përcaktuara nuk mund të shfrytëzoheshin për operacione ushtarake në Haiti, pa plotësimin e disa kushteve të kërkuara, që përfshinte dhe dorëzimin e një strategjie daljeje (*exit strategy*) në kongres). Në disa sisteme, parlamenti u drejtohet dhe masave të tilla ekstreme, si mocioni i *besimit* (*mosbesimit*) apo “*impeachment*”, në raste pakënaqësie ndaj vendimeve të dërgimit të forcave apo mënyrës së dislokimit të tyre. Në të vërtetë, masa të tilla ekstreme janë shfrytëzuar shumë rrallë, nga që ata, në raste krize, e dobësojnë forcën e ekzekutivit deri në atë shkallë që mund të rrezikojë interesin kombëtar. Nga ana tjetër, jo vetëm që



nuk mund të shmanget, por është dhe krejtësisht demokratike, që parlamenti të shfrytëzohet nga partitë e përfaqësuara aty apo individë të veçantë si një forum për artikullimin e kundërshtive ndaj përdorimit e dislokimit të trupave jashtë, sjelljes së organeve ekzekutive në këtë dislokim etj.

**Fuqia e investigimit.** Parlamenti shfrytëzon të drejtën e informimit, natyrisht pa kapërcyer të drejtën e sekretit përkundrejt publikut. I tillë është debati i hapur, transparenca mbi politikën konkrete ekzekutive. Po aq të përdorshme rezultojnë seancat e pyetje-përgjigjeve me anëtarët e kabinetit apo komandantët ushtarakë, madje në ndonjë rast dhe seancat dëgjimore nën betim. Megjithatë, nuk mungojnë rastet e publikimit të këtyre seancave. Po ashtu, mund të realizohen anketa konkrete dhe seanca dëgjimore, apo vizita tek trupat ushtarake të dislokuara jashtë vendit. Në disa vende, këto “teknologji” investigimi aplikohen nga parlamenti si i tërë, në të tjera vetëm nga komitetet apo komisionet parlamentare përkatëse. Në përgjithësi, me rastin e dislokimit të trupave jashtë vendit, mund të krijohen si komisione të përhershme ose ato *ad hoc* për monitorimin e këtij dislokimi dhe të problemeve të lidhura me të.

Shteti	Aprovimi paraprak	Mandati i misionit	Aprovimi i buxhetit	Zgjatja e misionit	Çështje operac.	E drejta e vizitës
Kanadaja	o	o	o	o	o	X
Çekia	X	X	X	X	o	X
Danimarka	X	X	X	X	X	X
Franca	o	o	o[1]	o	o	X
Gjermania	X	X	X	X	X	X
Hungaria	X	-	X	-	-	-
Maqedonia	X	X	X	X	o	X
Holanda	X	X	X	X	X	X
Polonia	o	o	o	o	o	X
Rumania	X	X	X	X	o	X
Spanja	X	o	X[2]	X	o	X
Zvicra	X	o	X	X	o	X

Suedia	X	X	X	X	o	X
Turqia	X	o	o	o	o	o
Britania	o	o	o	o	o	X
SHBA-ja	o	o	X	X	X	X
Shqipëria	X	X	X	X	o	-

*Por, a ndryshon kapaciteti parlamentar nga një vend në tjetrin?*  
Në tabelën këtu pranë raportohet rezultati i pyetësorit nga komitete të mbrojtjes në vende të ndryshme, më 2002. Ajo pasqyron dhe kompetencat apo fuqitë konkrete në lidhje me dislokimin e forcave ushtarake jashtë vendit. Në këtë tabelë, ndeshen dhe sqarimet shpesh: [1] pas faktit. [2] vetëm për buxhete suplementare. Po ashtu; aty si probleme operacionale konsiderohen ato që përfshijnë rregullat e angazhimit, komandën e kontrollin apo çështje rrezikshmërie. Ndërsa, në plotësimin e të dhënave shfrytëzohen shenjat: “X” - parlamenti zotëron fuqinë përkatëse, “o” - parlamenti nuk e zotëron këtë fuqi dhe shenja “-” informacioni ose nuk është dhënë, ose nuk është aplikuar.

**Disa sfida të mbikëqyrjes.** Në lidhje me mbikëqyrjen, vlejnjë të kihen parasysh dhe këto çështje.

*Efektiviteti kundrejt legjitimitetit.* Kërkesa për një miratim paraprak të dërgimit të trupave jashtë vendit mund të komprometojë aftësinë mbrojtëse të vendit apo rolin dhe kontributin e tij në bashkëveprimin ndërkombëtar. Procedurat parlamentare janë zakonisht të gjata dhe të zvarritura, gjë që e bën aprovimin paraprak parlamentar dhe vetë dislokimin jopraktik ose gati-gati të pamundshëm. Prandaj, në disa vende ku parlamenti duhet të japë këtë autorizim paraprak, lejohet një dislokim urgjent në situata në të cilat kërcënohet siguria kombëtare.

*Autoriteti i kufizuar.* Ligjet e përdorura për dislokimin ushtarak jashtë nuk mund të adoptohen apo shfrytëzohen ndaj forcave të tjera të sigurisë si agjencitë e inteligjencës, kur ato veprojnë jashtë territorit.

*Një terminologji e vagët.* Për të shmangur konfuzionin, mbikëqyrja lidhet me dislokimin e trupave apo shfrytëzimin të forcës, por jo me gjendjen e luftës.

**Dislokim trupash nën sigël ndërkombëtare.** Dislokimi i trupave nën siglën e OKB-së, NATO-s, BE-së dhe të aleancave të tjera

apo koalicioneve të vullnetit janë mjaft të ngjashme. Megjithatë, në jo pak raste, këto operacione janë kritikuar në saje të shfaqjes së një “*deficiti demokratik*” gjatë funksionimit të tyre. Kjo edhe pse në raste të tilla, trupat aty mund të marrin urdhra nga struktura të një vendi tjetër apo të organizatës ndërkombëtare; ata mund të kufizojnë aftësinë e autoriteteve kombëtare për kontrollin e trupave të tyre. Sidoqoftë, *kontrolli operacional* i ushtruar nga autoritetet ndërkombëtare është zakonisht i dalluar nga komanda kombëtare apo kontrolli përkatës me faktin që ai është *i përkohshëm* dhe i kufizuar ndaj detyrave specifike. NATO-ja, p.sh., konfirmon që kontrolli operacional nuk e përfshin autoritetin për të ndryshuar përbërjen e njësive, disiplinimin apo promovimin e tyre etj., jashtë përgjegjshmërisë së miratuar nga autoriteti kombëtar. Pra, në përgjithësi, tentohet që vendet pjesëmarrëse të ruajnë komandën dhe kontrollin mbi trupat e tyre.

***Mbikëqyrja nga strukturat qeverisëse të OKB-së, BE-së apo NATO-s?*** Le të ndalojmë kalimthi në mbikëqyrjen e tyre:

***OKB-ja.*** Në këtë rast, strukturat vendimmarrëse të OKB-së e komplikojnë jo pak mbikëqyrjen kombëtare.

***Këshilli i Sigurimit.*** Ai ka përgjegjësinë parësore për vendimet e lidhura me dislokimin e trupave. Në veçanti, shtetet që kontribuojnë në misione të tilla, por pa pasur vend në këtë këshill nuk mund të kenë të drejtë vote në vendimet përkatëse. Asambleja e Përgjithshme luan këtu një rol të kufizuar, edhe pse, që nga viti 1965, ka një Komitet Special për Operacionet Paqeruajtëse, që raporton në mënyrë vjetore para kësaj asambleje. Po ashtu:

- Procesi i vendimmarrjes në KS realizohet, zakonisht, në seanca të mbyllura, duke krijuar probleme për mbikëqyrjen nga qeveri që nuk janë të përfshira në mënyrë të drejtpërdrejtë në këtë proces, nga opinioni publik dhe parlamenti përkatës.

- OKB-ja nuk ka një parlament të zgjedhur në mënyrë të drejtpërdrejtë nga popujt e vendeve anëtare.

***BE-ja.*** Dislokimet e BE-së realizohen me konsensusin e të gjithë anëtarëve të këtij Bashkimi, në takimin e Këshillit Europian (*European Council*). Po ashtu, vlen të theksohet se parlamenti i BE-së, i zgjedhur në mënyrë të drejtpërdrejtë, e ka fuqinë për të aprovuar buxhetin për

Politikën e Jashtme të Përbashkët dhe atë të Sigurisë, por *nuk ka ndonjë rol në vendimmarrjen operacionale*. Nga ana tjetër, një barrierë kryesore e kësaj mbikëqyrjeje është vetë natyra komplekse e BE-së. Një strukturë ndërqeveritare është ESDP, që ndërmerr veprime nën të ashtuquajturën “*kolonë të parë*” të BE-së (që lidhet, p.sh., me aspektin civil të menaxhimit të krizës) apo të ashtuquajturën “*kolonë të tretë*” (p.sh., bashkëveprimi antiterror). Sidoqoftë, ka disa mekanizma dhe institucione të ndryshme të vendimmarrjes, ndërsa roli i ekzekutivit është luajtur, në varësi të kontekstit, nga Komisioni, Këshilli dhe qeveritë kombëtare.

**NATO-ja.** Vendimmarrja e dislokimit të trupave bëhet me konsensus, por strukturat e saj janë më “të rrjedhshme” dhe “të kapshme” në krahasim me ato të BE-së. Asambleja Parlamentare e NATO-s është ndikuese. Ajo nuk është e zgjedhur nga elektorati i vendeve anëtare të NATO-s, prandaj nuk ka rol të drejtpërdrejtë në vendimmarrje.

**ESDP (European Security and Defence Policy).** Kjo strukturë është një element bazë i kolonës së BE-së për Politikën e Përbashkët të Jashtme dhe të Sigurisë, që mbulon, po ashtu, aspektet ushtarake dhe të mbrojtjes. ESDP-ja është pasuesja e ESDI-së (*European Security and Defence Identity*), që kalon nga NATO në juridiksionin e BE-së, duke përfshirë dhe vendet e painkuadruara në NATO.

**Koalicionet ad hoc.** Nga pikëpamja e kontrollit, llogaridhënies parlamentare dhe mbikëqyrjes demokratike këto koalicione shfaqin probleme të mbështetjes konkrete. Përveç mungesës së një përmase parlamentare, këto koalicione shfaqin mangësi në një shtresim ndërqeveritar, në pikëpamje të formalitetit e transparencës, sidomos në procesin e vendimmarrjes. Për më tepër, mandati dhe komanda, strukturat e kontrollit kanë prirjen të përcaktohen kryesisht sipas kontribuuesit kryesor, që realizon dhe drejtimin e trupave, duke kufizuar apo duke e pakësuar hapësirën e negocimit për vendet me kontribut të vogël. Madje, në këtë kuptim, kur qeveritë përkatëse praktikisht nuk kanë çfarë të thonë, aq më të dobët rezultojnë ndikimet e parlamenteve të tyre...

**Memorandumi i mirëkuptimit.** I tillë është, p.sh., ai midis OKB-së dhe Shqipërisë. Ai përcakton rregulla të forta për sjelljen e

ushtarakëve në misionet ushtarake ndërkombëtare. Për më tepër, të qenët pjesë e misioneve paqeruajtëse të OKB-së, përveç detyrimeve financiare, kërkon tashmë një standard të lartë moral.

Nisur pikërisht nga kompleksiteti i vendeve të ndryshme ku operon kjo organizatë, por edhe nga skandalet e shumta, që kanë shoqëruar qëndrimin dhe aksionin e misioneve të ndryshme ushtarake në vendet në konflikt, Organizata e Kombeve të Bashkuara është detyruar të vendosë rregulla të qarta, duke specifikuar deri në detaje mënyrën e sjelljes së ushtarakëve në raport me popullsitë vendase, si dhe duke përcaktuar zgjidhjen e pasojave që mund të sjellin ato. Këtij rregulli të fortë duhet t'i nënshtrohet edhe vendi ynë në kuadër të misioneve të OKB-së. P.sh. për dërgimin e një njësie ushtarake (p.sh., kontingjenti shqiptar në Çad), për të sanksionuar këto rregulla dhe mandatin e kësaj njësie midis qeverisë shqiptare dhe Organizatës së Kombeve të Bashkuara, është nënshkruar një memorandum mirëkuptimi, që më tej kërkon ratifikimin në Kuvend për t'u bërë i detyrueshëm, gjatë zbatimit, nga palët.

**Gjen. Brig. MAKSIM MALAJ****(SHEF I SHTABIT TË PËRGJITHSHËM I FORCAVE TË ARMATOSURA)**

---

Është një kënaqësi e veçantë për mua si shef i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë t'i drejtohem një auditori kaq të përzgjedhur për të ndarë me ju disa mendime dhe sugjerime në lidhje me çështjen që do të trajtojmë sot.

Vetëm disa muaj më parë, Ministria e Mbrojtjes, Shtabi i Përgjithshëm i Forcave të Armatosura në bashkëpunim me Komandën e Doktrinës dhe Stërvitjes, Akademinë e Mbrojtjes dhe Institutin për Demokraci dhe Ndërmjetësim, organizuan një seminar ku u trajtuan dhe u analizuan në hollësi çështje që kanë të bëjnë me kontrollin demokratik në Forcat e Armatosura, marrëdhëniet civile-ushtarake, si dhe të drejtat e ushtarakëve. Sot, jemi mbledhur sërish në një interval relativisht të shkurtër kohor, për të diskutuar përsëri mbi këtë çështje.

Në këtë situatë, disa nga pyetjet që natyrshëm mund të lindin janë: Ç'e bën këtë çështje kaq të rëndësishme dhe interesante? Përse vazhdon të jetë kaq aktuale dhe arrin të intrigojë diskutime dhe debate në nivele të ndryshme siç është diskutimi i sotëm?

Në të vërtetë, analiza e marrëdhënieve ndërmjet politikës, ushtarakëve dhe faktorëve të ndryshëm socialë nuk është një dukuri e re.

Zhvillimi i shoqërisë shoqërohet në mënyrë objektive me lindjen e sfidave dhe problemeve që kërkojnë përgjigje nga faktorët dhe aktorët që janë pjesë e këtyre proceseve, një prej të cilave është pasqyrimi i marrëdhënieve mes ushtarakëve dhe civilëve në kontekstin e këtyre zhvillimeve.

Vërtetimin më të mirë të kësaj qasje, mund ta bëjmë nëse marrim në analizë faktin se si ka evoluar kjo çështje në një periudhë kohore prej dy dekadash për të kuptuar ndryshimin e këtij raporti si në formë ashtu dhe në përmbajtje.

Gjatë periudhës së komunizmit, Forcat e Armatosura ishin në varësi të drejtpërdrejtë të lidërshiptit politik, i cili ishte i interesuar që, duke i dhënë një mbulesë propagandistike e ideologjike rolit dhe përgjegjësi

të ushtrisë të mbronte në radhë të parë interesat e atij sistemi. Ushtria gjatë kësaj periudhe ishte pasqyrim i realitetit të brendshëm, por edhe atij ndërkombëtar.

Ndryshimet politike në Shqipëri, që në thelbin e tyre ishin të orientuara drejt zhvillimit të interesave dhe raporteve të reja gjeopolitike, shtruan si domosdoshmëri reformimin e të gjitha institucioneve të shtetit në mënyrë që ato të pasqyronin e garantonin nivelin e ndërveprueshmërisë me të gjitha institucionet ndërkombëtare, anëtarësimi drejt të cilave u shpall si prioritet kombëtar.

Në këtë kuadër, si pjesë e këtij ndryshimi, roli i Forcave të Armatosura, fitoi të tjera dimensione. Ato iu nënshtruan një reforme të thellë në mënyrë që t'i përgjigjeshin kërkesave dhe kushteve të reja. Për herë të parë në historinë e Forcave të Armatosura të Shqipërisë ushtarakët shqiptarë u bënë pjesë e misioneve ndërkombëtare për garantimin e paqes dhe të sigurisë jashtë vendit.

Në tërësinë e këtyre zhvillimeve, një prej kërkesave ishte vendosja e kontrollit demokratik civil mbi Forcat e Armatosura, si një detyrim kushtetues që ekzistonte në të gjitha vendet demokratike, me të cilat nisi zhvillimi i marrëdhënieve të reja të bashkëpunimit.

Sot, pas dy dekadash, ne mund të shprehemi se Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë i ushtrojnë përgjegjësitë e tyre kushtetuese në respekt të ligjeve në fuqi dhe në transparencë të plotë me të gjitha strukturat shtetërore brenda një sistemi të ri demokratik dhe i nënshtrohen kontrollit të autoriteteve civile të shtetit.

Kontrolli civil mbi Forcat e Armatosura konsiderohet si një kriter themelor në vlerësimin e nivelit të demokracisë jo vetëm në Forcat e Armatosura, por dhe të shoqërisë në tërësi.

Ky kontroll realizohet në disa plane nëpërmjet institucioneve më të larta shtetërore të vendit, si janë Kuvendi, Presidenti i Republikës, Këshilli i Ministrave, si dhe institucione të tjera kushtetuese, ku mund të përmendim organet e pushtetit gjyqësor, Avokatit të Popullit, Kontrollit të Lartë të Shtetit etj. Gjithashtu, një rol të rëndësishëm në transparencën dhe informimin e opinionit publik mbi rolin e Forcave të Armatosura si dhe reformat e ndërmarra në to, luajnë edhe institucionet e medias dhe të shoqërisë civile.

Duke ju referuar këtij raporti, me synimin për të nxitur më tej diskutimet, të cilat do t'i shërbenin jo vetëm njohjes më mirë, por edhe përmirësimit të mëtejshëm të marrëdhënieve midis ushtarakëve dhe civilëve, më lejoni të ndalem pak në rolin e ushtarakut, pasi mendoj se do të ishte me interes marrja në analizë e këtij roli, si një prej elementëve kryesorë të marrëdhënies civilo-ushtarake. E përbashkëta e një ushtaraku me çdo individ tjetër të shoqërisë, në rastin tonë, civilë që përfundon studimet e larta, është fakti se të dy kanë mësuar dhe fituar një profesion. Por, te përzgjedhja e këtij profesioni, fillon edhe dallimi mes këtyre dy individëve, dallim ky që në jetën e përditshme por edhe në literaturën politike apo juridike, lë vend për të folur për marrëdhëniet civile-ushtarake. Po ku qëndron diferenca? Civilët gëzojnë një tërësi të drejtash, disa prej të cilave nuk mund të gëzohen nga ana e ushtarakëve si qytetarë në uniformë, për sa kohë që ata janë aktivë në ushtrimin e profesionit të tyre. Ushtarakut nuk i lejohet të jetë i angazhuar në jetën politike të vendit, si dhe është i privuar edhe nga disa të drejta që gëzojnë në mënyrë të natyrshme civilët. Kjo shpjegon edhe faktin që trajtimi i ushtarakëve bëhet gjithnjë përmes ligjeve dhe procedurave të veçanta.

Në thelbin e këtyre ndryshimeve është fakti se nga vetë profesioni i tij, ushtaraku nuk vendos në qendër të veprimtarisë së tij interesat personale, por ato të atdheut, të flamurit, interesat e mbrojtjes së lirisë dhe integritetit territorial të vendit të tij.

Puna e ushtarakut është e lidhur kryesisht me garantimin e mbrojtjes dhe sigurisë së vendit, detyrim ky i ngulitur thellë në qenien e ndërgjegjen e tij, bashkë me përgjegjësinë për ta përmbushur atë ndaj shtetit dhe qytetarëve. Është ky devocion dhe përgjegjësi në mbrojtje të jetës dhe pronës së bashkëkombësve të tyre, që e bën ushtarakun një profesion të respektuar nga ana e popullsisë civile.

Gjatë kësaj periudhe, duke iu përgjigjur ndryshimeve të mëdha demokratike të vendit, Forcat e Armatosura në mënyrë graduale janë transformuar për t'ju përshtatur nga pikëpamja strukturore dhe konceptuale kalimit nga një ushtri stërmadhe ku në qendër ishte mbrojtja kryesisht në nivelet kombëtare, në një strukturë dhe mentalitet të ri, që shprehet në koncepte e dimensione të reja bashkëpunimi, me



synim realizimin e sigurisë kombëtare dhe asaj kolektive në kuadër të NATO-s si dhe mbrojtjes së qytetarit.

Ne kemi arritur të transformojmë Forcat tona të Armatosura në një forcë të vogël, të përgatitur si nga pikëpamja profesionale ashtu edhe të ndërveprueshme për të qenë e aftë t'i përgjigjet dhe të përballet me nevojat e kërkesat e Aleancës, tashmë si anëtare më e re e saj, me objektivin për ta kthyer atë në tërësisht profesioniste duke filluar nga viti 2010.

Në këtë kontekst, dëshiroj gjithashtu të theksoj se i tërë ky proces transformimi dhe zhvillimesh që gjatë kësaj periudhe është drejtuar nga institucionet civile të vendit, ka kërkuar angazhime të mëdha por edhe sakrifica nga ana e ushtarakëve. Të gjithë jemi dëshmitarë se jo gjithnjë ky proces ka ecur pa u shoqëruar me probleme të cilat kanë shtruar si domosdoshmëri rishikimin dhe përmirësimin e raporteve mes lidërshiptit politik dhe atij ushtarak.

Në disa raste, gjatë këtyre viteve ka pasur edhe mosdakordësi në lidhje me një numër kompetencash dhe të drejtash që kanë apo që duhet të kenë palët. Gjykoj se kjo ka ardhur si rezultat i moskuptimit të qartë nga të gjithë faktorët të rolit që marrin marrëdhëniet civilo-ushtarake dhe kontrolli civil mbi Forcat e Armatosura në kuadrin e shtetit juridik, por në ndonjë rast edhe të mosdëshirës për t'i zbatuar parimet e kësaj marrëdhënie të ndërsjellët si nga drejtuesit ushtarakë, ashtu edhe nga lidërshipi civil.

Nisur nga parashtrimi i mësipërm, mendoj se stadi aktual në të cilin ndodhemi kërkon që marrëdhëniet civilo-ushtarake në tërësi si dhe realizimi i kontrollit demokratik mbi veprimtarinë e Forcave të Armatosura në veçanti duhet t'i nënshtrohen një analize të gjerë prej të gjithë aktorëve që janë pjesë e këtyre marrëdhënieve. Ka ardhur koha për ndërmarrjen e hapave konkretë me synim përmirësimin e tyre në të gjitha aspektet, në mënyrë të veçantë në përcaktimin më të saktë për mënyrën e ushtrimit të kompetencave në drejtimin dhe komandimin e Forcave të Armatosura, si dhe në menaxhimin e personelit të tyre.

Në parim, kontrolli demokratik mbi Forcat e Armatosura dhe veprimtarinë për përmbushjen e misionit të tyre kushtetues, realizohet

nëpërmjet kompetencave kushtetuese dhe ligjore të përcaktuara qartë. Është në natyrën e shtetit demokratik, që lidhshipi civil politik dhe ekzekutiv, të hartojë politika dhe strategji, të iniciojë e amendojë ligje, të marrë vendime për dërgimin e forcave në misione jashtë vendit, të rishikojë e kontrollojë zbatimin e buxhetit, të realizojë prokurime, të kontrollojë zbatimin e politikave për përgatitjen dhe menaxhimin e personelit si dhe të kërkojë llogari për realizimin e detyrave në shërbim të misionit.

Nga ana tjetër, është detyrë e lidhshipit ushtarak që këto politika t'i kthejë në terma ushtarakë për të kryer komandimin unik të Forcave të Armatosura, duke qenë përgjegjës për krijimin e një force luftarake të aftë për të plotësuar misionin e vet kushtetues, hartimin e doktrinave ushtarake, drejtimin e përgatitjes dhe gatishmërisë luftarake të këtyre forcave, sigurimin e plotësimit me personel, si dhe drejtimin e organizimit e veprimeve ushtarake dhe jo ushtarake.

Mbi këtë bazë, duke qenë palë që punojnë për realizimin e një qëllimi të përbashkët në kuadër të shtetit të së drejtës, kërkohet që secila prej tyre të zbatojë kompetencat e veta të përcaktuara në ligj dhe të mos ndërhyjnë apo marrin kompetencat e njëra-tjetrës. Parë në këtë këndvështrim, marrëdhëniet civile-ushtarake dhe ushtrimi i kontrollit demokratik mbi Forcat e Armatosura përbëjnë një sfidë për të sotmen dhe të ardhmen.

Paketa ligjore mbi të cilën mbështetet aktualisht veprimtaria e Forcave të Armatosura, por edhe ushtrimi i kontrollit demokratik mbi to, ka nevojë të përmirësohet në përputhje me përvojat e vendeve anëtare të NATO-s, me qëllim realizimin e ***një ndarje më të qartë e të balancuar të kompetencave midis lidhshipit civil politik dhe ekzekutiv me atë të lidhshipit ushtarak.***

Për të realizuar këtë, jam i mendimit se puna duhet të fillojë me Kushtetutën si dhe me ligjet organike bazë të Forcave të Armatosura, që rregullojnë marrëdhëniet që kanë të bëjnë me pushtetet dhe autoritetet e komandimit dhe të drejtimit strategjik të Forcave të Armatosura, statusin e ushtarakut, ecurinë në grada dhe karrierën ushtarake, menaxhimin e trajtimit e personelit etj.

Ndryshimi i këtij legjislacioni dhe përafrimi i tij me modelet e tjera të vendeve anëtare të NATO-s, bëhet i nevojshëm për disa arsye, ku në mënyrë të veçantë dua ta vë theksin në disa prej tyre:

**Së pari**, rritjen e ndërveprueshmërisë dhe lehtësimit të procedurave në veprimtaritë e përbashkëta me NATO-n, të cilat kërkojnë në parim një decentralizim të kompetencave sidomos në fushën e veprimit me mision.

**Së dyti**, për të plotësuar e saktësuar më mirë kompetencat e autoriteteve shtetërore civile në drejtimin e Forcave të Armatosura në kohë paqe dhe kohë lufte, si dhe në strukturimin e përdorimin kushtetues të tyre.

**Së treti**, për të ndarë më saktë kompetencat midis lidërshiptit politik dhe ekzekutiv me lidërshiptin ushtarak në fushat e menaxhimit të personelit ushtarak dhe buxhetit, duke i dhënë më shumë kompetenca lidërshiptit ushtarak, pasi në realitet këto kompetenca janë të kufizuara edhe në krahasim me ndarjen ligjore të këtyre kompetencave në agjencitë e tjera shtetërore që operojnë në fushën e sigurisë, si janë Policia e Shtetit, Garda e Republikës, Policia e Burgjeve etj.

**Së katërti**, përputhjen e paketës ligjore të Forcave të Armatosura, me legjislacionin e përgjithshëm të shtetit që vepron mbi veprimtarinë e këtyre forcave, sidomos në fushat e zbatimit të buxhetit, marrëdhënieve të punës, pronës publike, prokurimeve etj. Kjo është e nevojshme për të kapërcyer disa vështirësi, të cilat burojnë nga fakti se këto ligje operojnë duke pasur parasysh sistemin e përgjithshëm të qeverisjes së vendit dhe administratën publike brenda ekzekutivit në përgjithësi, dhe në disa raste, nuk mbajnë parasysh specifikat që paraqesin degë të veçanta të ekzekutivit, si janë Ministria e Mbrojtjes dhe Forcat e Armatosura.

Sa për ilustrim, më lejoni t'ju ofroj një shembull konkret. Ligji “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, duke mos pasur parasysh veçoritë që përmenda më lart, shmang Shtabin e Përgjithshëm dhe shefin e Shtabit të Përgjithshëm nga përgjegjësitë e përcaktuara në ligjin mbi pushtetet dhe autoritetet e komandimit dhe drejtimit strategjik të Forcave të Armatosura, për planifikimin, programimin e buxhetimin e mbrojtjes, si dhe për menaxhimin e

përdorimin e frytshëm të burimeve financiare. Këto kompetenca, ligji mbi buxhetin, ia kalon “Nëpunësit autorizues” në Ministrinë e Mbrojtjes, funksion që kryhet nga Sekretari i Përgjithshëm, i cili, sipas akteve ligjore në fuqi, drejton administratën civile në Ministrinë e Mbrojtjes dhe nuk bën pjesë në zinxhirin kushtetues të drejtimit dhe komandimit të Forcave të Armatosura. Pra nëse bëjmë një analizë të plotë, mund të dilet në përfundimin se, prej të gjithë aktorëve që veprojnë në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë së vendit, qofshin këta politikë, ekzekutivë, ushtarakë, por dhe të shoqërisë civile, kërkohet si domosdoshmëri, një kuptim më i gjerë teorik i rolit që kanë ushtrimi i kontrollit demokratik mbi Forcat e Armatosura dhe rritja e cilësisë së marrëdhënieve civile-ushtarake, si dhe ndërgjegjësimi i mëtejshëm i tyre për ndërmarrjen e hapave konkretë, që këto instrumente politike e shoqërore të vendosen e veprojnë në një shtrat ligjor të përshtatshëm dhe bashkëkohor.

Në përfundim të fjalës sime, më lejoni të shpreh gatishmërinë e Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura si dhe timen personale, për të marrë pjesë dhe për të përfituar nga diskutimi dhe debati në tryeza të tilla, që i bëjnë më të afërta Forcat e Armatosura me shoqërinë civile, në kuadrin e arritjes së qëllimit të përbashkët, rritjen e sigurisë dhe mbrojtjes së vendit si dhe integrimin e mëtejshëm të tij në hapësirat euroatlantike.

**ARIAN DYRMISHI**

(EKSPERT I LARTË I IDN-së)

---

## VLERËSIM I STRUKTURAVE VENDIMMARRËSE TË SIGURISË KOMBËTARE NË SHQIPËRI

### Abstrakt

*Mënyra se si politikat e sigurisë konceptohen, miratohen, zbatohen dhe vlerësohen është e rëndësishme për vendin dhe mirëqenien e qytetarëve. Për të realizuar procesin e vendimmarrjes dhe për të zhvilluar këto politika është e nevojshme që të krijohen institucione të mirorganizuara dhe me legjitimitet. Ky studim analizon Strukturat Vendimmarrëse të Sigurisë Kombëtare dhe përpiqet të vlerësojë se sa ato janë të përshtatshme dhe të mirëkoordinuara për të gjeneruar politika sigurie të qëndrueshme dhe garantuar zbatim efektiv të tyre.*

### Hyrje

Ky studim analizon zhvillimet institucioneve përgjegjëse për vendimmarrjen dhe koordinimin për politikat e sigurisë kombëtare dhe përpiqet të bëjë një vlerësim të tyre.

Në pjesën e parë trajtohet koncepti mbi të cilën bazohet nevoja e krijimit të institucioneve vendimmarrëse dhe koordinuese të politikave të sigurisë kombëtare. Nga pikëpamja institucionale, eksperiencia e krijimit të strukturave të tilla është relativisht e re dhe fillon në SHBA pas Luftës së Dytë Botërore.

Pjesa e dytë analizon zhvillimin vendimmarrës dhe koordinues të politikave të sigurisë kombëtare në Shqipëri. Studimi hedh një vështrim

retrospektiv mbi ecurinë e zhvillimit të këtyre strukturave përgjatë tre periudhave duke analizuar rrethanat dhe faktorët që kanë ndikuar në mënyrën si janë ndërtuar dhe si kanë funksionuar ato. Gjetjet tregojnë se ndarja në tre periudha përkon me ndryshime kushtetuese, çka lë të kuptohet se ndryshime të mundshme në të ardhmen do të duhet të mbështeten në amendamente kushtetuese.

Në dy pjesët e fundit parashtrohen disa konkluzione se përse institucionet përgjegjëse për koordinimin dhe integrimin e politikave të sigurisë janë të dobëta, jo në përshtatje me sistemin politik dhe nevojat e vendit dhe rrjedhimisht jo në gjendje për të gjeneruar politika të qëndrueshme dhe garantuar zbatimin me efikasitet të tyre, si dhe disa rekomandime.

### Nevoja e ekzistencës së Strukturave Vendimmarrëse të Sigurisë Kombëtare

Në shumë vende të botës Strukturat Vendimmarrëse të Sigurisë Kombëtare (SVSK)<sup>1</sup> janë element i rëndësishëm për zhvillimin, koordinimin dhe mënyrën se si shprehen politika e jashtme, e mbrojtjes apo politika të tjera që sigurojnë mirëqenien e vendit.<sup>2</sup> Një organizëm i tillë u ngrit për herë të parë në SHBA në vitin 1947, nën emërtimin Këshilli i Sigurisë Kombëtare (KSK), kur Kongresi i SHBA-së propozoi që të miratohej një legjislacion, i cili do të shërbente për të menaxhuar çështjet e sigurisë kombëtare.<sup>3</sup> Kongresi propozoi gjithashtu krijimin e një aparati brenda ekzekutivit, i cili do të shërbente për të integruar dhe koordinuar politikat e institucioneve dhe agjencive të ndryshme të

---

<sup>1</sup> Termi **Strukturat Vendimmarrëse të Sigurisë Kombëtare** është huazuar nga studimi 'National Security Decision-Making Structures and Security Sector Reform', RAND Corporation, 2005. Termi është një gjetje përgjithësuese dhe nuk presupozon ndonjë preferencë ndaj ndonjë modeli të caktuar.

<sup>2</sup> Alan G. Whittaker, Frederick C. Smith, Elizabeth McKune, (2008). *The National Security Policy Process: The National Security Council and Interagency System*. (Research Report, November 15, 2008 Annual Update), Washington D.C.: Industrial College of the Armed Forces, National Defence University, U.S. Department of Defence.

<sup>3</sup> Cody M. Brown, 'Project on National Security Reform, *The National Security Council: A Legal History of the President's Most Powerful Advisors*' (2008)

vendit dhe për të këshilluar Presidentin për çështje dhe interesa të sigurisë kombëtare.<sup>4</sup>

Pas kësaj eksperience vende të ndryshme kanë ndërtuar dhe zhvilluar modelet e tyre të organizimit dhe funksionimit, të cilat kanë qenë rezultat i sistemit politik, strukturave institucionale pararendëse si dhe nevojave specifike apo stilit të zyrtarëve më të lartë.<sup>5</sup> Sidoqoftë, modeli i KSK në SHBA konsiderohet si modeli më i fuqishëm. KSK shërben si një forum në të cilin iniciohen dhe formulohen politika të reja dhe ku Presidenti, këshilltarët dhe anëtarët e kabinetit qeverisës diskutojnë për politikat e brendshme, të jashtme dhe të mbrojtjes, që lidhen me sigurinë kombëtare. Stafi i KSK këshillon Presidentin për çështje të sigurisë kombëtare, koordinon institucionet e ndryshme të ekzekutivit në zhvillimin dhe formulimin e politikave, por pa u përfshirë vetë në zbatim.

Arsyetimi për krijimin e SVSK bazohet në nevojën për të pasur struktura që konsolidojnë dhe koordinojnë aspekte të ndryshme të sigurisë kombëtare. Strukturave të tilla mbështjellëse u kërkohet të koordinojnë politika, zbatojnë politika ose thjesht të bëjnë vlerësim të politikave si dhe të këshillojnë zyrtarisht ose jo zyrtarisht.<sup>6</sup> SVSK janë organizma me kompetenca vendimmarrëse ose këshillimore ose të dyja dhe në shumicën e rasteve janë të krijuara me kushtetutë, ligj ose dekret dhe kryejnë një sërë funksionesh:

- Vlerësimin e politikave të ndryshme që lidhen me sigurinë
- Vendosjen e prioriteteve të sigurisë
- Këshillim për politika që lidhen me sigurinë
- Koordinimin e tyre
- Shpërndarjen e burimeve
- Koordinim emergjencash

---

<sup>4</sup> Duhet nënvizuar se sistemi politik në SHBA është presidencial, ku Presidenti është kryetari i ekzekutivit dhe ka si kompetenca ekzekutive ashtu edhe të drejtën për të propozuar legjislacion. Në sistemet parlamentare, siç është dhe Shqipëria, këto kompetenca i ushtron Kryeministri.

<sup>5</sup> Bearne, Susanna, Olikier, Olga, O'Brien. Kevin A., Rathmell. Andrew, 'National Security Decision-Making Structures and Security Sector Reform', RAND Corporation, 2005

<sup>6</sup> Ibid

- Mbikëqyrjen e zbatimit të politikave për çështje të mbrojtjes dhe sigurisë
- Çështje të tjera të rëndësishme si emërimet zyrtarësh të lartë, hartimi i Strategjisë së Sigurisë Kombëtare etj.

Në përgjithësi SVSK luajnë një rol qendror menaxhues për politikën e sigurisë, por shërbejnë edhe si një organ i pavarur këshillimor për zyrtarët më të lartë vendimmarrës,<sup>7</sup> që në varësi të sistemit politik mund të jenë Presidenti ose Kryeministri.

Një tjetër aspekt i rëndësishëm por që ka justifikuar krijimin e SVSK është se një strukturë e tillë siguron që vlerësimi i kërcënimeve dhe vendimmarrja në fushën e sigurisë të mos bëhet brenda kufijve të veçuar të institucioneve të mbrojtjes, policisë apo shërbimeve informative, por të dalë nga kufijtë e tyre dhe të kryhet nga zyrtarë të lartë civilë të ekzekutivit.

Por faktorë kyç që garantojnë që SVSK të kryejë funksionet në mënyrë efektive janë përbërja dhe shkalla e kompetencave që i jepen. Kështu, në këto struktura marrin pjesë institucione të rëndësishme të përfshira në çështje të sigurisë si dhe sektorë civilë të politikave, si: financat, politika e jashtme, ekonomia dhe drejtësia. Kjo përbërje bën të mundur një analizë më holistike mbi çështjet e politikave të jashtme, sigurisë dhe mbrojtjes.

### Strukturat Vendimmarrëse të Sigurisë Kombëtare në Shqipëri

Siç u tha më sipër, mënyra e organizimit dhe funksionimit të SVSK në shumë vende ka qenë rezultat i kombinimit të një sërë faktorësh, si: sistemi politik, trashëgimia institucionale, mënyra e qeverisjes dhe sjelljes së drejtuesve më të lartë si dhe evoluimi i konceptit të mbrojtjes, i cili e ka zhvendosur fokusin nga siguria e brendshme territoriale drejt një dimensionit gjithnjë edhe më ndërkombëtar.

Rasti i Shqipërisë duket se përfshihet tërësisht në këtë model. E analizuar në këtë kuadër, për mënyrën se si këto struktura janë organizuar dhe kanë funksionuar, dallohen tre periudha kryesore:

---

<sup>7</sup> John E. Tedstrom, 'Establishing a National Security Council: Lessons for the Federal Republic of Yugoslavia', DCAF Working Paper Series - No.15, Geneva, April, 2002



- Përpara vitit 1991
- 1991-1998
- 1998 dhe në vazhdim

Deri në vitin 1985 autoriteti më i lartë i mbrojtjes dhe sigurisë në vend ishte Sekretari i Parë i Komitetit Qendror të Partisë së Punës (SPKQPP), i cili megjithëse nuk kishte asnjë funksion ekzekutiv zyrtar merrte vendimet më të rëndësishme në fushën e sigurisë, të cilat dilnin në formatin e platformave të partisë dhe ishin të detyrueshme për të gjitha institucionet e interesuara. Në vitin 1985, kur SPKQPP u zgjodh Ramiz Alia, i cili ishte Presidenti i Republikës në fuqi, erdhi dhe shkrirja e dy funksioneve në një person.<sup>8</sup>

Për hir të kësaj analize, kjo periudhë mund të mos kishte pasur rendësi në qoftë se nuk do të ishte për trashëgiminë institucionale dhe mënyrën se si ndodhën proceset e transformimit të sistemit politik në vitet 1991-1992.

Rënia e sistemit njëpartiak dhe vendosja e shtetit ligjor do të thoshte se ashtu si edhe aspekte të tjera të politikave publike, edhe siguria e vendit dhe koordinimi i institucioneve të ngarkuara me këtë mision do të vendosej mbi baza kushtetuese dhe ligjore. Zhvillimet politike të fillimit të vitit 1991, të cilat përkrijnë me kohën kur po hartohej dhe drafti i kushtetutës që pritej të miratohej nga parlamenti i parë pluralist, po e bënë të dukshme që forca fituese do të ishte përsëri Partia e Punës. Kështu hartuesit e kushtetutës, të cilët vinin nga brenda sistemit ekzistues, e shkruan kushtetutën duke pasur në mend që Presidenti i ardhshëm do të ishte përsëri Ramiz Alia.<sup>9</sup> Ky draft, i cili nuk arriti të miratohej si kushtetutë por si *Ligji për Dispozitat Kryesore Kushtetuese (LDKK)* dhe që për rrethana dhe shkaqe të komentuarra gjerë tashmë ngeli në fuqi deri në vitin 1998, megjithëse parashikonte një republikë parlamentare, i kalonte Presidentit kompetenca të gjera ekzekutive si dhe të drejtën e iniciativës ligjvënëse.<sup>10</sup> Me këto kompetenca Presidenti ishte shefi de facto i ekzekutivit me

---

<sup>8</sup> Raymond Zickel and Walter R. Iwaskiw, eds. 'Albania: A Country Study'. Washington: GPO for the Library of Congress, 1994.

<sup>9</sup> Jon Elster, 'Approaching Democracy: A New Legal Order for Eastern Europe', *The University of Chicago Law Review*, Vol. 58, No. 2, (Spring, 1991), pp. 447-482

<sup>10</sup> *Ligji nr. 7491, datë 29.4.1991, "Për dispozitat kryesore kushtetuese"*.

kompetencat më të larta në fushën e politikës së jashtme dhe të mbrojtjes si Komandant i Përgjithshëm i Forcave të Armatosura.

LDDK krijoi Këshillin e Mbrojtjes (KM) si një autoritet vendimmarrës dhe koordinues në varësi të Presidentit me mision “drejtimin, organizimin e mobilizimin e të gjitha forcave dhe të burimeve të vendit për mbrojtjen e Atdheut”.<sup>11</sup> Për përbërjen e KM, e cila miratohej nga parlamenti me propozim të Presidentit, shih tabelën 1.<sup>12</sup>

Përveç funksionit këshillues, me shumicë votash, KM kishte kompetenca për të marrë vendime, të cilat qeveria ishte e detyruar t’i zbatonte.<sup>13</sup> Këshilli i Ministrave drejtonte veprimtarinë për plotësimin e këtyre detyrave, në përputhje me vendimet e Këshillit të Mbrojtjes.<sup>14</sup>

Kompetencat e KM reflektojnë dhe konceptin e sigurisë në fillim të viteve ’90, i cili bazohej në mbrojtjen e vendit dhe rrjedhimisht fokusi ishte mbi Forcat e Armatosura (FA). Disa nga këto kompetenca përfshinin: përpunimin e udhëzimeve ushtarake për përgatitjen e vendit për mbrojtje; përcaktimin e strukturës së FA; krijimin e shtabeve të mbrojtjes; përcaktimi i mbrojtjes operativo-strategjike; shqyrtimi i masave për ruajtjen e rendit publik në rast gjendje të jashtëzakonshme ose lufte.<sup>15</sup> Po kështu, edhe kompetencat e Presidentit si Kryetar i KM ishin tërësisht me fokus FA, si: miratimi i planit operativ strategjik të mbrojtjes, emërimi i shefit të Shtabit të Përgjithshëm, dhënia e masave disiplinore për gjeneralët, vendosja e shkallëve të gatishmërisë, vendimi për përdorimin e FA në operacione ushtarake.<sup>16</sup>

Megjithëse i kufizuar vetëm në çështje të mbrojtjes, koncepti i nevojës së koordinimit ishte i qartë dhe i reflektuar si në kushtetutë ashtu edhe në ligjin organik për funksionimin e KM.

<sup>11</sup> *Ligji nr. 7491, datë 29.4.1991, “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, Neni 32.*

<sup>12</sup> Vendim i Kuvendit Popullor, nr. 214, datë 11.12.1991 dhe Vendim i Kuvendit Popullor, nr. 319, datë 05.08.1997.

<sup>13</sup> *Ligji nr. 7528, datë 11.12.1991, “Për funksionet e Këshillit të Mbrojtjes dhe të Komandantit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura”.*

<sup>14</sup> *Ligji nr. 7491, datë 29.4.1991, “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, Neni 36, pika 4.*

<sup>15</sup> *Ligji nr. 7528, datë 11.12.1991, “Për funksionet e Këshillit të Mbrojtjes dhe të Komandantit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura”, Neni 5.*

<sup>16</sup> *Ligji nr. 7528, datë 11.12.1991, “Për funksionet e Këshillit të Mbrojtjes dhe të Komandantit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura”, Neni 8.*

Duke reflektuar problematikat e reja të sigurisë, që nuk lidheshin vetëm me mbrojtjen dhe FA, në vitin 1995 u krijua pranë Këshillit të Ministrave një organ tjetër koordinues, Komiteti i Politikës së Sigurimit Kombëtar (KPSK). KPSK, u krijua si organ konsultativ i Këshillit të Ministrave, me synim koordinimin dhe përcaktimin e politikave qeveritare në fusha të rëndësishme të veprimtarisë shtetërore.<sup>17</sup> Misioni KPSK ishte shqyrtimi i çështjeve të rendit publik, të mbrojtjes, të politikës së jashtme dhe integritimit europian, si dhe shqyrtimi dhe propozimi i projektligjeve e projektvendimeve të rëndësishme për sigurinë kombëtare.<sup>18</sup>

Nisur nga misioni dhe synimet, është e qartë se KPSK është rezultat i njohjes së realiteteve të reja të sigurisë. Por është e paqartë se përse u krijua një organ tjetër koordinimi kur mund të kishte qenë më me vend që të zgjerohej fusha e veprimit të KM, i cili do të funksiononte si organi i vetëm i koordinimit për të gjitha çështjet e sigurisë dhe do të ishte shmangur dhe fragmentimi institucional që u mbijetoi ndryshimeve kushtetuese dhe vazhdon të ekzistojë edhe sot.

Gjatë kohës së kryerjes së këtij studimi, nuk u gjetën të dhëna për të vlerësuar rolin e KPSK dhe shkallën e koordinimit midis dy autoriteteve koordinuese për periudhën dyvjeçare deri në shpërthimin e krizës së skemave piramidale.

Pas krizës së vitit 1997 dhe rotacionit politik që pasoi, prioritet për mazhorancën e re ishte miratimi i kushtetutës dhe rindërtimi i sistemit të shkatërruar të sigurisë. Ka pak të dhëna për rolin që ka luajtur Presidenti dhe KM gjatë periudhës 1997-1998 si për vendime për çështje të sigurisë në vend ashtu edhe për mënyrën se si do të përcaktoheshin në kushtetutë kompetencat e reja të autoriteteve të rëndësishme në vendimmarrje për çështje të sigurisë kombëtare. Në këtë periudhë, deri në miratimin e Kushtetutës, megjithëse kompetencat e Presidentit dhe KM vazhdonin të ishin të pandryshuara, vendimet më të rëndësishme

---

<sup>17</sup> *KPSK drejtohej nga Kryeministri dhe përbëhej nga ministri i Brendshëm, ministri i Mbrojtjes, ministri i Drejtësisë, ministri i Punëve të Jashtme dhe kryetari i Shërbimit Informativ Kombëtar. Me ftesë mund të merrte pjesë edhe Prokurori i Përgjithshëm.*

<sup>18</sup> VKM nr. 81, datë 6.2.1995, "Për rregullat e funksionimit të Këshillit të Ministrave", Neni 8.

për çështjet e sigurisë merreshin nga Kryeministri dhe KPSK.<sup>19-20</sup> Por koordinimi nga kjo strukturë ishte i dobët, mbledhjet bëheshin pa kalendar të rregullt dhe KPSK nuk kishte ekspertizën e duhur për të shërbyer si filtër për vendimet e Këshillit të Ministrave dhe për të kontribuar me sukses në procesin e zhvillimit të politikave të sigurisë kombëtare.<sup>21</sup>

Është e dukshme se ka pasur mungesë vizioni për mënyrën e ndërtimit të strukturave vendimmarrëse për integrimin dhe koordinimin e politikave të sigurisë, pasi kjo manifestohet jo vetëm në kushtetutë por edhe në ligjet që u miratuan në vijim dhe në praktikat institucionale të ndjekura.

Kushtetuta e vitit 1998 e rikonfirmoi Shqipërinë si republikë parlamentare, me Kryeministër më të fortë dhe me President me kompetenca më të kufizuara krahasuar me ato të mëparshmet.<sup>22</sup> *Edhe me kushtetutën e re Presidenti vazhdon të jetë Komandant i Përgjithshëm i FA, por tashmë këtë kompetencë ai e ushtron nëpërmjet Kryeministrit dhe ministrit të Mbrojtjes. Në fakt, ushtrimi nga një autoritet i një kompetence nëpërmjet një tjetri nënkupton delegim të kompetencës. Pra, ajo që është kundërthënëse është se këto kompetenca nuk i janë dhënë Kryeministrit, i cili de facto, edhe nëpërmjet Këshillit të Ministrave, është autoriteti më i lartë vendimmarrës, por i janë dhënë Presidentit për t'iu deleguar po me kushtetutë Kryeministrit dhe ministrit të Mbrojtjes. Kështu, Kushtetuta përcakton Këshillin e Ministrave si autoriteti që “përcakton drejtimit kryesore të politikës së përgjithshme shtetërore” dhe Kryeministrin si autoriteti që “koncepton dhe paraqet drejtimit kryesore të politikës së përgjithshme shtetërore dhe përgjigjet për to”.*<sup>23</sup> Kështu, Presidenti është veçse zbatues i këtyre

---

<sup>19</sup> ‘Nano says aid for Kosova refugees increases’, Albanian Telegraphic Agency (ATA), 16 July 1998,

<sup>20</sup> ‘Albanian Premier Orders Action against Organized Crime’, Radio Free Europe/Radio Liberty, Vol. 2, No. 145, 31 July 1998,

<sup>21</sup> Albania, Centre of Government Profile, [as at April 1998], SIGMA, Support for Improvement in Governance and Management,

<sup>22</sup> Constitution Watch, Albania Update, East European Constitutional Review, Volume 7, Number 3, Summer 1998.

<sup>23</sup> Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, Neni 100 dhe 102.

politikave sepse në Kushtetutë nuk i jepet asnjë kompetencë propozuesi apo formuluesi politikash.

Kompetenca më të forta të Presidentit sipas kushtetutës janë ato të emërimit dhe shkarkimit të Komandantit të Forcave të Armatosura, të komandantëve të forcave tokësore, detare dhe ajrore, emërimit të drejtorit të Shërbimit Informativ të Shtetit, kompetenca të cilat ai nuk mund t'i ushtrojë pa pasur një propozim formal nga Kryeministri. Por si do të demonstrohej dhe në praktikë në vitet që do të pasonin, këto kompetenca kanë më shumë peshë vetëm kur Kryeministri kërkon të shkarkojë ndonjë nga titullarët e sipërpërmendur. Vetëm me këto kompetenca dhe duke pasur parasysh faktin se me kushtetutën e re Presidenti nuk ka kompetencë për të iniciuar ligje, vendosja e Këshillit të Sigurimit Kombëtar (KSK) si organ këshillimor mund të konsiderohet si një recetë për dështim, pasi sfera e veprimit të tij ngushtohet mjaft nëse do ta krahasojmë me funksionet tipike të një autoriteti të tillë, siç u përmend në pjesën hyrëse të këtij studimi.

*Këto paqartësi u manifestuan shumë shpejt kur, pothuajse në të njëjtën ditë menjëherë pas dekretimit të Kushtetutës, Presidenti iu drejtua Gjykatës Kushtetuese për të qartësuar statusin e Këshillit të Sigurimit Kombëtar, zëvendësimin e KM dhe rolin e tij si Komandant i Përgjithshëm i FA, duke konsideruar se ekzistenca njëkohësisht e ligjit për KM dhe e Kushtetutës krijonin një situatë ligjore kontradiktore.<sup>24</sup> Gjykata Kushtetuese vendosi se dispozitat e ligjit që përcakton funksionet e KM nuk janë të zbatueshme dhe se në Kushtetutë “pranohet drejtimi unik i Forcave të Armatosura, duke u suprimuar Këshilli i Mbrojtjes si organ kolegjal e vendimor”.<sup>25</sup> Tre muaj më vonë, parlamenti miratoi një ligj të ri ku përcaktoheshin kompetencat e Presidentit si Komandant i Përgjithshëm i Forcave të Armatosura dhe Këshillit të Sigurimit Kombëtar. Ligji rikonfirmonte Presidentin si Komandant i Përgjithshëm i FA në kohë paqeje dhe në kohë lufte, i cili*

<sup>24</sup> Constitutional Watch: Albania Update, East European Constitutional Review, Volume 8, Numbers 1-2, Winter-Spring 1999.

<sup>25</sup> Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 77, datë 31.12.1998. Me objekt interpretimin e nenit 178, pika 1, të Kushtetutës në lidhje me zbatimin e ligjit nr. 7528, datë 11.12.1991, “Për funksionet e Këshillit të Mbrojtjes dhe të Komandantit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura”.

e ushtron këtë funksionon nëpërmjet Kryeministrit dhe ministrit të Mbrojtjes, si dhe kompetencat emëruese të sanksionuara në kushtetutë. Si Komandant i Përgjithshëm i FA, Presidenti vazhonte të kishte edhe me këtë ligj kompetenca të ngjashme me ato të mëparshmet, si: miratimi i planit operativ strategjik të mbrojtjes dhe strukturës organizative të FA, emërimi i shefit të Shtabit të Përgjithshëm, dhënia e masave disiplinore për gjeneralët, vendosja e shkallëve të gatishmërisë, vendimi për përdorimin e FA në operacione ushtarake, të drejtën për t'i propozuar Kuvendit shpalljen e gjendjes së luftës etj.<sup>26</sup> Roli i KSK u ripërcaktua në përputhje me kushtetutën si organ këshillimor i Presidentit të Republikës në fushën e sigurisë kombëtare me detyrë “për të ndihmuar atë në drejtimin, organizimin dhe mobilizimin e burimeve njerëzore dhe materiale për sigurimin kombëtar të vendit”.<sup>27</sup>

Formulimi i detyrës së KSK, e cila ndryshon nga formulimi i detyrës së KM vetëm se në vend të “mbrojtjes së vendit” përcakton si objektivi “sigurimin kombëtar” tregon në fakt evoluimin e mjedisit dhe konceptit të sigurisë, i cili kishte marrë dimension më të gjerë se sa mbrojtja e integritetit të vendit. Por përveç se ligji i jep kompetenca tepër të zbehta KSK, “diskuton dhe jep mendime”, fokusi i tyre përsëri vazhdon të jetë me orientim pothuajse tërësisht ushtarak.<sup>28</sup> Përbërja e KSK ndryshoi duke e rritur numrin e institucioneve të përfshira (Shih tabelën 1).

Strategjia e Sigurisë Kombëtare e miratuar në janar të vitit 2000, në kapitullin ku përcakton përgjegjësitë kushtetuese të udhëheqjes strategjike të sigurimit, përcakton Presidentin e Republikës si “funksionari më i lartë përgjegjës për realizimin e misionit, parimeve e objektivave të sigurimit të vendit dhe mbrojtjen e zhvillimin e interesave kombëtare” dhe për herë të parë shfaqet si detyrë kryesore e KSK “formulimi dhe miratimi i strategjisë së sigurimit të Republikës së Shqipërisë, të cilën e paraqet për miratim në parim në Kuvend”. Këshilli

---

<sup>26</sup> Ligji nr. 8467, datë 31.3.1999, “Për kompetencat e Presidentit të Republikës si Komandant i Përgjithshëm i Forcave të Armatosura dhe të Këshillit të Sigurimit Kombëtar”, Neni 8.

<sup>27</sup> Ligji nr. 8467, datë 31.3.1999, Neni 7.

<sup>28</sup> Ligji nr. 8467, datë 31.3.1999, Neni 8.

i Ministrave përcaktohet si përgjegjës për zbatimin e strategjisë së sigurimit dhe përcaktues i drejtimeve kryesore të politikës së sigurimit, të cilat i parashtron në KSK. Ndërsa Kryeministri përcaktohet si autoriteti që “koncepton dhe paraqet drejtimit kryesore të politikës së sigurimit dhe siguron bashkërendimin e zbatimit e tyre në përputhje me ligjet dhe Kushtetutën”.<sup>29</sup>

Kompetencat e Presidentit dhe të KSK u ripërcaktuan përsëri në tetor të vitit 2000 me ligjin për pushtetet dhe autoritetet e komandimit e të drejtimit strategjik të FA, i cili e shfuqizoi ligjin për *kompetencat e Presidentit si Komandant i Përgjithshëm i FA dhe të KSK*. Në këtë ligj u përcaktuan në mënyrë të harmonizuar kompetencat e pushteteve dhe autoriteteve të komandimit dhe të drejtimit strategjik për FA. KSK në këtë ligj përcaktohet si ndihmës i Presidentit në çështje të sigurisë dhe të mbrojtjes së vendit dhe që “diskuton dhe jep mendime për çështje të politikës së sigurimit, të politikës së mbrojtjes, të armëkontrollit dhe për të gjitha çështjet e sigurisë e të mbrojtjes”.<sup>30</sup>

Dokumenti nuk përcakton se kush është mekanizmi që siguron se “diskutimet dhe mendimet” e hedhura në KSK të bëhen pjesë e procesit të vendimmarrjes për çështje të sigurisë kombëtare, por që roli i KSK ka qenë i parëndësishëm është e dukshme po të shohim se gjatë mandatit të tij deri në vitin 2002, Presidenti e ka mbledhur këshillin vetëm dy herë.<sup>31</sup>

Me zgjedhjen e Presidentit me konsensus të gjerë në vitin 2002 u duk sikur u krijua një klimë më e përshtatshme bashkëpunimi politik dhe institucional. Në fjalën e tij të mbajtur në mbledhjen e *KPSK në gusht 2002, Kryeministri do të deklaronte:*

*“Duke vlerësuar iniciativën e Presidentit të Republikës për të vënë në veprim edhe këshillin që ai drejton, të Sigurimit Kombëtar, ne po*

---

<sup>29</sup> Ligji nr. 8572, datë 27.1.2000, “Për Miratimin e Dokumentit të Strategjisë së Sigurimit të Republikës së Shqipërisë” (33-34).

<sup>30</sup> Ligji nr. 8671, datë 26.10.2000, “Për Pushtetet dhe Autoritetet e Komandimit e të Drejtimit Strategjik të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, Neni 13.

<sup>31</sup> Sipas të dhënave të mara zyrtarisht mbi kalendarin e mbledhjeve të KSK nga zyra e Presidentit të Republikës kërkuar për qëllime të këtij studimi, KSK është mbledhur një herë më datë 14.11.1998, dhe një herë më datë 03.04.1999.

*zhvillojmë sot mbledhjen e Komitetit Ndërmnistror të Politikave të Sigurimit Kombëtar për të bërë më të lartë analizën dhe vendimmarrjen që reflekton situatat dhe ritmet e reja të punës së institucioneve tona. Pra, kjo mbledhje i paraprin logjikshëm dhe unë kam bindjen që po e strukturojmë funksionimin e një procedure pune normale dhe demokratike bashkëpunimi, edhe për raste të tjera, kur ka organizma homologe që drejton Presidenti i Republikës, ku marrin pjesë anëtarë të qeverisë ose të institucioneve të tjera dhe që konvergojnë në veprime të bashkërenduara për qëllime prioritare, që ne i kemi në program dhe institucionet e tjera që janë angazhuar në lidhje me sigurimin kombëtar dhe detyrat e integritit. Me këtë po konsolidojmë përfundimisht modelet e bashkëveprimit të institucioneve kushtetuese të shtetit shqiptar. Me respekt të plotë të parimit universal të balancave dhe ekuilibrave në funksionimin e pushteteve në një shoqëri demokratike. Duke pritur vlerësimet dhe mendimet tuaja rreth çështjeve që do të diskutohen besoj se do të arrijmë së bashku të formulojmë një dokument që do t'ia paraqesim edhe Presidentit të Republikës dhe Këshillit të Sigurimit Kombëtar, që ai drejton në këto funksione konvergjente.”<sup>32</sup>*

Në dukje, Presidenti i sapozgjedhur dhe Kryeministri, i cili edhe ai është rikthyer në këtë post pas dorëheqjes në vitin 1998, janë të prirur të sjellin një impuls të ri në këtë aspekt, duke lënë të kuptohet se arsyet e koordinimit të dobët deri në atë kohë kanë qenë voluntariste. Por nga ana tjetër, vihet në pah ekzistenca e dy autoriteteve koordinuese, të cilat paraqiten si të barabarta përballë njëra-tjetrës dhe nuk është e qartë se si realizohet koordinimi i tyre apo kush e ka fjalën e fundit.

Edhe pse legjislacioni i miratuar pas Kushtetutës së vitit 1998 i transferon shumë kompetenca Kryeministrit, i cili është *de facto* autoriteti me fuqinë më të madhe vendimmarrëse, përsëri është e paqartë se si ai e ushtron këtë autoritet dhe si përfshihen vendimet e marra nga KSK dhe Presidenti.

---

<sup>32</sup> Nga fjala e Kryeministrit Ministër Fatos Nano mbajtur në mbledhjen e Komitetit Ndërmnistror të Politikave të Sigurimit Kombëtar, 29 gusht 2002. Faqja zyrtare e Këshillit të Ministrave.



Disa muaj më vonë, në janar 2003, parlamenti miraton ligjin për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave ku përveç të tjerave përcaktohen dhe kompetencat e Kryeministrit, i cili përveç kompetencave të parashikuara në Kushtetutë, me miratimin e Këshillit të Ministrave, mund të marrë përsipër edhe detyra të tjera.<sup>33</sup> Po kështu ky ligj krijoi dhe Komitetet Ndërministrorë “si organe konsultative të Këshillit të Ministrave, ku diskutohen paraprakisht politikatat, çështjet e rëndësishme të veprimtarisë ekzekutive, si dhe projektaktet e një rëndësie të veçantë”.<sup>34</sup> Këto komitete kryesohen nga Kryeministri dhe përbërja, fusha e veprimtarisë që shqyrtojnë, përcaktohen me urdhër të tij. Ne rregulloren e re të Këshillit të Ministrave të miratuar në vijim të këtij ligji, Komiteteve Ndërministrorë u jepet një rol i rëndësishëm në procesin e formulimit të politikave,<sup>35</sup> por në rregullore nuk përmenden funksione të tjera që janë tipike për autoritete të koordinimit të sigurisë kombëtare.

Gjate periudhës 2002-2004 KPSK është mbledhur disa herë për të diskutuar dhe marrë vendime për çështje të ndryshme si përafrimi i legjislacionit dhe dokumenteve për lëvizjen e lirë në zonën Shengen dhe masave konkrete për këtë;<sup>36-37</sup> përforcimi i masave dhe kapaciteteve në luftën kundër terrorizmit,<sup>38</sup> koordinimi ndër-institucional për të unifikuar qëndrimet në çështjet e politikës së jashtme për përfshirjen në strukturat euroatlantike;<sup>39</sup> miratimi i projektit përfundimtar të dokumentit të Strategjisë së Sigurisë.<sup>40</sup>

---

<sup>33</sup> Ligji nr. 9000, datë 30.1.2003, “Për Organizimin dhe Funksionimin e Këshillit të Ministrave”, Neni 2.

<sup>34</sup> Ibid, Neni 11

<sup>35</sup> VKM nr. 584, datë 28.8.2003, “Për Miratimin e Rregullores së Këshillit të Ministrave”, Kreu V, Bashkëndimi i projektakteve.

<sup>36</sup> Mbledhja e Komitetit Ndërministror të Politikave të Sigurimit Kombëtar, datë 29.08.2002.

<sup>37</sup> Mbledhja e Komitetit Ndërministror të Politikave të Sigurimit Kombëtar, datë 28.01.2004.

<sup>38</sup> Mbledhje e Komitetit Ndërministror të Politikave të Sigurimit Kombëtar, datë 18.03.2003.

<sup>39</sup> Mbledhje e Komitetit Ndërministror të Politikave të Sigurimit Kombëtar, datë 10.06.2003.

<sup>40</sup> Mbledhje e Komitetit Ndërministror të Politikave të Sigurimit Kombëtar, datë 16.04.2004.

Megjithatë, edhe sipas raporteve ndërkombëtare për përmirësimin e qeverisjes, zyra e Kryeministrit paraqitet e fragmentuar nga ana organizative, me ndarje detyrash midis kabinetit politik dhe njërive administrative në varësi të Sekretarit të Përgjithshëm, të cilat nuk funksionojnë konform praktikave më të mira dhe të paafta për të garantuar një përfaqje koherente në mbështetje të aktivitetit kolektiv të Këshillit të Ministrave.<sup>41</sup>

Animi gradual i peshores së vendimmarrjes në anën e Kryeministrit është i dukshëm, megjithëse Presidenti gjatë kësaj kohe është më aktiv dhe përpiqet të vërë në efikasitet KSK, të paktën duke e mbledhur atë më shpesh dhe më rregullisht.<sup>42</sup> Rishikimi i Strategjisë së Sigurisë Kombëtare në nëntor të vitit 2004 solli një riformulim të ri të roleve të autoriteteve vendimmarrëse dhe koordinimit të tyre. Përveçse “koncepton dhe paraqet drejtimet kryesore të politikës së sigurimit dhe siguron bashkërendimin e zbatimit të tyre në përputhje me ligjet dhe Kushtetutën” Kryeministri sipas këtij dokumenti ka dhe kompetencën për të iniciuar rishikimin e strategjisë së sigurisë brenda një periudhe jo më vonë se tre vjet nga data e miratimit të saj. Po kështu strategjia e re ngarkon Kryeministrin me detyrën për të krijuar dhe drejtuar Komitetin e Politikave të Sigurimit Kombëtar.<sup>43</sup>

Edhe në këtë rast nuk është e qartë nëse ka pasur një pozicionim të KSK dhe Presidentit lidhur me këto ndryshime pasi sipas strategjisë ekzistuese të sigurisë formulimi dhe miratimi i strategjisë ishte detyrë e KSK. Vetë KSK ripërcaktohet si organ këshillues i Presidentit për çështje të sigurisë dhe mbrojtjes së vendit, si dhe të drejtimit, organizimit dhe mobilizimit të burimeve njerëzore dhe materiale në dobi të sigurisë dhe të mbrojtjes së vendit. Përbërja ndryshoi përsëri me largimin e ministrit të Ekonomisë dhe përfshirjen e drejtorit të Përgjithshëm të Policisë (Shih tabelën 1).<sup>44</sup>

---

<sup>41</sup> ‘Albania: Policy-Making and Coordination Assessment. June 2006’, SIGMA Support for Improvement in Governance and Management

<sup>42</sup> Sipas të dhënave të marra zyrtarisht mbi kalendarin e mbledhjeve të KSK nga zyra e Presidentit të Republikës kërkuar për qëllime të këtij studimi, KSK është mbledhur dhjetë herë nën drejtimin e Presidentit Moisiu gjatë periudhës korrik 2002 - korrik 2007.

<sup>43</sup> Ligji nr. 9322, datë 25.11.2004, “Për Miratimin e Strategjisë së Sigurisë Kombëtare të Republikës së Shqipërisë”.

<sup>44</sup> *Ibid.*

KM 1991	KSK 1999	KSK 2004*
1. Presidenti	1. Presidenti	1. Presidenti
2. Kryetari i Kuvendit Popullor	2. Kryetari i Kuvendit	2. Kryetari i Kuvendit
3. Kryeministri	3. Kryeministri	3. Kryeministri
4. Ministri i Mbrojtjes	4. Ministri i Mbrojtjes	4. Ministri i Punëve të Jashtme
5. Ministri i Brendshëm	5. Ministri i Punëve të Jashtme	5. Ministri i Mbrojtjes
6. Ministri i Transporteve	6. Ministri i Rendit Publik	6. Ministri i Rendit Publik*
7. Ministri i Ekonomisë	7. Ministri i Ekonomisë dhe Privatizimit	7. Ministri i Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit
8. Drejtori i Shërbimit Informativ Kombëtar	8. Ministri i Financave	8. Ministri i Financave
9. Shefi i Shtabit të Përgjithshëm	9. Ministri i Punëve Publike dhe Transporteve	9. Ministri i Transporteve dhe Telekomunikacionit
	10. Ministri i Pushtetit Lokal	10. Shefi i Shtabit të Përgjithshëm
	11. Ministri i Shëndetësisë	11. Drejtori i Shërbimit Informativ të Shtetit
	12. Drejtori i Shërbimit Informativ të Shtetit	12. Drejtori i Përgjithshëm i Policisë
	13. Shefi i Shtabit të Përgjithshëm	

**Tabela 1:** Përbërja e Këshillit të Mbrojtjes dhe Këshillit të Sigurimit  
Kombëtar

Rotacioni politik dhe ardhja e mazhorancës së re në vitin 2005 nuk solli ndonjë ndryshim në përmirësimin apo reformimin e autoriteteve koordinuese. KSK vazhdoi të mbledhej dy herë në vit për periudhën deri në zgjedhjet presidenciale në korrik 2007, gjë që më shumë se sa prirje e këshillit për të hyrë në një rrjedhë normale dhe të institucionalizuar funksionimi rezultoi të jetë më shumë interesim dhe nxitje individuale e Presidentit Moisiu. Pas zgjedhjes së Presidentit të ri, KSK është mbledhur një herë në shtator të vitit 2007 për të diskutuar për situatën në Kosovë dhe rajon dhe një herë tjetër në mars 2008 për

\*Përbërja e vitit 2004 vazhdon të jetë e vlefshme edhe aktualisht

\* Ministri i Rendit Publik pas vitit 2005 është ministër i Brendshëm dhe i Pushtetit Lokal

të analizuar ngjarjen e Gërdecit.<sup>45</sup> Pra, nga katërmbëdhjetë mbledhje që KSK ka bërë që nga krijimi me Kushtetutën e vitit 1998 dhe deri më sot, dhjetë janë drejtuar nga Presidenti Moisiu.

Edhe pas vitit 2005 koordinimi ndërmjet ministrive të ndryshme, por edhe ndërmjet KSK dhe Këshillit të Ministrave ka vazhduar të jetë i dobët. Megjithëse nevoja e koordinimit ka qenë refren i disa mbledhjeve të KPSK, në fakt ka ngelur vetëm në nivelin e retorikës. Krijimi i një strukture të përhershme në Këshillin e Ministrave për t'u marrë me çështje të sigurisë kombëtare nuk ka arritur të konkretizohet. Ngjarja e Gërdecit u duk sikur e solli përsëri në krye të prioritetëve të Kryeministrit këtë çështje kur deklaronte se:

*“Pranë Këshillit të Ministrave do të krijohet një departament që do të koordinojë punën e të gjitha agjencive që merren me problemin e sigurisë, ku përfshihen SHISH, Garda e Republikës, Policia, Tatimet, Doganat, Shërbimi i Ushtrisë, Policia Ushtarake dhe inspektorate të tjera. Ky model ekziston në shumë vende dhe mundet që ky komitet, i cili përcaktohet me ligj, të marrë atributet e një kolegji, që të shqyrtojë periodikisht problemet e sigurisë së vendit”.*<sup>46</sup>

Megjithëse ka kaluar një vit e gjysmë, nuk ka akoma një ligj apo strukturë të tillë. Për arsye të prioritetëve integruese të vendit ka një mbivendosje të çështjeve të sigurisë kombëtare dhe të integritit, gjë që shihet nga axhenda e diskutimeve e komiteteve ndërministrorë respektive.<sup>47</sup>

Po kështu, ka një vazhdimësi të vizionit të mazhorancës paraardhëse për sa i përket formatit të koordinimit dhe peshës së vendimmarrjes së autoriteteve koordinuese. Megjithëse nuk ka akoma një strategji të re të sigurisë kombëtare të miratuar nga mazhoranca aktuale, *formati i autoriteteve, i kompetencave dhe i strukturave koordinuese sipas*

<sup>45</sup> Sipas të dhënave të marra zyrtarisht mbi kalendarin e mbledhjeve të KSK nga zyra e Presidentit të Republikës kërkuar për qëllime të këtij studimi.

<sup>46</sup> Armand Maho, “Berisha: Një departament pranë qeverisë për të koordinuar agjencitë e sigurisë”, Gazeta “Tema”, 5 qershor 2008.

<sup>47</sup> Mbledhja e Komitetit Ndërministror për Integrimin në NATO, datë 16.06.2008.

strategjisë ushtarake të vitit 2007, është po ai i përcaktuar në strategjinë e sigurisë kombëtare të vitit 2004, përveç se në strategjinë ushtarake nuk risanksionohet kompetenca e Kryeministrit për të iniciuar rishikimin e strategjisë së sigurisë kombëtare.<sup>48</sup>

Kryeministri e realizon koordinimin nëpërmjet këshilltarëve, të cilët e këshillojnë për çështje të sigurisë dhe të integritimit dhe po të heqësh deklaratat duket se është i kënaqur me këtë format. Dobësia e dallueshme e kësaj forme organizimi nga pikëpamja institucionale është se kur ndryshon Kryeministri, memoria institucionale dhe eksperiencia e vërtetë humbasin dhe nuk ka vazhdimësi të qëndrueshme në qendrën e qeverisjes për të këshilluar për çështje të politikave të sigurisë, pasi ky funksion është i kufizuar te këshilltarët politikë të Kryeministrit të cilët ndryshojnë pas çdo ndryshimi të qeverisë.<sup>49</sup>

Edhe anëtarësimi në NATO, i cili mund të sillte presion të ri për nevojën e koordinimit më të mirë ndërinstytucional, jo vetëm që nuk ka sjellë ndonjë zhvillim të ri deri tani, por këto marrëdhënie të komplikuar nuk shihen si ndonjë problem i madh nga NATO, por më tepër shihen si karakteristikë për rajonin në përgjithësi.<sup>50</sup>

## Konkluzione

Është e qartë se evoluimi i SVSK në Shqipëri është rezultat i kombinimit të ndryshimeve të sistemit politik, institucioneve të trashëguara nga e kaluara, vizioni, filozofia politike dhe mënyra e qeverisjes dhe sjelljes së aktorëve të ndryshëm politikv, por edhe ndryshimet e konceptit të sigurisë.

Nga pikëpamja institucionale duket se modeli më i mirë i aplikuar në Shqipëri është ai i rregulluar nga *ligji për Dispozitat Kryesore Kushtetuese*, por duke qenë se vetë esenca e autoriteteve koordinuese

---

<sup>48</sup> *Ligji nr. 9858, datë 27.12.2007, "Për miratimin e strategjisë ushtarake të Republikës së Shqipërisë"*.

<sup>49</sup> Albania: Policy-Making and Co-ordination Assessment. May 2009', SIGMA Support for Improvement in Governance and Management.

<sup>50</sup> Pietz, Tobias and Marc Remillard, 'Defense Reform and Conversion in Albania, Macedonia and Croatia', Bonn International Centre for Conversion, 2006.

është pjesëmarrja, roli i fortë i Presidentit dhe dobësia e aktorëve të tjerë politikë bëri që kjo eksperiencë të mos rezultonte efektive. Nisur nga vendosja si strukturë koordinuese nën drejtimin e Presidentit, i cili ishte dhe kryetari de facto i ekzekutivit dhe me kompetenca kushtetuese për iniciativë ligjore, mund të thuhet se KM ishte i mirëpozicionuar në ciklin e politikave<sup>51</sup> për të kryer funksionet tipike të një strukture të tillë.<sup>52</sup> Duke qenë një proces kompleks, në ciklin e politikave marrin pjesë aktorë të shumtë, si: ministra parlamentarë, nëpunës civilë, sektori privat, shoqëria civile, media etj., të cilët përpiqen të influencojnë njëri-tjetrin në arritjen e një rezultati të balancuar. Pra, parë nga ky këndvështrim teorik kjo strukturë koordinuese ishte e rregulluar mire nga ana normative, por empirikisht duke konsideruar se shumica e aktorëve të tjerë ishin të dobët vendimet për politikat e sigurisë janë marrë jo në mënyrë ciklike, por vertikale nga lart-poshtë. Veçanërisht mund të përmendet roli i dobët i parlamentit, i cili nuk kishte gjithsesi fuqi mbikëqyrëse mbi Presidentin, por edhe shoqërisë civile dhe medias.

Një aspekt negativ me pasoja dhe të mëvonshme i kësaj eksperiencë ishte se u krijua precedenti për një rol të dobët të parlamentit dhe mbikëqyrjes parlamentare por edhe përjashtimi i aktorëve të tjerë si media dhe shoqëria civile. Eksperiencë tjetër negative ishte dhe fragmentimi konceptit të koordinimit midis dy institucioneve: Presidentit dhe Kryeministrit, fragmentim i cili vazhdon edhe sot.

Modeli i parashikuar nga Kushtetuta e vitit 1998 në vend që ta përmirësonte e dobësoi dhe e bëri më të komplikuar koordinimin. Një nga dobësitë e Kushtetutës është se e identifikon konceptin e sigurisë me Forcat e Armatosura dhe ka bërë rregullimin e dispozitave për kompetencat e Presidentit dhe Këshillit të Sigurimit Kombëtar bazuar mbi këtë koncept. Po kështu ka ngelur e papërcaktuar mënyra se si

---

<sup>51</sup> James E. Skok, 'Policy Issue Networks and the Public Policy Cycle: A Structural-Functional Framework for Public Administration', *Public Administration Review*, Vol. 55, 1995.

<sup>52</sup> Teorikisht cikli i politikave nënkupton procesin që përfshin: (a) identifikimin e problemit dhe propozimin, (b) formulimin e politikave, (c) miratimin, (d) zbatimin, (e) vlerësimin

vendimet e Presidentit dhe KSK përfshihen në vendimmarrje për politika apo në zbatimin ose artikulumin e tyre.

Tentativat e mëvonshme për të rregulluar me ligje hapësirat kushtetuese e kanë bërë koordinimin viktimë të sfidave dhe përplasjeve politike, të cilat gjithnjë e më tepër kanë pasur prirje për t'i dhënë kompetenca të mëtejshme Kryeministrit dhe Këshillit të Ministrave, duke e bërë KSK më shumë një problem se sa zgjidhje. Kështu, koordinimi për çështje të sigurisë kombëtare në qendrën e qeverisjes vazhdon të jetë i dobët, spontan dhe i politizuar.

Krijimi i një autoriteti të vetëm të sigurisë kombëtare është një detyrë komplekse dhe e vështirë. Që të realizohet me sukses një gjë e tillë duhet që të gjithë palët e përfshira të shohin përfitimin e tyre në këtë iniciativë dhe të ofrojnë mbështetjen e tyre.<sup>53</sup> Në stadin aktual nuk mungon as eksperiencia vendase, e cila në rastin më të mirë mund të shërbente për të mësuar nga gabimet, por as edhe praktikatat më të mira të vendeve me struktura koordinuese të suksesshme.

## Rekomandime

Si duket edhe nga dështimet e sistemit tonë aktual, por edhe nga eksperiencat e vendeve të tjera, është i nevojshëm krijimi i një organizmi të vetëm dhe i një strukture të përhershme mbështetëse pranë ekzekutivit. Ky organizëm:

- do të bënte të mundur një koordinim më të mirë të institucioneve që kanë rol në sferën e sigurisë;
- do të bënte vlerësim më koherent dhe të detajuar të kërcënimeve ndaj sigurisë kombëtare;
- do të ndihmonte lidhshërinë e vendit për formulimin dhe farkëtimin e politikës së jashtme dhe të mbrojtjes,
- do të koordinonte aktivitetin e organizmave të përfshirë në menaxhimin e krizave;

---

<sup>53</sup> John E. Tedstrom, 'Establishing a National Security Council: Lessons for the Federal Republic of Yugoslavia', DCAF Working Paper Series - No.15, Geneva, April 2002.

- do të krijonte edhe vazhdimësi në ndjekjen e politikave pasi do t'i mbijetonte rotacioneve të mazhorancave.

Problematik paraqitet fakti se tradicionalisht kjo strukturë është drejtuar nga Presidenti, dhe siç u tha është rezultat i traditës sonë institucionale, por edhe i modelit presidencial të SHBA-së, vend i cili e solli për herë të parë këtë eksperiencë.

Kështu që krijimi i kësaj strukture duhet të paraprihet nga reforma legjislative që të sigurojnë që Kryeministri të jetë në qendër të procesit, pasi si drejtues i Këshillit të Ministrave ai është në gjendje që të realizojë dhe një veprim më të organizuar kolektiv. Një skemë e tillë është në përputhje të plotë edhe me parimet kushtetuese të republikës sonë parlamentare dhe bën të mundur mbikëqyrjen parlamentare, pasi vetë ekzekutivi është subjekt i kësaj mbikëqyrje.

Struktura mbështetëse e këtij autoriteti, e krijuar pranë ekzekutivit, do të përmbante ushtarakë, diplomatë, zyrtarë të lartë të shërbimeve, specialistë dhe teknokratë. Kjo përbërje mikse do të ndihmonte në krijimin e një kulture civilo-ushtarake dhe do të shërbente si bazë për zgjidhje të çështjeve të sigurisë në mënyrë konsensuale dhe elastike dhe në përputhje me mjedisin kompleks të sigurisë.

Në këtë kontekst do të kishte një rol konkret edhe për këshilltarin për sigurinë kombëtare të Kryeministrit, pasi ai do të shërbente si instrument për të penguar, si krijimin e një institucioni me influencë përtej parashikimeve ligjore, ashtu edhe shmangien e konflikteve dhe rivaliteteve ndër-institucionale brenda strukturës. Megjithëse nuk mund të thuhet se ka një model të përcaktuar, në vija të përgjithshme kjo strukturë mund të përmbante këta elementë:<sup>54</sup>

- Një sekretariat administrativ
- Një njësi planifikimi strategjik
- Një qendër menaxhimi krizash
- Një njësi koordinimi të shërbimeve informative
- Një njësi përgjegjëse për diplomacinë publike

---

<sup>54</sup> Andrew N. Liaropoulos, "The Institutional Dimension of Greek Security Policy: Is there a Need for a National Security Council?" NATIONAL SECURITY AND THE FUTURE 3 (9) 2008.



Sfidë për krijimin e një strukture të tillë është se ajo duhet të jetë e vogël, e realizueshme dhe elastike, në mënyrë që të mos rrezikojë të zëvendësojë institucionet ekzistuese, por t'i ndihmojë dhe koordinojë ato. Problematik mund të paraqitet fakti se nëse nuk ekziston vullneti politik për ta ruajtur këtë strukturë nga influencimi i tepruar, Kryeministri mund të ndërhyjë dhe ta manipulojë atë duke e kthyer në një instrument në favor të tij. Po kështu, sfidues mund të jetë edhe krijimi i balancave të duhura midis ekspertëve të fushave të ndryshme, por edhe midis stafit politik dhe teknokratik.

### III

## *Sfidat për një kontroll efektiv demokratik dhe mbikëqyrja parlamentare në sektorin e mbrojtjes*

---

### PANELI II

---

#### LEONARD DEMI

(KRYETAR I KOMISIONIT PARLAMENTAR I SIGURISË KOMBËTARE)

Falënderoj IDN për ftesën që më ka bërë të marrë pjesë në këtë takim që unë e konsideroj shumë të rëndësishëm dhe që më ka dhënë mundësinë që të mbaj një referat për mbikëqyrjen e Institucioneve të Sigurisë në përgjithësi por kryesisht të Forcave të Armatosura të vendit tonë. Ky është mandati im i dytë si Kryetar i Komisionit të Sigurisë Kombëtare të vendit tonë dhe për sa i përket problemit të mbikëqyrjes së Forcave të Armatosura nuk kemi trashëguar ndonjë gjë nga e kaluara.

Kur themi “Komision i Sigurisë Kombëtare” në parlamentin tonë ne kemi parasysh atë Komision i cili ka të bëjë ose bashkëpunon ngushtë me Ministrinë e Mbrojtjes, Ministrinë e Brendshme dhe Shërbimet Inteligjente të vendit tonë apo siç i themi ne Shërbimi Informativ Shtetëror. Unë do të përpiqem të flas shkurtimisht dhe të nxjerr përvojën si dhe vështirësitë që kemi, njëkohësisht dhe çfarë kemi bërë dhe ku synojmë të arrijmë. Të gjithë e dimë dhe unë nuk do të ndalem shumë në anën teorike të problemit, por demokracia nënkupton një supermaci civile të pakufizuar mbi komandën e Forcave të Armatosura

apo të institucioneve të sigurisë që kemi parasysh të gjithë pra mbi ato institucione që kanë autoritetin për të ushtruar forcën. Sa më e vogël të jetë kjo supermaci, aq më shumë demokracia nuk është e plotë.

Për sa i përket mbikëqyrjes, ne përdorim termin mbikëqyrje dhe jo kontroll pasi ne nuk jemi një institucion ekzekutiv, por jemi pjesë e parlamentit, jemi të zgjedhur të popullit, që qëndrojnë midis institucioneve të sigurisë dhe zgjedhësve tanë dhe sa më pranë të jemi Institucioneve të Sigurisë në kuptimin e mbikëqyrjes së tyre aq më i madh është besimi i popullit apo i zgjedhësve për këtë institucion, dhe në këtë mënyrë shuhet të gjitha tensionet që mund të krijohen. Sot mbikëqyrja në Forcat e Armatosura dhe në institucionet e sigurisë është në rendin politik dhe shkencor deri në NATO për disa arsye, dhe për të arritur deri këtu kemi kaluar nëpërmjet një reforme shumë të madhe shumëvjeçare duke zbatuar planin e veprimit për anëtarësim në pesë drejtimet e tij në Forcat e Armatosura dhe në Ushtri. Sot ne përballemi me kthimin e rekrutëve në ushtarë profesionistë dhe sipas angazhimeve që kemi marrë në fund të vitit 2010 ne duhet të kemi një ushtri profesioniste, kështu nuk duhet të kemi më rekrutë. Forcat tona janë zvogëluar, nuk janë më ato që kanë qenë. Me këto forca që kemi ne marrim pjesë në aktivitete ndërkombëtare në mbështetje të paqes. Kur themi në mbështetje të paqes i kemi parasysh të gjitha veprimet me të cilat mund të përballen Forcat e Armatosura duke përfshirë dhe veprimet luftarake, misionet luftarake etj.

Duke iu përshtatur natyrës së Komisionit tonë ne kemi përgjegjësi edhe për Sigurinë e Brendshme e cila sigurisht është e lidhur ngushtë me Sigurinë Rajonale dhe më gjerë që ka të bëjë me sigurinë e kufijve, me krimin dhe luftën kundër krimit të organizuar, terrorizmit, tregtitë ilegale, trafiket të gjitha llojet e kriminaliteteve në përgjithësi. Ne nuk mund të merremi me probleme speciale por sigurisht që mund të ndikojmë në aktivitetin e procesit ligjor të sigurisë, në mënyrën sesi zbatohen ligjet me anë të autoritetit që ka Komisioni.

Ka dy lloj Komisionesh: të dobëta dhe të forta. Çfarë kuptojmë ne me komisione të forta? Struktura e komisionit shkon paralel me institucionet shtetërore. Anëtarësia në komision, zgjat për katër vjet me radhë gjatë gjithë mandatit që ka legjislatura. Ne shqyrtojmë ligje,

por kemi autoritetin për t'i prodhuar edhe vetë d.m.th. për t'i propozuar dhe për të bërë ligje edhe vetë. Unë mund të jap një rast. E bëj këtu se kemi të bëjmë me një institucion joqeveritar shumë të rëndësishëm dhe aktiv në vendin tonë dhe unë i përgëzoj për këtë punë se kanë dhënë një kontribut të madh sidomos në polici dhe përpiqen të japin një kontribut në Shërbimet Inteligjente edhe në Forcat e Armatosura. Ne nuk kemi ligj për mbikëqyrjen e Shërbimeve Inteligjente në vendin tonë. Në nenin 7 të ligjit të tanishëm thotë që këtë detyrë e bën Komisioni i Sigurisë. Po si e bën Komisioni i Sigurisë, deri ku është e drejta e Komisionit të Sigurisë? Cilat janë përgjegjësitë e Komisionit të Sigurisë kur bën mbikëqyrjen në Shërbimet Inteligjente të cilat janë sekrete, puna e tyre është sekrete. A ka të drejtë Komisioni i Sigurisë të shikojë dosjet e operacioneve në zhvillim? Çfarë ndodh nëse një anëtar i Komisionit të Sigurisë thotë ndonjë emër që shikon atje? Cilat janë përgjegjësitë që mban? Prandaj ne po punojmë për të pasur një ligj, kemi njëfarë suksesi në punë, po përpiqet OSBE që të na japë mbështetje por kjo është për tu parë. Por them që po punojmë në këtë drejtim dhe përmenda këtë ligj sepse janë shumë të rëndësishëm dhe puna me të cilën përballet Komisioni i Sigurisë ndonjëherë nuk kuptohet. Janë specialistë të cilët luftojnë krimin, terrorin dhe ndodhen vazhdimisht në situata tepër të vështira. Ç'ndodh sikur emri i tyre del në pazar nëpër gazeta, të nesërmen ai sigurisht do jetë në buzë të ndonjë kanali. E them këtë sepse mbikëqyrja është e rëndësishme dhe ne të gjithë duhet të marrim përsipër përgjegjësinë dhe autoritetin që na kanë dhënë zgjedhësit kur bëjmë këtë punë.

Kemi dhe Komisione të dobëta, dhe anëtarësia në këto komisione nuk është e gjatë, ndryshon por Komisioni i Sigurisë Kombëtare i cili i përket më tepër komisioneve të forta. Deri në vitin 2004 kanë qenë dy komisione më vete: Komisioni për Mbrojtjen dhe Komisioni për Rëndin dhe SHISH-in. Por u bashkuan dhe ne tani kemi një Komision.

Komisioni ynë e ka filluar ta kryejë këtë aktivitet në zbatimin e ligjeve, sesi zbatohen ligjet nga institucionet për të cilat ne i miratojmë këto ligje. Në fillim ne i miratojmë, i diskutojmë dhe ia paraqesim seancës plenare për miratimin përfundimtar, se ligji në qoftë se miratohet vetëm në komision nuk është i vlefshëm pa miratimin e seancës plenare. Pra

dua të sjell një element në vëmendje të të gjithë zotërinjve të nderuar këtu, se për katër vitet e kaluara ne ligjet i kemi miratuar me konsensus me opozitën, kemi bërë përpjekje të jashtëzakonshme që ata të jepnin konsensusin e tyre me qëllim sepse është në interesin kombëtar. Nuk i përket as njërës parti as tjetrës, i përket Shqipërisë dhe këto ligje duhet të kalohen vazhdimisht me konsensus. Unë do të jap një shembull, ne kemi kaluar ligjin për policinë e shtetit i cili e bën atë një institucion krejt profesional, të pavarur nga politika, me buxhet më vete, emërohet vetëm drejtori i përgjithshëm i policisë, të gjithë të tjerët emërohen në bazë të karrierës. Ministri nuk ka të drejtë të emërojë asnjë njeri. Një deputet nuk e ka votuar ligjin për muaj të tërë, sepse diskutimet zgjatën pesë muaj për të pasur një konsensus, vetëm se ai në rezervë humbte një yll nga ligji i ri. Dhe për këtë arsye ligji ishte i keq, nuk bënte. Por njerëzit që bëjnë pjesë në komision duhet të jenë të duruar, jo për t'i mbushur mendjen njerit apo tjetrit, por për të pasur konsensus, ky është i rëndësishëm. Se ata që do ta zbatojnë ligjin, nuk zbatojnë ligj që është miratuar vetëm nga një forcë politike, por zbatojnë ligjin që e ka miratuar komplet parlamenti dhe kështu ligji është ende më i fuqishëm.

Ne e kemi bërë mbikëqyrjen duke organizuar seanca dëgjimore për probleme të ndryshme që kanë pasur këto institucione. Seancat dëgjimore janë të hapura dhe ne kemi thirrur median dhe institucionet jo qeveritare për të marrë pjesë në problemet që ne kemi diskutuar. Pjesë ka qenë edhe institucioni që organizon këtë mbledhje sot. Diskutimet kanë qenë për probleme që shqetësojnë vendin, por edhe një për ngjarjen e nëntë janarit e cila ishte shumë e debatuar dhe ne kemi thirrur të gjithë ata që mundëm dhe diskutimi ka qenë i lirë në kuptimin jo për të hetuar por për të nxitur se ku qëndron e drejta dhe dikush të marrë masa dhe si është zbatuar ligji në këtë drejtim.

Ne nuk jemi institucion hetimor, nuk jemi forcë ekzekutive, pasi këtotribute i kanë organet juridike apo ekzekutive, por në fund fare ne bëjmë një raport, ia paraqesim seancës plenare, kryetares së kuvendit, institucionit të cilin kemi thirrur dhe ftojmë atë që të reflektojë mbi problemet që kanë dalë. Në këto seanca dëgjimore nuk janë ftuar njerëz vetëm kur ne kemi pasur çështje të shërbimeve inteligjente. Ato janë të fshehta nuk thirren gazetarët. Nëse më lejoni t'iu them një ish-

drejtor i CIA-as ka thënë që shërbimi inteligjent sekret me demokracinë nuk shkon, sepse demokracia është e hapur, transparente dhe nxjerr në pah përgjegjësinë që kemi për detyrën që bëjmë. Kurse ato janë të fshehta por që shteti ka nevojë dhe për to dhe siç thashë edhe në fillim ne jemi midis tyre dhe popullit dhe sa më kërkues që të jemi ne karshi tyre, aq më të qetë janë zgjedhësit dhe shoqëria në përgjithësi.

Ne kemi ftuar përveç institucioneve me të cilat kemi të bëjmë ministra apo zyrtarë shumë të lartë, shefat e Shtabit, drejtorët e policive, kemi ftuar edhe nga institucione të tjera që ndikojnë në sigurinë kombëtare. Për shembull nga ministria e financave për sa i përket pastrimit të parave që është një problem shumë i madh. Individë apo grupe individësh me para të pista që futen në treg shkatërrojnë ekonominë kombëtare, shkatërrojnë njerëzit e ndershëm që punojnë. Dhe ne kemi bërë dy seanca të tilla një para një viti e gjysmë dhe një para disa javëve. Në seancën e parë zotërinjtë që ishin ftuar të raportonin nuk thanë gjë dhe ne ishim shumë kritik karshi tyre. Por vumë re me kënaqësi kësaj radhe para dy-tre javësh që ata kishin bërë një punë të madhe dhe Komisionarët Europianë në progres raportin për vendin tonë për këtë vit flisnin mirë për ta. Kjo nuk do të thotë se ata kishin bërë gjithçka por do të thotë se ata ishin futur në vijë.

Por ne nuk kemi një buxhet më vete për ta bërë këtë punë, kemi një staf shumë të vogël, tani e kemi prej tre vetash, njërin e mban DCAF dhe i jemi shumë mirënjohës, është një kolonel rezervë i FA, kurse të tjerët i mban kuvendi. Që kjo punë të jetë e suksesshme jo Komisioni i Sigurisë Kombëtare ose komisionet në përgjithësi që marrin përsipër të bëjnë mbikëqyrje parlamentare duhet të kenë specialistë t'i ndihmojnë, nëse nuk ka specialistë dhe bashkëpunim me ta, puna është në pikëpyetje. Por dua t'ju them që ne kemi bërë në forcat e armatosura dy mbikëqyrje. Mbikëqyrja e parë ka qenë për gradat dhe karrierën në kuptimin që si e ka zbatuar Ministria e Mbrojtjes ligjin e miratuar në vitin 2004 për gradat dhe karrierën. Në problemin e komisionit në të kaluarën ne kemi pasur si deputetë disa ish funksionarë të lartë të ushtrisë, gjeneralë kolonelë, të cilët e njohin me hollësi Ministrinë e Mbrojtjes dhe aktivitetin e Forcave të Armatosura. Në vitin 2006 apo 2007 kur ne kemi bërë këtë mbikëqyrje si ishte zbatuar ligji nga

Ministria e Mbrojtjes për gradat dhe karrierën vumë re disa shkelje, por ato nuk ishin domethënëse. Por ka rëndësi zbatimi i ligjit. Ka pasur raste kur nuk ka qenë respektuar koha për të marrë gradën pasardhëse p.sh. gradën e kolonelit nga nënkoloneli e kanë marrë më shpejt. Shumë pak 90% ishte në zbatim të ligjit dhe në grada të tjera. Këtë gjë ia vumë në dukje ministrit, shefit të Shtabit të Përgjithshëm kur i thirrëm në komision dhe iu lexuam raportin e përgatitur për këtë gjë. Ata e pranuan dhe u zotuan që edhe atë 90% në bazë të amendamenteve që ne kishim përgatitur nuk do të ndodhte në të ardhmen.

Më vonë unë i kam shkruar ministrit të Mbrojtjes një letër ku i kam thënë se ai nuk e zbatoi plotësisht këtë ligj dhe ky është një mendim individual, që kur kanë marrë gradën oficerë shumë të lartë ndonjëherë ka pasur ndonjë shkelje e cila për mendimin tim dëmton punën në forcat e armatosura. Gradat dhe karriera është një element shumë i rëndësishëm dhe unë mendoj është më mirë të respektosh ligjin edhe kur ndonjëherë nuk del ai që duhet të dalë dhe mund të digjet ndonjë oficer sesa të shkelësh ligjin. Unë dhe komisioni kemi pasur, kemi dhe përpiqemi t'i ruajmë marrëdhëniet e mira me të gjithë ushtarakët.

Mbikëqyrja e dytë e cila ka kërkuar një kohë jashtëzakonisht të madhe përgatitore dhe nganjëherë apo në fillim nuk u kuptua as nga deputetët e Komisionit të Sigurisë ka qenë ajo që ne kemi bërë për të mbikëqyrtur sesi është zbatuar ligji për ruajtjen dhe magazinimin e armatimeve të tepërta që kanë Forcat tona të Armatosura. Ne në kohën kur kemi bërë mbikëqyrjen mendonim se kishim 90.000 apo 100.000 ton municione të tepërta në depot tona nga Veriu deri në Jug të Shqipërisë. Para se ne ta bënim mbikëqyrjen ndodhi një aksident i vogël në Dhëmblan të Tepelenës ku humbën jetën 2 nënoficerë dhe ne dërguam një për të parë si ndodhi dhe në takimin që patëm me ministrin e Mbrojtjes, Komisioni tha që ne nuk kemi njerëz të tepërt në ushtri për t'u vrarë prandaj duhet të marrim masa që të mos ndodhi më kjo. Raporti që përgatiti komisioni nuk nxirrte në pah shkaqet, arsyet dhe ne nuk e morëm në konsideratë dhe as nuk e lexuam në Komision. Pastaj ftuam si këshilltarë të jashtëm nga specialistët më të mirë të armatimit që ka vendi ynë. Dhe me mendimin e zotit Mediu ne filluam për muaj të tërë për të vëzhguar nëse komandat apo repartet e ndryshme

të Forcave të Armatosura kishin zbatuar rregullat dhe ligjet përsa i përket ruajtjes së armatimeve. Pas disa muajsh ne përgatitëm një raport të cilin e lexuam në prani të ish-ministrit të Mbrojtjes, ish-shefit të Shtabit të Përgjithshëm dhe zyrtarëve të tjerë të lartë që ndoshta sot janë në Forcat e Armatosura. Me vendim të Komisionit mbledhja u bë e mbyllur për shkak të problematikës që paraqiste ai raport. Komisioni e ka këtë autoritet që t'i bëjë mbledhjet e mbyllura, mos të thërrasë media dhe OJQ kur shikon se nuk duhet. Raporti nuk ishte aspak i mirë, kushtet dhe rregullat në përgjithësi nuk ishin zbatuar. Ministri Mbrojtjes dhe shefi i Shtabit të Përgjithshëm i pranuan konkluzionet e veprimtarisë mbikëqyrëse të Sigurisë dhe u zotuan se do të merrnin masa për t'i rregulluar. Raporti është lexuar më 16 nëntor 2007 dhe në korrik apo qershor të 2008 zoti Oketa i bëri pjesë të Strategjisë së vet për të përmirësuar situatën në vend. E them këtë që bashkëpunimi i ngushtë midis institucioneve ekzekutive dhe parlamentit e ndihmon punën dhe është e domosdoshme.

Po kështu ne kemi bërë një punë të madhe me juristë dhe prokurorë shumë të njohur, konkretisht me Prokurorinë e Krimeve të Rënda, me Prokurorinë e Përgjithshme për të organizuar një mbikëqyrje parlamentare në departamentet rajonale të policisë për të këqyruar sesi ato e zbatojnë ligjin në luftën kundër krimit të organizuar. Është një punë shumë e vështirë por që ne do ta arrijmë me sukses. Një mundësi tjetër që është e domosdoshme për t'u bërë është në aspektin e buxhetit, ku ne do të punojmë ta bëjmë me Forcat e Armatosura në kuptimin sesi është zbatuar buxheti për modernizimin e ushtrisë.

Dhe së fundi si konkluzion do të nxjerr disa pika. Edhe pse mbikëqyrja është një mekanizëm i rëndësishëm ka kufizimet e veta. Parlamentarët kanë mungesë njohurish të nevojshme për çështjen apo për objektin që mbikëqyret të cilat vijnë për arsye të ndryshme. E para për shkak të kërkesave të shumta të kohës, e dyta mbase për shkak të mënyrës sesi janë zgjedhur për të bërë pjesë në Komisionin e Sigurisë, e treta se mund të kenë njohuri të përgjithshme kur kërkohet të jenë të specializuar, e katërta ndikimi i politikave partizane partiake, ku dikush është i interesuar, dikush nuk është i interesuar. E pesta është shtrëngesa për të ruajtur sekretin e materialeve të klasifikuara. Mungesa



e profesionalizmit të stafit të komisionit. Nganjëherë deputetët edhe pse kanë njohuritë e nevojshme, nuk dëshirojnë të përfshihen në këtë proces. Kjo ishte një pasqyrë në vija të përgjithshme të punës që ka bërë Komisioni në këtë drejtim, që është një pjesë e vogël e punës disavjeçare të Komisionit. Sepse Komision ka qenë më tepër përqendruar për të ndikuar dhe ndihmuar në proceset e integrimit të vendit në NATO dhe marrjes sa më shpejt të ftesës së anëtarësimit e të bëheshim anëtarë. Por në vitet që do vijë në bazë të përvojës së fituar besoj që aktiviteti do të jetë më dobiprurës. Siguria kombëtare është një veprimtari që na takon të dyve si mazhorancës dhe opozitës dhe institucionet e Sigurisë Kombëtare kanë nevojë të jemi bashkë.

**WALTER KOLBOW****(ish-ANËTAR I PARLAMENTIT DHE ish-ZËVENDËSMINISTËR I MBROJTJES SË GJERMANISË)**

Parlamenti Gjerman ushtron kontroll mbi Forcat e Armatosura Gjermane bazuar në Ligjin Themeltar Gjerman, legjislacionin aktual si dhe ligjin ndërkombëtar. Në 1994-n, Gjykata Kushtetuese Federale e bëri të detyrueshme për Bundestag-un pjesëmarrjen në vendimet në lidhje me dërgimet e Forcave Ushtarake (Bundeswehr)<sup>1</sup> në misionet e armatosura jashtë shtetit. Kjo pjesëmarrje parlamentare po fillon që të ketë një rëndësi të madhe, në një moment kur po planifikohen dërgime të tilla.

Bundestag-u u mbështet në eksperiencën e dërgimeve të Forcave të Armatosura jashtë shtetit, që u realizuan nga ekzekutivi dhe parlamenti, kur hartoi atë që njihet si Akti i Pjesëmarrjes Parlamentare, i cili u miratua në 2004-n. Ky është një ligj i mirë. Ai na siguron që përfaqësuesit tanë politikë të jenë të aftë të përmbushin përgjegjësitë e tyre duke vepruar aktivisht nëpërmjet kanaleve parlamentare - pasi ata kontribuojnë në vendimet themelore të marra nga Bundestag-u mbi mandatet për dërgimet e trupave jashtë vendit. Kjo i adresohet si mandateve fillestare ashtu edhe zgjerimit të mandateve vjetore. Formalisht, diskutimi bazë mbi dërgimin e Forcave në Misione jashtë vendit, është i organizuar si më poshtë:

Duke vepruar në bazë të një mandati nga Këshilli i Sigurisë së Kombeve të Bashkuara, Qeveria Federale Gjermane ka vendosur t'i shpërndajë Forcat e Armatosura Ushtarake duke adoptuar një vendim kabineti. Kjo do të thotë që, me përjashtim të Kancelarit Federal, të gjithë ministrat duhet të pajtohen me një vendim të tillë. Propozimi në lidhje me dërgimin e Forcave Gjermane në një mision të armatosur transmetohet më pas në Bundestag nga Qeveria Federale. Propozimi duhet të përcaktojë themelet ligjore për mandatin. Përveç kësaj, duhet të jepet një informacion specifik mbi misionet ushtarake, hapësirën e dërgimit të trupave, aftësitë ushtarake që u nevojiten forcave, numrin e ushtarëve, periudhën e dërgimit të misionit si dhe sa do të jetë kosto e tij.

---

<sup>1</sup> Bundeswehr: Forcat e Mbrojtjes Federale

Si rregull, këto mandate diskutohen gjatë një procedure të zakonshme parlamentare. Fillohet me një lexim të parë në seancën plenare, gjatë së cilës Qeveria Federale shpall bazat për mandatin si dhe nis një diskutim fillestar mbi çështjen. Në fund të leximit të parë, mandati u referohet komisioneve të posaçme kompetente - në rastin konkret Komisionit mbi Punët e Jashtme, që është dhe komisioni përgjegjës për mocionin, Komisioni i Mbrojtjes dhe Komisioni i Buxhetit. Ndonjëherë konsultohen edhe Komisioni mbi Zhvillimin dhe Bashkëpunimin Ekonomik si dhe Komisioni mbi të Drejtat e Njeriut dhe Ndhimës Humanitare.

Secili komision diskuton mbi mandatin në dy prej takimeve të tij. Komisionet i paraqesin gjithmonë seancës plenare një rekomandim të vetëm për vendimin, i cili hartohet nga Komisioni mbi Punët e Jashtme, meqenëse është komision përgjegjës. Në leximet e dyta dhe të treta, Bundestagu zhvillon një debat gjithëpërfshirës rreth mocionit të paraqitur nga Qeveria Federale si dhe voton mbi mandatin. Sipas legjislacionit, Bundestag-u është i aftë të votojë vetëm Pro ose Kundër dërgimeve. Është detyrë vetëm e Qeverisë Federale Gjermane të përcaktojë përmbajtjen substanciale të mandatit.

Kur mandatet zgjerohen pa u bërë më parë ndryshime substanciale (emërore), Qeveria federale Gjermane mund të ndjekë atë që njihet si “procedurë e thjeshtëzuar”.

Sipas kësaj procedure, mandati i kalohet Bundestag-ut dhe më pas konsiderohet i aprovuar në rast se nuk bëhet asnjë kërkesë për diskutime formale në Bundestagun Gjerman nga një prej grupeve parlamentare ose nga 5% e anëtarëve të Bundestag-ut brenda një periudhe kohe të 14 ditëve. Për pasojë anëtarët e Bundestag-ut Gjerman kanë një përgjegjësi të madhe, një përgjegjësi që u duhet ta marrin përsipër sa herë që një vendim merret rreth një dërgimi si dhe për çdo mision specifik. Natyra e vështirë e kësaj përgjegjësie është e njohur brenda grupit tim parlamentar, dhe ne na pëlqen të mendojmë se realizojmë një qasje të veçantë mbi vendimet e Bundeswehr rreth mandateve.

Do të doja t’ju ndihmoja se çfarë do të thotë kjo në terma konkretë, duke iu referuar shembullit të dërgimit të trupave në Afganistan. Pas

viteve të para të dërgimit, u bë e qartë se komuniteti ndërkombëtar po përballej me sfida më të mëdha, nga ato të cilat ishin parashikuar fillimisht. Synimet politike që ishin vendosur nga Qeveria e Përkohshme Afgane si dhe nga komuniteti ndërkombëtar ishin dukshëm tepër ambiciozë, ndërkohë që ekzistonte një mungesë balance në burimet kushtuar aktiviteteve civile dhe ushtarake. Situata në Afganistan po bëhej gjithnjë e më tepër e komplikuar dhe më e rrezikshme.

Ekziston një traditë e fortë në grupin tim parlamentar që, gjatë marrjes së vendimeve mbi mandatet e Bundeswehr, të gjithë anëtarët janë të pajisur me informacione shteruese mbi gjendjen e vendit ku do të shpërndahen Forcat Gjermane si dhe mbi detyrat që ato do të kryejnë. Për t'u siguruar që ata e kanë këtë informacion, ne u shpërndajmë materiale të shkruara anëtarëve të grupit tonë parlamentar, përveç këtyre, për të gjithë anëtarët ofrohen dhe realizohen mbledhje conference me përfaqësues të qeverisë si dhe me ekspertë të tjerë.

Falë mundësive që u japin atyre këto aktivitete për të mësuar rreth çështjeve në fjalë, politikanët që nuk janë specialistë të fushës, përvetësojnë gjithashtu baza solide, me anë të të cilave ata mund të marrin vendime individuale mbi mandatin në fjalë.

Megjithatë, ajo që ne bëjmë është më tepër se sa thjesht diskutimi i mandateve, ku secili prej tyre konsiderohet në mënyrë të ndërgjegjshme në kursin e një procesi transparent dhe serioz të diskutimit - po ashtu ne ushtrojmë një kontroll parlamentar mbi dërgimet e Bundeswehr-it jashtë vendit.

Për shembull, "gjendja në zonat e dërgimit", gjithmonë paraqitet si një përbërës në axhendë në fillim të çdo takimi të Komisionit të Mbrojtjes. Gjithashtu brenda grupeve parlamentare, është e mundur të arrihen marrëveshjet mbi format e kontrollit parlamentar, të cilat shkojnë përtej vendim-marrjes mbi mandatet. Pikërisht duke pasur këtë parasysh, grupi parlamentar i Partisë Social-Demokrate Gjermane (SPD), vendosi para tre vitesh që të krijonte atë që njihet si Task Force e Afganistanit.

Kjo Task Force mbledh së bashku anëtarë të specializuar në të gjitha fushat politike përkatëse, midis tyre specialistë në politikën e jashtme, politikën e mbrojtjes, çështjet e brendshme, politikat e zhvillimit dhe

të drejtat e njeriut. Në takimet e saj të rregullta, diskutohen dhe analizohen çështje kritike në lidhje me këto fusha të ndryshme politike. Për ta ndihmuar në punën e saj, Task Force gjithashtu merr të dhëna nga ekspertë të jashtëm me kualifikime në politikë, në ushtri si dhe në organizatat e ndihmës për zhvillim, po ashtu edhe zhvillimin e takimeve me parlamentarë nga kombe të tjera që furnizojnë me trupa. Gjithashtu disa udhëtime në zonat e dërgimit si dhe bisedimet në bazë, kanë ndihmuar anëtarët e Task Force që të përftojnë një tablo realiste të asaj që po ndodh në Afganistan.

Puna e bërë nga Task Force e Afganistanit ka prodhuar formën e raporteve të spektrit të gjerë mbi sfidat dhe mundësitë në dhe për Afganistanin, po ashtu edhe progresin e bërë deri më tani në rindërtimin e vendit raporte këto që mund të merren në anglisht nga faqja zyrtare në internet e grupit parlamentar të Partisë Social-Demokrate (SPD). Disa nga sugjerimet e Task Force janë brendësuar në Dokumentin e Politikës për Afganistanin të Qeverisë Federale Gjermane. Të dyja raportet e tij janë publikuar. Partneri ynë i koalicionit ka botuar gjithashtu një dokument mbi Afganistan.

Megjithatë, prezantimi dhe diskutimi i raporteve të tij nga Task Force nuk shënon fundin e përpjekjeve tona për të ushtruar kontrollin parlamentar. Grupi im parlamentar ka vendosur që Task Force duhet të vazhdojë punën e tij. Pavarësisht punës intensive parlamentare mbi rishikimin e mandateve si dhe mbikëqyrjen e zbatimit të tyre, disa anëtarë, duke përfshirë këtu edhe kolegë nga grupi im parlamentar, e kanë të vështirë të japin miratimin e tyre për dërgimin e forcave në misionet e armatosura jashtë shtetit. Kjo ishte e dukshme herën e fundit që u zgjeruan mandatet për ISAF dhe u zgjeruan Operation Enduring Freedom. Parë në një aspekt, mënyra se si anëtarët votuan në Bundestag është një reflektim i opinionit publik, prandaj nuk duhet që të dramatizohet fakti që disa anëtarë të grupeve parlamentare qeverisëse të koalicionit votuan kundër dërgimeve të Forcave të Armatosura në misione jashtë vendit. Ajo që ka rëndësi është fakti se anëtarët e Bundestag-ut Gjerman janë të ndërgjegjshëm për përgjegjësitë që ata kanë kur diskutojnë mbi dërgimin e forcave tona në misionet e armatosura.

Nuk është një çështje e vendimeve përfundimtare që tashmë janë marrë - por kjo është një çështje që i vendos anëtarët individualë në testimin e mënyrave të reja vazhdimisht. Kjo nuk e bën procesin e vendimmarrjes të lehtë për ata njerëz, detyra e të cilëve është që ta menaxhojnë atë. Megjithatë, unë kuptoj se është pjesë e demokracisë parlamentare, që ne përfaqësuesit e njerëzve, duhet të veprojmë në mënyrë të përgjegjshme kur japim aprovimin tonë themeltar për mandatet e dërgimeve. Për këtë arsye, ne kemi detyrimin që t'i shqyrtojmë me kujdes propozime të tilla për dërgimin, të ndjekim shqyrtimin objektiv të lëvizjes së paraqitur, si dhe të përhapim verdiktin tonë parlamentar mbi çdo mandat.

Në 12 vitet e fundit, Bundestagu Gjerman ka dhënë miratimin e tij për mandatet e dërgimit të Forcave të Armatosura ose për zgjerimin e mandateve të tilla në më tepër se 60 raste, secilën herë me një shumicë më të madhe dhe si rregull me një konsensus ndërpartiak. Shumica të tilla të mëdha nuk tregojnë vetëm që Qeveria Federale ka baza të sigurta politike mbi të cilat mund të marrë vendime. Ato janë gjithashtu një miratim i rëndësishëm për ushtarët në shërbimin aktiv, që ajo çka ata po bëjnë dëshirohet politikisht dhe gëzon mbështetje të gjerë.

Bundeswehr është një ushtri parlamentare. Gjykata Kushtetuese Federale e ka emërtuar atë si të tillë në 1994-n. Praktika e ndjekur gjatë diskutimeve parlamentare të mandateve për dërgimin e Forcave në Misionet e Armatosura jashtë Gjermanisë, tregon se si Bundestag ka bërë përpjekje për të kënaqur pritshmëritë e larta të Gjykatës - pritshmëri të cilat Parlamenti Gjerman do të vazhdojë ti realizojë edhe në të ardhmen. Nuk është e detyruar që ta bëjë këtë vetëm me anë të instrumenteve statutores që drejtojnë rolin e tij: por kjo është përgjegjësia e tij politike - jo vetëm kundrejt ushtarëve tanë, të cilët janë dërguar jashtë vendit si pasojë e vendimeve të tij themeltare.

RAPORT: ROLI DHE PËRVOJAT E KOMISIONIT  
PARLAMENTAR PËR SIGURINË KOMBËTARE  
(IDN, SHTATOR - TETOR 2009)

***Anketim i IDN-së me ish-deputetë anëtarë  
të Komisionit Parlamentar të Sigurisë Kombëtare***

*(Përgatiti raportin Arian Dyrmishi, IDN)*

## **1. Hyrje**

Anëtarësimi i Shqipërisë në NATO demonstroi se institucionet dhe praktikat demokratike bazë janë instaluar. Megjithatë kontrolli dhe mbikëqyrja parlamentare ka qenë një nga aspektet më të pakonsoliduara. Studimet mbi mbikëqyrjen dhe kontrollin parlamentar të sektorit të sigurisë në Shqipëri nënvizojnë mangësi të një kontrolli demokratik real, përfshirë dhe çështje të buxhetit, përveç plotësimit të disa kriterëve demokratike në lidhje me legjislacionin. Ndër shkaqet kryesore rreshtohen: në përgjithësi është ndër një mangësi e eksperiencës demokratike e cila ka çuar në mungesën e debatit midis deputetëve dhe midis parlamentit dhe qeverisë, ndoshta për shkak në disa raste edhe të imponimit nga ana e qeverisë; mungesa e dispozitave kushtetuese për të bërë të detyrueshëm një konsultim më të gjerë të qeverisë me parlamentin; aksesit i kufizuar i parlamentit ndaj informacionit; mungesa e burimeve të ekspertizës dhe numri i kufizuar i stafit teknik të kualifikuar në dispozicion të parlamentit.

Në këtë kontekst ky anketim përpiqet të paraqesë një vlerësim të azhurnuar të zhvillimeve në fushën e kontrollit demokratik duke u bazuar në përgjigje të marra nga ish-deputetë anëtarë të Komisionit Parlamentar të Sigurisë Kombëtare gjatë dy legjislaturave të fundit.

Anketimi me ish-deputetë të këtyre dy legjislaturave u pa i përshtatshëm për disa arsye. Së pari, periudha pas vitit 2000 shënon

fillimin e gjeneratës së dytë të reformave të sektorit të sigurisë, që është e interesuar kryesisht për konsolidimin e mëtejshëm të procedurave demokratike të mbikëqyrjes dhe transparencës, mënyrës se si institucionet i zbatojnë politikat, përmirësimin e efikasitetit dhe efikasitetit si dhe përfshirjen më të gjerë të shoqërisë civile. Së dyti, përveç legjislacionit organik dhe rregullues parlamenti në këtë periudhë ka qenë më i përfshirë dhe në miratimin dhe rishikimin sistematik të strategjive që lidhen me sigurinë, çka ka sjellë një përfshirje më të madhe të parlamentit në çështje të sigurisë. Së treti, në këto dy legjislatura kanë qeverisur dy maxhoranca të ndryshme, çka lejon dhe mundësinë për të vërejtur nëse qëndrimet e tyre ndaj mbikëqyrjes parlamentare variojnë.

## **2. Përbërja e kampionit**

Nga ish-deputetët anëtarë të Komisionit Parlamentar të Sigurisë Kombëtare në legjislaturën 2001-2005, u kontaktuan nëntë prej tyre dhe pranuan ti përgjigjen pyetësorit gjashtë. Për legjislaturën 2005-2009 u kontaktuan katërbëdhjetë ish-deputetë dhe pranuan të marrin pjesë në anketim shtatë prej tyre. Për të dy legjislaturat numri i përgjithshëm i deputetëve është 26, u kontaktuan 23 prej tyre, dhe iu përgjigjën pyetësorit të anketimit 13 prej ish-deputetëve pra, gjysma e deputetëve. Duhet theksuar që të gjithë deputetët e të dy legjislaturave kanë qenë meshkuj. Anketimi u zhvillua në periudhën shtator-tetor 2009.

Meqenëse shumica e përgjigjeve janë të kufizuara në PO ose JO, janë paraqitur në formë grafike vetëm ato pyetje përgjigjet e të cilave janë më të fragmentuara.

Ne pyetësor u përfshinë 19 pyetje, nga të cilat 3 pyetje të hapura dhe 16 të mbyllura. Por, edhe tek pyetjet e mbyllura të anketuarit kanë bërë komente të cilat janë reflektuar në raport. Nëpërmjet pyetjeve të hapura, anketimi synoi të identifikojë shkallën e informimit dhe familjaritetin e të anketuarve me thelbin e kontrollit dhe mbikëqyrjes parlamentare, funksionet kryesore të Komisionit Parlamentar për Sigurinë Kombëtare, dhe instrumentet që KPSK përdor në procesin e mbikëqyrjes.



### 3. Gjetjet e sondazhit

1. Pyetjes së shtruar mbi përshkrimin e thelbit të kontrollit dhe mbikëqyrjes parlamentare mbi sektorin e mbrojtjes, anketimi identifikoi një audiencë në përgjithësi njësoj të informuar si në legjislaturën 2001-2005 ashtu dhe në atë 2005-2009.

Në përgjigjet e të anketuarve nuk del në plan të parë thelbi thellësisht politik i mbikëqyrjes parlamentare, por ajo identifikohet më shumë me funksionet dhe instrumentet që parlamenti përdor për të ushtruar këtë mision. Kështu, thuajse një masë e madhe deputetësh e identifikojnë thelbin e kontrollit parlamentar me shqyrtimin dhe miratimin e dokumenteve të sigurisë kombëtare, shqyrtimin dhe miratimin e marrëveshjeve ndërkombëtare, ushtrimin e kontrollit mbi buxhetin duke e kaluar atë në filtrin parlamentar etj. Përveç kësaj e identifikojnë atë edhe me kontrollin administrativ mbi reformat në Forcat e Armatosura zbatimin e tyre.

Mbikëqyrjen parlamentare e njohin si një nga elementët më të rëndësishëm të realizimit të kontrollit civil-demokratik mbi Forcat e Armatosura por suksesin i saj e konsiderojnë si i varur nga kompetencat e parlamentit mbi ekzekutivin në këtë fushë. Po, kështu ata mendojnë se mbikëqyrja parlamentare efektive është rezultat i kombinimit të sanksionimit ligjor të marrëdhënieve midis ekzekutivit dhe parlamentit dhe shkallës së demokratizimit të shoqërisë.

Kur është fjala për të treguar rrugët për të pasur një mbikëqyrje sa më efektive pritshmëria e tyre është që ekzekutivi me dëshirën e vet t'i nënshtrohet mbikëqyrjes dhe transparencës. Po kështu të anketuarit e shohin efektivitetin e mbikëqyrjes parlamentare si të varur nga "shkalla e demokratizimit të shoqërisë" por pa arritur të artikulojnë parlamentin si një nga aktorët kryesorë në çuarjen përpara të procesit të demokratizimit.

2. Përgjigja për përshkrimin e funksioneve kryesore të Komisionit Parlamentar për Sigurinë Kombëtare (KPSK) është në koherencë me përgjigjet e dhëna në pyetjen e mësipërme pasi të gjithë të anketuarit nuk e kanë përshkruar KPSK si organ të parlamentit të ngarkuar me

mbajtjen e marrëdhënieve të punës dhe konsultimeve me institucionet e ekzekutivit. Megjithatë, në pjesën më të madhe të anketuarit janë të informuar për detyrat specifike të KPSK, si ata që kanë shërbyer në legjislaturën 2001-2005 ashtu dhe ata që kanë shërbyer në legjislaturën 2005-2009. Monitorimi i implementimit të ligjeve dhe politikave të qeverisë si dhe ai mbi përmbushjen e detyrave nga ana e Ministrisë së Mbrojtjes sipas objektivave të strategjisë së sigurisë kombëtare dhe të mbrojtjes, rezulton si një prej detyrave më të njohura nga të anketuarit.

3. Përgjigjet ndaj pyetjes nëse mund të përshkruani disa nga instrumentet që KPSK përdor në ushtrimin e detyrave dhe kompetencave të tij, tregojnë se pjesa më e madhe e ish-deputetëve identifikojnë shumicën e instrumenteve kryesore që KPSK dhe parlamenti përdor për ushtrimin e kompetencave si debatet parlamentare, pyetjet dhe interpelancat parlamentare kryesisht me Ministrinë e Mbrojtjes, hetimet parlamentare, kontrollat tek institucionet e fushës së sigurisë, seanca dëgjimore publike me anëtarë të Këshillit të Ministrave, me përfaqësues të lartë të institucioneve shtetërore ose publike, ekspertë, përfaqësues të shoqërisë civile, përfaqësues të grupeve të interesit, si dhe grupime të tjera të interesuara.

Gjatë përgjigjes së kësaj pyetje ka edhe vlerësime për rezultatet e procesit të mbikëqyrjes, dhe konkretisht për komisionet hetimore të cilat edhe pse janë përdorur gjerësisht nga Parlamenti nuk kanë rezultuar në një instrument efektiv dhe nuk kanë pasur impakt për krijimin e një opinioni në Shqipëri. Gjithashtu konsiderohet se opinionet e tyre dhe konkluzionet e nxjerra nga parlamenti nuk kanë gjetur zbatim, por kanë ngelur në nivel rekomandimi.

4. Pyetjes nëse Parlamenti ka dhënë një kontribut të rëndësishëm në vendosjen dhe përmirësimin e standardeve të qeverisjes së mirë në fushën e sigurisë, 60% e ish-deputetëve i janë përgjigjur se Parlamenti e ka dhënë një kontribut të tillë pozitiv. Duke iu referuar gjetjeve të pyetësorëve, pavarësisht përkatësisë partiake të anketuarit mendojnë se Parlamenti dhe Komisioni ka luajtur të njëjtin rol në të dy legjislaturat.


5. Pyetjes nëse Parlamenti dhe veçanërisht Komisioni duhet të përfshihet në procesin e emërimeve të larta në sektorin e mbrojtjes, 70% e ish-deputetëve mendojnë se Komisioni duhet të përfshihet në procesin e emërimeve të larta në sektorin e mbrojtjes. Pjesa më e madhe e të anketuarve që përgjigjen PO saktësojnë se dy figurat kryesore në të cilat do të ishte mirë të konsultohet parlamenti në procesin e emërimeve dhe përkatësisht të shefit të Shtabit të Përgjithshëm dhe drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit. Sidoqoftë tendenca e përgjithshme e të anketuarve është për të specifikuar se përfshirja e parlamentit duhet të ketë karakter konsultativ. Gjithashtu një aspekt tjetër i rëndësishëm për tu vënë në pah është ata që i janë përgjigjur JO pyetjes për përfshirjen e parlamentit në procesin e emërimeve në legjislaturën 2005-2009 kanë qenë pjesë e maxhorancës.

6. Pyetjes nëse konsensusi politik ka funksionuar në nivelin e duhur që KPSK të kryejë detyrën funksionale, 60% e të anketuarve, pavarësisht përkatësisë partiake, i është përgjigjur PO. Ia vlen për t'u përmendur që disa prej të intervistuarve saktësuan se konsensusi politik ka qenë më i madh në fushën e Mbrojtjes. Konsensusi në këtë fushë i detyrohet sidomos anëtarësimit në NATO sepse fusha e Mbrojtjes është një fushë ku të gjitha forcat politike kanë rënë dakord për integrimin e vendit në NATO. Një element i rëndësishëm që është vënë në dukje nga disa deputetë është fakti se konsensusi politik ka qenë pozitiv edhe për shkak të frymës pozitive të vetë ministrit të Mbrojtjes. Përqindja e të anketuarve që japin përgjigje negative për konsensusin politik është i njëjtë në të dy legjislaturat.


7. Pyetjes nëse ka pasur opozita hapësirën e duhur që brenda KPSK dhe parlamentit të shprehë dhe realizojë preokupimet e saj, qoftë në procesin e politikëbërjes, atë të zbatimit të politikave apo kontrollit dhe rishikimit të tyre, pritshmëria e të anketuarve pëson një variacion më të madh. 60% e të intervistuarve mendojnë se opozita ka pasur hapësirën e nevojshme për të shprehur preokupimet e saj, për të ngritur problematika apo për të marrë pjesë në procesin e politikëbërjes. Vihet re, gjithashtu, që nuk ka pasur asnjë ndryshim në konsensusin politik

si në legjislaturën 2001-2005 ashtu dhe në atë 2005-2009. Përsëri vihet re që dhe në rastet kur përgjigja ka qenë “Deri diku” ose “JO” ka pasur një përqindje të njëjtë për sa i përket raportit pozitë-opozitë. Këto të dhëna tregojnë se niveli i konsensusit politik në të dy legjislaturat objekt të këtij anketimi ka qenë në të njëjtin nivel.

8. Në pyetjen ku shtrohet problematika nëse KPSK dhe nëpërmjet tij parlamenti realisht arrin të balancojë pushtetin ekzekutiv në procesin e miratimit të buxhetit 50% mendojnë se “JO”, 20% “Deri diku” dhe vetëm 30% “PO”. Si shprehet një deputet edhe kur në KPSK janë bërë ndryshime, gjatë seancës qeveria ka arritur të gjejë mënyrat për të miratuar versionin e saj.



9. Pyetjes a është mjaftueshëm i qartë dhe i mirëdetajuar procesi i përgatitjes për diskutim i buxhetit, ish-deputetët janë të ndarë gati njëjloj në “PO”, “JO”, “Deri diku” dhe “Nuk e di”. Edhe në këtë rast vihet re që si përgjigjet negative ashtu dhe ato pozitive janë të së njëjtës përqindje si në legjislaturën 2001-2005 ashtu dhe në atë 2005-2009. Pra duket se procesi i detajimit të buxhetit nuk është shumë i qartë dhe nuk ka pasur ndryshime apo përmirësime nga njëra legjislaturë në tjetrën.



10. Pyetjes nëse KPSK ka kërkuar shpjegime të mëtejshme mbi mënyrën e shpenzimit të buxhetit në bazë të raporteve të Kontrollit të Lartë të Shtetit, 90% e ish-deputetëve i janë përgjigjur “PO”. Ndër arsyet që të anketuarit japin për të shpjeguar këtë prirje është detyrimi ligjor për të kërkuar një gjë të tillë dy herë në vit.

11. Pyetjes nëse mendoni se parlamenti ka influencë në prokurimin e materialeve dhe shërbimeve në fushën e mbrojtjes, ish-deputetët i janë përgjigjur 100% “JO”.

Duke qenë se me përfundimin e reformës së personelit deri në vitin 2010, fokusi i reformës në Forcat e Armatosura do të jetë modernizimi i pajisjeve, kjo çështje merr rëndësi për t’u adresuar nga parlamenti.

12. Në vijim të pyetjes së mësipërme, edhe për pyetjen - a mendoni se prokurimet në fushën e mbrojtjes janë specifike dhe duhet të mos bëhen pjesë e shqyrtimit dhe e debatit parlamentar - shumica e ish-deputetëve (70%) konsideron se prokurimet në fushën e mbrojtjes duhet të bëhen objekt i shqyrtimit parlamentar. Disa prej të anketuarve vënë në dukje faktin se parlamenti nuk mund të ketë kompetenca në fushën e prokurimeve pasi ka procedura të gjata dhe kjo do të ngadalësonte vendimmarrjen. Kjo tregon nevojën për më shumë

informim të deputetëve mbi nevojën e përfshirjes së parlamentit në prokurimet e Forcave të Armatosura.


13. Të njëjtat përqindje paraqiten edhe në përgjigjet që jepen për pyetjen - a mendoni se parlamenti ka arritur të luajë rolin e vet në procesin e prokurimeve të rëndësishme në fushën e mbrojtjes dhe të shitjes së armatimeve - ku 70% e tyre konsideron se parlamenti nuk ka arritur ta luajë këtë rol. Kështu, në bllokun prej tre pyetjesh që lidhen me prokurimet ka një koherencë të dukshme për sa i përket përfshirjes së ulët të parlamentit në procesin e prokurimeve por që është dhe një qëndrim ndaj nevojës për të adresuar këtë problem.

14. Përgjigjet për pyetjen nëse mendoni se parlamenti ka shërbyer si një urë midis ekzekutivit dhe publikut për informimin e tij mbi procesin e buxhetit dhe prokurimeve në fushën e mbrojtjes - paraqiten të ndara 60% "PO" dhe 40% "JO". Meqenëse rritja e transparencës në marrëdhëniet me publikun dhe votuesit është një nga detyrimet themelore të parlamentit, rezultati i përgjigjeve të kësaj pyetjeje përkon edhe me paqartësinë në përcaktimin e thelbit të mbikëqyrjes parlamentare.

15. Pyetjes nëse mendoni se KPSK ka burimet, ekspertizën dhe përgjegjshmërinë e mjaftueshme për të kryer funksionet e mësipërme, vetëm 60% i janë përgjigjur "PO". Por kjo pyetje ka shkaktuar pothuajse të gjithë të anketuarit nevojë për të bërë një ndarje midis përgjegjshmërisë dhe burimeve nga njëra ane dhe ekspertizës nga ana tjetër. Pjesa më e madhe specifikon se nuk ka pasur burimet dhe ekspertizën e nevojshme ndërkohë që përgjegjshmëria nuk ka munguar asnjëherë. Disa prej të anketuarve kanë përmendur dhe mungesën e një stafi teknik të kualifikuar që e mbështet KPSK në ushtrimin e funksioneve të tij, pasi zgjidhet mbi baza dhe përkatësi partiake duke mos pasur njohuri mbi fushën dhe nuk ofron ekspertizën e nevojshme.

16. Pyetjes nëse mendoni se keni pasur akses dhe bashkëpunim për të marrë informacionin e duhur nga ekzekutivi dhe forcat e armatosura

në mënyrë që të kryeni funksionet tuaja kushtetuese dhe ligjore, 50% i janë përgjigjur “PO”, 40% “Deri diku” dhe 10% “JO”. Kjo tregon se në përgjithësi ka pasur bashkëpunim në marrjen e informacionit edhe pse jo në nivelin optimal, ndërkohë që është interesante për t’u parë që pjesa më e madhe e të anketuarve që janë përgjigjur pozitivisht i përkasin legjislaturës 2001-2005.



17. Pyetjes nëse mendoni se respektohen procedurat kohore të nevojshme për diskutimin dhe miratimin e projektligjeve të ndryshme 60% e të anketuarve i përgjigjen “PO”. Është me interes të theksohet që një pjesë e mirë e të anketuarve edhe kur përgjigjen pozitivisht dëshirojnë të vënë theksin te volumi i legjislacionit që parlamentit shqiptar i është dashur të kalojë, edhe në kuadër të përafrimit të legjislacionit me Bashkimin Europian, duke vënë në pah edhe më tepër punën e mirë të parlamentit në këtë kontekst. Nga ky këndvështrim mund të kuptohet edhe përgjigja negative e pakicës së personave të anketuar të cilët specifikojnë që është e pamundur të respektohet të gjitha procedurat e nevojshme për diskutim dhe miratim për shkak të intensitetit të ligjeve. Mund të nxirret konkluzioni se si në legjislaturën 2001-2005 ashtu dhe në legjislaturën 2005-2009 procedurat kohore të nevojshme për diskutim dhe miratimin e projektligjeve janë

respektuar njësoj, pra nuk ka pasur ndonjë ndryshim thelbësor për t'u vënë në dukje në mënyrë të veçantë.

18. Pyetjes a keni pasur raste kur për nevoja pune apo informacioni keni thirrur për të dëgjuar drejtues të nivelit më të ulët se titullari i institucionit, 40% i janë përgjigjur “PO”, 40% “JO” dhe 10% “Ndonjëherë”. Disa prej të anketuarve që përgjigjen negativisht e vënë theksin te procedurat ligjore sipas të cilave KPSK kërkon ministrin, dhe pastaj është ky i fundit që dërgon për ta përfaqësuar zëvendësministrin ose drejtorin përkatës sipas nevojës dhe çështjes. Këto të dhëna nxjerrin në pah se në të dy legjislaturat ka pasur të njëjtin numër rastesh ku në parlament janë paraqitur përfaqësues të një niveli më të ulët se ministri. Në komentet e bëra ish-deputetët theksojnë se kjo ka sjellë dhe mungesën e zgjidhjes së problemeve në shumë raste ku prania e autoriteteve me përgjegjësi më të drejtpërdrejtë do të kishte kontribuar në zgjidhjen problemeve.

19. Pyetjes a keni pasur raste kur vetë institucionet zbatuese kanë kërkuar ndihmën dhe angazhimin e KPSK, 60% thonë se kjo na ndodhur “Ndonjëherë”, 20% i janë përgjigjur “PO” dhe 20% “JO”, duke shprehur të njëjtin nivel përfshirje nga ana e ekzekutivit për dy legjislaturat.



## **IV**

# **Transparenca dhe hapja ndaj shoqërisë (roli i shoqërisë civile, medias, akademikëve)**

---

## **PANELI III**

---

**RAPORT:**  
**PERCEPTIMI I OPINIONIT PUBLIK MBI FORCAT  
E ARMATOSURA DHE MBI MINISTRINË E MBROJTJES**  
*(IDN, SHTATOR 2009)*

*(Përgatiti raportin Enri Hide, Kërkues SMN, Lektor në UET)*

### **1. Hyrje**

Në një kohë kur Forcat e Armatosura dhe lidershipi i tyre politik kanë kapërcyer me sukses një vit më parë sfidën e integritimit në NATO, ky anketim do të përplotësojë raportet e mëparshme të perceptimit të publikut shqiptar mbi Forcat e Armatosura, Ministrinë e Mbrojtjes dhe kontributin e tyre në NATO. Anketimi i realizuar nga Instituti për Demokraci e Ndërmjetësim synon të vlerësojë dinamikën, familjarizimin, pikëpamjet dhe qasjet e qytetarëve shqiptarë ndaj institucionit të Ministrisë së Mbrojtjes dhe të Forcave të Armatosura.

Sondazhi është realizuar gjatë periudhës gusht-shtator 2009 nëpërmjet intervistave telefonike me rreth 600 të anketuar në të gjitha

qytetet e vendit. Përqasja ndaj kampionit u bazua në përzgjedhjen rastësore të të anketuarve (mbi 18 vjeç) dhe në intervista të realizuara në orare të ndryshme të ditës në mënyrë që të sigurohet përfaqësimi i duhur sa i përket grupmoshave dhe nivele të ndryshme të tyre (të punësuar ose jo, në shkollë ose jo, e kështu me radhë). Anketimi bazohet në një pyetësor me rreth 23 pyetje i ndërtuar mbi pyetje të strukturuar dhe, përgjithësisht, të mbyllura.

## 2. Përbërja e kampionit

Kampioni i pjesëmarrësve në sondazh shfaq një veçori për shkak të raportit jo të barabartë midis përfaqësimit të të intervistuarve meshkuj e atyre femra, çka normalisht nuk do të shprehte perceptimin real të shoqërisë shqiptare në raport me institucionin e ushtrisë (duke qenë se pjesëmarrja në të rezulton 66% me 34% në favor të meshkujve. (Shih Fig. 1)




Figura 1. Gjinia e të anketuarve

Gjithsesi prania e të dyja gjinive, e të gjitha grupmoshave dhe e të gjitha niveleve të arsimit dëshmon një gjithëpërfshirje dhe shtrirjen e matjes së perceptimit publik në të gjitha kategoritë.

Ndërkaq, në përputhje me qëllimet tona për të matur në mënyrë sa më të plotë e përfaqësuese opinionin e të gjitha grupeve të popullsisë, shpërndarja e grupmoshave sipas arsimit përkatës përqendrohet në individët me arsim të mesëm e të lartë (89% e të intervistuarve kishin arsim të lartë ose të mesëm. (Shih Fig. 3)




Figura 2. Ndarja e të anketuarve sipas moshës




Figura 3. Niveli arsimor i të anketuarve

### 3. Gjetjet e sondazhit

Kur të anketuarit pyeten mbi njohuritë e tyre për institucione të caktuara bazuar në informacionin që zotërojnë, duket se Ministria e Mbrojtjes qëndron mjaft lart në listën e institucioneve. Praktikisht ajo radhitet e treta, me rreth 60% të përgjigjeve “shumë mirë” ose “mirë” (Fig. 4), ndërkohë që në vendin e parë vendoset Ministria e Arsimit, me rreth 73%, e pasuar nga Ministria e Shëndetësisë, me 68%.




Figura 4. Njohuritë mbi Ministrinë e Mbrojtjes

Disi më i ulët, por gjithsesi domethënës, është niveli i njohjes që pretendojnë të kenë të anketuarit në lidhje me Forcat e Armatosura, ku rreth 58% e tyre në total shprehen se e njohin mirë ose shumë mirë institucionin. (Shih Fig. 5)




Figura 5. Njohuritë mbi Forcat e Armatosura

Kjo radhitje, e cila përkon më së miri me perceptimin e përgjithshëm të publikut evropian mbi Forcat e Armatosura, duket se i atribuohet disa faktorëve. Së pari, ai duhet kërkuar në anëtarësimin e Shqipërisë në NATO, proces që në fundin e tij e vendosi Ministrinë e Mbrojtjes në qendër të debatit publik. Së dyti, sidomos pas ngjarjes tragjike të Gërdecit (mars 2008), lidershpi i Forcave të Armatosura dhe ai politik i ministrisë u vendosën në qendër të debateve të forta në opinionin publik. Kështu mund të shpjegohet përse Ministria e Mbrojtjes zë një vend kaq të lartë në vëmendjen e opinionit publik, kurse, bie fjala, Ministria e Bujqësisë, në një vend ku afërsisht 50% e popullsisë jeton në fshat, zë vendin e fundit, me 39.5% të të anketuarve që mendojnë se e njohin shumë / mirë këtë institucion.

Nga përgjigjet e të intervistuarve vërehet se rreth 83% e tyre kanë opinion “shumë pozitiv” ose “pozitiv” mbi Forcat e Armatosura, kurse asnjë prej tyre nuk shprehu opinion “shumë negativ” (Shih Fig. 6: vetëm 3.67% e të intervistuarve shprehën mendim negativ, kurse 13.52 të tjerë neutral).




Figura 6. Opinioni mbi Forcat e Armatosura

Dy arsyt kryesore sipas shumicës së të anketuarve për këtë mendim pozitiv ose shumë pozitiv të tyre kanë të bëjnë me faktin se Forcat e Armatosura konsiderohen të domosdoshme për mbrojtjen (28.69% e tyre) dhe gjithashtu prej rolit të tyre në misionet paqeruajtëse (28.96%). (Shih Fig. 7)




Figura 7. Arsyet për mendim shumë / pozitiv mbi Forcat e Armatosura

Sa i përket të anketuarve që kanë mendim negativ dhe ose neutral për Forcat e Armatosura, arsyt kryesore kanë të bëjnë me perceptimin e të anketuarve që i konsiderojnë Forcat e Armatosura të pारेformuara (28.4%), si vegla të politikës (17.28%) apo për shkak të Gërdecit (24.69%). (Shih Fig. 8)




Figura 8. Arsytet për mendimin negativ ndaj Forcave të Armatosura

Ndërkaq, lehtësisht i diferencuar shfaqet opinionin mbi Ministrinë e Mbrojtjes, ku 74% e të intervistuarve shprehin mendim pozitiv ndërsa 24% e të anketuarve deklarojnë qëndrim neutral ndaj kësaj Ministrie dhe vetëm 2% kanë opinion negativ për punën e saj si institucion. (Shih Fig. 9)




Figura 9. Opinioni mbi Ministrinë e Mbrojtjes

Ekziston një grup arsyesh për perceptimin “pozitiv” dhe/ose “shumë pozitiv” të të intervistuarve ndaj Ministrisë së Mbrojtjes, ndër të cilat spikasin: hyrja në NATO, që është identifikuar nga grupi më i madh i të anketuarve (19.88%); misionet ndërkombëtare në të cilat marrin pjesë Forcat tona të Armatosura (në Luftën kundër Terrorit në Afganistan e në Irak në kuadrin e NATO-s); si dhe dy arsye me natyrë mjaft të përgjithshme: a) sepse punon mirë dhe, b) sepse mbron interesat e qytetarëve shqiptarë dhe mbron sovranitetin shqiptar. (Shih Fig. 10)

Figura 10: Arsyet për mendimin pozitiv/shumë pozitiv mbi Ministrinë e Mbrojtjes

Nga ana tjetër duhet theksuar që mendimi negativ i të intervistuarve për Ministrinë e Mbrojtjes, si mund të pritej, vjen pikësisht (në masën 61.22%) për shkak të tragjedisë së Gërdecit dhe pasojave të saj, së dyti për shkak se udhëheqja e Forcave të Armatosura nga kjo Ministri nuk është e mirë (9.52%) dhe, së treti, për shkak të politikave ndaj personelit (8.16). (Shih Fig. 11)






Figura 11. Arsyet e opinionit negativ për Ministrinë e Mbrojtjes

Një pyetje tjetër që iu parashtrua të anketuarve ishte nëse Shqipëria ka ose jo nevojë për një ushtri të fortë. Në përgjigjet e tyre rreth 74.5% e të intervistuarve u shprehën në favor (plotësisht dakord, dakord dhe deri diku dakord) të një ushtrie të fortë shqiptare, kurse 24.37% të tjerë nuk ishin dakord me nevojën e Shqipërisë për një ushtri të fortë. (Shih Fig. 12)

Ndërsa analiza e përgjigjes në favor të një ushtrie të fortë shqiptare do të ishte lehtësisht e menaxhueshme (pasi shkaqet për të burojnë nga eksperiencia jonë historike, nga ndryshimi i kërcënimeve ndërkombëtare dhe nevoja për të pasur një ushtri të aftë t'u përshtatet atyre, nga pozita jonë gjeopolitike dhe nga politikat e disa prej fqinjëve tanë, por edhe nga situata e mjeruar në të cilën ndodhej ushtria jonë deri në fillim të viteve 2000), duhen parë më në thellësi shkaqet e përgjigjes së 24.37% të të anketuarve, që përbëjnë një pjesë të konsiderueshme të kampionit (thua jse 1/4 e tij), se Shqipërisë nuk i duhet një ushtri e fortë. Kështu, për të analizuar më mirë perceptimet e publikut, të anketuarve u janë drejtuar disa pyetje në lidhje me aspekte të veçanta të aktivitetit të Forcave të Armatosura.




Figura 12: A i duhet Shqipërisë një ushtri e fortë?




Figura 13: Ushtria shqiptare është e armatosur mirë

Duket se të anketuarit shfaqen të ndarë në pozicionin e tyre ndaj disa pohimeve në lidhje standardet apo infrastrukturën e sektorit. Figura 13 (më poshtë) është një provë e qartë e këtyre qëndrimeve (rreth 40% e të anketuarve janë plotësisht / dakord me pohimin, kurse 36% aspak dakord ose neutral apo nuk kanë informacion) të cilat mund të vijjnë gjithashtu edhe nga mungesa e informacionit.

Thuajse e njëjta ndarje e qëndrimeve si më sipër, por me një përqindje më të lartë të qëndrimit “deri diku dakord”, shfaqen përgjigjet e të anketuarve ndaj pohimit se Forcat e Armatosura kanë standarde të larta profesionale. (Shih Fig. 14)



nale

uarve (mbi 80%) bien dakord ka të bëjë me rolin dhe kontributin e Forcave të Armatosura shqiptare për paqen në botë, supozim i cili normalisht është më pak i prekshëm për të gjithë shqiptarët. (Shih Fig. 15)




Figura 15: Ushtria shqiptare kontribuon për paqen në botë

Mbase më i prekshëm për publikun shqiptar do të ishte roli i Forcave të Armatosura në ndihmë të komuniteteve vendore në situata krizash dhe emergjencash civile në mbështetje të popullsisë dhe autoriteteve për menaxhimin dhe lehtësimin e pasojave të tyre. Ndonëse një përqindje më e ulët sesa në rastin e kontributit për paqen në botë, një shumicë gjithësesi e konsiderueshme e të anketuarve janë plotësisht / dakord në lidhje me rolin pozitiv të Forcave të Armatosura në ndihmë të komuniteteve vendore - mbi 70% e tyre. (Shih Fig. 16)




Figura 16: Ushtria shqiptare kontribuon komunitetet vendore

E megjithatë të krijohet përshtypja sikur ky rikthim gradual i besimit të opinionit publik është ende i brishtë, veçanërisht kur bëhet fjalë për Ministrinë e Mbrojtjes. Kur të intervistuarit pyeten nëse mendojnë se Ministria e Mbrojtjes i shpenzon drejt paratë e taksapaguesve shqiptarë, “Aspak dakort” me një pohim të tillë shfaqen rreth 29% e të anketuarve, kurse rreth 34% të tjerë deklarojnë se “nuk e dinë”. (Shih Fig. 16)




Figura 17:  
Forcat e Armatosura  
i shpenzojnë drejt  
paratë e  
taksapaguesve

Duket se kjo lidhet me reagimin (thujse në të njëjtat shifra) e të intervistuarve ndaj pyetjes lidhur me transparencën e procedurave të blerjes së armatimeve, ku rreth 29% e tyre mendojnë se procedurave të blerjes së armatimeve u mungon totalisht transparenca, ndërsa rreth 31.6% të tjerë shprehen se nuk kanë një përgjigje, përkundrajt vetëm rreth 37.5% në total (“shumë dakord”, “dakord” dhe “deri diku dakord”) që shprehet se ka transparencë. (Shih Fig. 18)

Figura 18: Ministria e Mbrojtjes përdor procedura transparente në blerjen e armatimeve

Gjithashtu, thujse i njëjti perceptim (ndonëse pak më shumë pozitiv) shfaqet edhe në lidhje me transparencën e Ministrisë së Mbrojtjes në kuadër të politikave të mbrojtjes. (Shih Fig. 19)




Figura 19: Ministria e Mbrojtjes është transparente në fushën e politikave të mbrojtjes

Një tjetër aspekt që lidhet pikërisht me çështjen e imazhit që Ministria e Mbrojtjes dhe ushtria ka në opinionin publik është perceptimi i këtij të fundit për përkujdesjen e këtyre institucioneve për personelin e tyre civil dhe ushtarak. Figurat 20 dhe 21 shfaqin opinionet e të anketuarve, të cilat për të dy institucionet rezultojnë pozitive për rreth 60% prej të anketuarve.

Fig. 20: Forcat e Armatosura kujdesen për personelin e tyre





Fig. 21: Ministria e Mbrojtjes kujdeset për personelin e saj



Por përkundrejt këtyre qëndrimeve, sipas të anketuarve përkujdesja nuk nënkupton përkujdesje ekonomike dhe nuk shtrihet në rrafshin ekonomik, pasi për këtë të fundit opinioni shfaqet ngurrues dhe përgjithësisht negativ (vetëm 34% e të anketuarve janë plotësisht / dakord me pohimin. (Shih Fig. 22)

Figura 22: A janë të mirëpaguara Forcat e Armatosura?

Së fundi, një e dhënë mjaft interesante vjen nga pyetja mbi burimet e informacionit të të intervistuarve për çështjet e Ministrisë së Mbrojtjes dhe Forcave të Armatosura. Si mund të shihet nga Fig. 23 më poshtë, rreth 78% e të intervistuarve e marrin këtë informacion nga media audiovizuale (përgjithësisht televizioni, gazetat dhe interneti). Nëse këtë e lidhim me perceptimet e sipërpërmendura të aspekteve të ndryshme të fushës, atëherë rezulton se produkti i opinionit pozitiv të të anketuarve është krijuar në saje të impaktit që media ka pasur mbi ta, kryesisht duke nxjerrë në pah elemente të caktuara të veprimtarisë politike e ushtarake që lidhet me Forcat e Armatosura, si stërvitjet e përbashkëta, integrimin në NATO, vizitat e nivelit të lartë të lidhshimit të NATO-s në vendin tonë, misionet ndërkombëtare, e kështu me radhë.



Nëse kjo lidhet edhe me faktin se vetëm një pjesë e vogël e tyre kanë punuar ose kanë pasur lidhje me Ministrinë e Mbrojtjes ose Forcat e Armatosura, atëherë përfundimi i sipërpërmendur bëhet edhe më bindës, çka nënkupton se politikëbërësit dhe opinionbërësit qoftë në strukturat e Ministrisë qoftë në ato të Forcave të Armatosura duhet të vazhdojnë të punojnë në këtë drejtim, duke forcuar ndoshta aspektet më të dobëta të burimeve të informacionit, si gazetatat dhe informacionin virtual.




Figura 23: Burimet e informacionit mbi çështjet e mbrojtjes

Në përgjithësi mund të themi se opinioni publik shqiptar, i përfaqësuar në kampionin prej rreth 600 të intervistuarish, rezervon për ushtrinë dhe Ministrinë e Mbrojtjes një pikëpamje pozitive. Gjithsesi, ky opinion përgjithësisht pozitiv nxjerr në pah disa të meta e hendeqe që tregojnë se ndonëse Forcat e Armatosura mund të konsiderohen një institucion që ka kaluar me sukses shumë prova integruese euroatlantike, ato vazhdojnë të mbeten peng i hapave më të ngadaltë të institucioneve të tjera.

**Dr. SIMON GEGA**

## FORCAT E ARMATOSURA, TRANSPARENCA DHE SHOQËRIA CIVILE

Në vijim të të gjithë atyre problemeve që u trajtuan, më lejoni të sjell para jush edhe një aspekt mjaft të rëndësishëm për veprimtarinë e Forcave të Armatosura, i cili në njëfarë mënyre luan rol përcaktues në zhvillimin e vetë Forcave të Armatosura.

Tashmë jemi të vetëdijshëm se siguria e një vendi nuk mund të reduktohet vetëm si funksion i një instrumenti shtetëror, qoftë ky edhe ai i Forcave të Armatosura. Kjo për faktin se faktorët që lidhen me të janë shumëdimensional dhe shumë të sofistikuar.

Natyrisht, trajtimi i këtij problemi ka sjellë ndërmarrjen e shumë hapave, të cilët synojnë shmangien e përdorimit të forcës në realizimin e një sigurie me bazë sa më të gjerë. Mirëpo pavarësisht nga masat e marra, pavarësisht nga angazhimi i shumë strukturave e mekanizmave të ndryshëm politikë, shoqërorë e ekonomikë, faktori ushtarak, pra ai i përdorimit të forcës, edhe për shumë kohë do të jetë i pranishëm në të gjithë momentet kur siguria do të cenohet, dhe kjo qoftë në aspektin psikologjik ashtu edhe atë fizik.

Demokracia në radhë të parë presupozon siguri brenda një kuadri ligjor. Kjo do të thotë vetëdije për përdorimin e të gjitha mjeteve që mundësojnë efikasitetin e ligjit. Kjo nënkupton edhe përdorimin e forcës si instrumenti i fundit ligjor.

Në këtë kuadër, administrimi politik i dhunës së organizuar, konsiderohet një bazë e fuqishme e sistemit demokratik, por ajo është jo e plotë nëse opinioni publik nuk është i familjarizuar dhe i mirinformuar për atë që ndodh dhe si përdoren instrumentet e dhunës, në të cilin roli vendimtar i takon Forcave të Armatosura.

Nisur nga nevoja për mbështetje të vazhdueshme dhe të gjithanshme, në radhë të parë Forcave të Armatosura, stafit të drejtimit politik dhe

ushtarak, u intereson që, shoqëria dhe opinioni jo vetëm ta kuptojë domosdoshmërinë e investimit, por edhe t'i pranojë ato si një institucion i cili duhet trajtuar me prioritetet në krahasim me institucionet e tjera të shtetit. Ky prioritet ka bazën e vet në koston e lartë sociale, politike dhe ekonomike të angazhimit dhe ndonëse ky angazhim mund të mos paraqitet si i domosdoshëm, ai duhet trajtuar si i pranishëm në çdo moment.

Mirëpo, duhet të pranohet publikisht se situatat, politike sociale e ekonomike nuk mund të perceptohen nga opinioni si problematike dhe as evidente më parë se ato të ndodhin. Për këtë arsye edhe politika jo rrallë bie në këtë opinion duke reduktuar dhe ndërhyrë ne reforma të njëpasnjëshme jo efektive në strukturat e sigurisë dhe në veçanti në Forcat e Armatosura.

Natyrisht kjo është e kuptueshme, pasi e prekshme është ana financiare e cila rëndohet nga buxheti i Forcave të Armatosura, mirëpo kjo në fakt rëndon dukshëm personalitetin e ushtarakut dhe të vetë Forcave të Armatosura.

Arsyet janë të shumta, por një ndër to është eksperiencia jo e mirë që kemi për profesionin shtetëror dhe publik të ushtarakut që shërben në këto institucione. Duhet të kuptohet se deri më sot ushtaraku i është përkushtuar vetëm këtij profesioni pa pasur mundësi një zgjidhje tjetër, kështu që ndërprerja e njëanshme nga shteti, në një moshë relativisht madhore e me ndikime sociale, do të thotë pasoja të rënda për personalitetin e ushtarakut jo vetëm ekonomikisht, por edhe publikisht për Forcat e Armatosura.

Për këtë e të tjera si këto, stafet ushtarake të drejtimit nëpërmjet lidhjes e bashkëpunimit me personalitetet publike, politike, akademike mediatike e shoqërore me ndikim në jetën shoqërore e politike të vendit, përpiqen të marrin mendimin e tyre duke përcaktuar strategji afatgjate zhvillimi e mbështetje me qëllim që jo vetëm të ruhet personaliteti i krijuar por edhe të zhvillohet më tej ai duke krijuar mundësi për integrim të shpejtë në shtet e shoqëri.

Ky është një proces në të cilin, mendimi ushtarak gjen mbështetje e përkrahje por edhe mendimi i intelektualëve civilë gjen mishërimin e vet në profesionalizmin ushtarak, duke u shndërruar në strategji të sigurisë kombëtare.

Ky lloj bashkëpunimi, të cilin e gjejmë edhe sot në këtë konferencë, që organizon sot Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim, siguron jo vetëm mbështetjen, por edhe transparencën e nevojshme për synimet dhe objektivat në fushën e mbrojtjes, si dhe me shqetësimet e problemet që kanë lindur.

Është me vend të theksojmë se krijimi i “Tavolinave të rrumbullakëta” të intelektualëve më të shquar të vendit për të diskutuar çështje të tilla madhore si janë zhvillimet e brendshme në Forcat e Armatosura apo ato të pritshme të saj, nuk janë ndonjë shpikje shqiptare, por një eksperiencë që tashmë shumë vende të zhvilluara e kanë të institucionalizuar. Marrja e mendimit të këtyre intelektualëve për ekspertizën përkatëse për problemet që shqetësojnë Forcat e Armatosura aq sa është një zgjidhje në të cilën përfshihen shumë interesa, është edhe një qëndrim dinjitoz i drejtuesve ushtarakë ndaj intelektualizmit shoqëror të cilët i konsiderojnë Forcat e Armatosura pjesë të përgjegjshmërisë intelektuale duke siguruar një mbështetje bindëse edhe nga vetë opinionin publik.

Tashmë e dimë se vlera e një informacioni të saktë tregon seriozitet dhe apelon për një qëndrim korrekt, si në kuadrin e brendshëm në Forcat e Armatosura ashtu edhe atë me shoqërinë e opinionin në tërësi, ndërsa një informacion i detajuar apelon për mbështetje, mirëkuptim e deri sakrificë. Shembuj në këtë drejtim secili prej nesh është në gjendje të gjejë duke përcaktuar edhe vetë defektet e punës sonë apo të institucioneve të caktuara. Përfshirja e shumë mendimeve intelektuale në zhvillimet e brendshme të Forcave të Armatosura duhet të jetë një prioritet i veprimtarisë drejtuese për to.

Krijimi i këtyre tavolinave, që sipas rastit mund të jenë për të gjitha çështjet që lidhen me veprimtarinë e Forcave të Armatosura, krijon hapësirat e nevojshme për realizimin e transparencës për mënyrën e hapjes e daljes bindshëm në shoqëri, për mënyrën e trajtimit e të konceptimit të problemeve të brendshme e të perspektivës së Forcave të Armatosura, por edhe lartëson figurën dhe personalitetin e vetë Forcave të Armatosura në opinionin publik.

Nëse i hedhim një sy legjislacionit të Forcave të Armatosura, vihet re se fryma e “mbylljes” ushtarake është e pranishme. Për mua është e

patolerueshme që në hartimin e bazës legislative të mos marrin pjesë institucionet e tjera. Me këtë nuk injoroj faktin e shprehjes së mendimit për çdo ligj, por pjesëmarrjen direkte në hartimin e tij e konsideroj një çështje parimore. Kjo ka edhe një logjikë të thjeshtë; se si i duan Forcat e Armatosura nuk e dinë ushtarakët, por pjesa tjetër jashtë tyre, se si e kërkojnë ushtarakun në sytë e opinionit publik kombëtar dhe ndërkombëtar janë po ato që mund të shprehen.

Për hir të së vërtetës hartimi i këtyre ligjeve e programeve të zhvillimit nga vetë ushtarakët, ka qenë aq korrekt sa krahasimi për të gjithë kërkesat është bërë në nivelin më të ulët të shoqërisë dhe kjo për hir të konceptit të “ruajtjes së të njëjtit standard” me shtresat e tjera të popullsisë, duke shmangur trajtimet e privileguara. Jam tërësisht i bindur se nëse këto ligje do të ishin hartuar në këtë lloj tavoline si kjo konferencë, ata do të kishin qenë shumë më të mirë se sa janë sot dhe se ushtarakët do të kishin një trajtim tjetër e më dinjitoz.

Me këtë desha të evidentoj se transparenca dhe hapja nuk janë as ditët e hapura, as ceremonitë në pritje-përcjellje, as ndonjë ceremoni festive apo përvjetor, të cilat mund të konsiderohen si praktika defektoze për transparencën e marrëdhëniet me publikun.

**Kërkesa e parë** për një bashkëpunim produktiv me mjedisin politik dhe shoqëror është: Transparenca dhe bashkëpunimi me median, personalitetet publike e politike, shkencore e fetare, organizatave jo fitimprurëse, institucioneve të shoqërisë civile si ky sot, **nuk mund të jetë në një rrugë me një kalim dhe vetëm për një kolonë.** Transparenca në Forcat e Armatosura nuk ka kufizime dhe nuk mund të jetë vetëm për të evidentuar respektin ndaj ligjit. Ajo është e gjithanshme dhe shumë komplekse, ajo duhet të jetë në radhë të parë brenda vetvetes dhe me opinionin publik në respekt të plotë se edhe gabimi e paraqitja e tij e hapur janë akt civilizimi dhe apel në opinion për eliminimin e tyre. Fajet ndëshkohen dhe për to nuk ka transparencë por ekspertizë ligjore për përgjegjësitë.

Është rasti të themi se opinionin publik, për të mos thënë edhe ai i brendshëm, rrallë e ka marrë vesh se cilët janë zhvillimet e pritshme apo aktuale në Forcat e Armatosura. Cilat janë reformat dhe cili është opinionin i brendshëm ushtarak për to?

Transparencë nuk mund të bësh atëherë kur të është evidentuar fenomeni si problematik. Parimisht siç është rasti i Dhëmbanit, Gërdecit apo ndonjë fenomeni tjetër me ndikim në opinionin publik, qoftë edhe një stërvitje e madhe me pjesëmarrje të shumë trupave, transparenca merr fund, ka vetëm informim duke shmangur çdo lloj ndikimi emocional.

Çdo përpjekje për transparencë në të tilla raste konsiderohet “përpjekje për të mbuluar shkaqet e vërteta”. Vërtetësia nuk është objekt i transparencës apo i debatit publik, ai është një proces i mbyllur ose i hapur sipas vendimeve të institucioneve të specializuara.

Për këtë arsye objekt i transparencës, veç të tjerave, janë sistemi i arsimit e i drejtimit, marrëdhëniet ndërmjet forcave e strukturave, menaxhimi i personelit dhe burimet e mbështetjes, angazhimet operacionale dhe perspektiva e zhvillimit, mundësitë e financimit dhe investimet e pritshme, mënyra e prokurimit dhe veçoritë që shoqërojnë procesin etj. etj.

Efekt shumë pozitiv në opinionin publik ka realizimi i transparencës së veprimtarisë që **në hapin e parë të marrjes së nismës për një vendim të pritshëm**. Natyrisht kjo ka bazën e vet logjike në veprimtarinë drejtuese e operacionale për Forcat e Armatosura, pasi një vendim i mirë ka temp të shpejtë realizimi. Me këtë rast është me vend të risjellim në vëmendjen e të gjithëve se vendimet emocionale janë shumë të vështira për t’u zbatuar dhe aq me tepër vendime të cilat janë hartuar e miratuar nga një rreth shumë i mbyllur kanë shumë gjasa për të mos u zbatuar ose nëse zbatohen sjellin shumë vështirësi duke përkeqësojnë gjendjen. Kjo sepse në radhë të parë kërkon konsumim energjie për t’u kuptuar e më pas për t’u imponuar në interesa të cilat mund të mos jenë objekt i interesit të përgjithshëm.

Përfshirja e medias në këtë “lojë” për realizimin e transparencës dhe hapjes është një nga parimet themelore të veprimtarisë drejtuese në Forcat e Armatosura. Nuk është vetëm interneti apo shtypi i shkruar që realizon transparencën, pasi ai ka autor ata që janë përgjegjës për zbatimin dhe dihet ndikimi në të tilla raste. Prandaj **mjetet për realizimin e transparencës** janë tërësisht të mundshme dhe teknika

efikase të veprimtarisë drejtuese në Forcat e Armatosura për realizimin e bashkëpunimit të strukturave ushtarake me ato civile.

Aspekti me ndikim negativ në opinionin publik është **informacioni i rëndomtë dhe rutinë** me natyrë të njëjtë. Të tilla fenomene e largojnë vëmendjen e opinionit nga veprimtaria e Forcave të Armatosura. Organizimi i ceremonive të ndryshme, siç u theksua më sipër, sa herë mbarojnë kurse, stërvitje apo evenimente të tjera me pompozitet, nuk mund të jenë objekt i transparencës dhe as i informimit publik. Të gjithë e dimë se kush mund të konsiderohet lajm dhe kush e dëmton imazhin në opinionin publik.

Transparenca në opinionin publik ka vlera kur ajo bëhet me objekt të caktuar dhe në vijimësi për të gjitha problemet që kanë ndikim në mjedisin shoqëror mediatic apo intelektual. E rëndësishme është që për probleme madhore transparenca apo dalja në publik nuk mund të delegohet si ndodh rëndom te zëdhënësi apo ndonjë përfaqësues tjetër. Me këtë rast bëjmë një dallim ndërmjet Dhëmbanit dhe Gërdecit ndonëse kjo nuk ka lidhje me transparencën, por me informimin. Në rastin e Dhëmbanit zëdhënësit ishin në hije, drejtuesit kryesorë morën përgjegjshmërinë për atë që ndodhi.

Transparenca ka përmbajtje të dyfishtë. Nga njëra anë ajo duhet të jetë e vazhdueshme dhe për të gjitha problemet **brenda përbrenda** Forcave të Armatosura për motivimin e ushtarakëve dhe punonjësve që shërbejnë në këto forca dhe nga ana tjetër duhet të jetë **e jashtë** me shoqërinë dhe institucionet e tjera të shtetit për sigurimin e mbështetjes së nevojshme.

Jo rrallë ka ndodhur që më të informuar kanë qenë të huajt për zhvillimet në Forcat e Armatosura se sa vetë ushtarakët shqiptarë dhe për këtë arsye jo rrallë ndodh që ne u drejtohem praktikave të cilat tashmë janë të papranueshme, si në emërimin e personelit ashtu edhe në hartimin e programeve të zhvillimit e problemeve të tjera.

Për mua është “abuzim politik” i veshur me ligj emërimi i personelit ushtarak nga politika dhe aq më keq kur edhe transparenca e brendshme deri në daljen e aktit administrativ mungon.

Vendosja përpara faktit të kryer, cenon një nga parimet kryesore të drejtimit. Nuk mund të mendohet për një veprimtari të suksesshme

drejtimi pa një informim të saktë dhe nuk mund të këtë sakrificë pa një mirinformim për arsyet madhore për aktin që do të kryhet për vendimin e marrë. Transparenca është pjesa qendrore e lindjes së motiveve për të realizuar vendimin dhe vendimi kërkon motivim të njerëzve për të qenë pjesë e zgjidhjes.

Kështu transparenca nxit interesimin për pjesëmarrje aktive me kontribute reale, krijon shtratin e ngrohtë për bashkëpunim dhe mbështetje të vazhdueshme, krijon klimë familjare në trajtimin e problemeve duke gjetur zgjidhjen më të mirë të mundshme duke e mbështjellë institucionin me besimin dhe respektin që kërkon.

Këtë duhet të bëjë intelektualizmi ushtarak dhe për këtë arsye kërkesa për evidentimin e personaliteteve publike ushtarake është më se e domosdoshme.



## BESART LUKMETA

(GAZETAR SMN)

### TRANSPARENCA NË MARRËDHËNIET CIVILO-USHTARAKE

Duke pasur parasysh të dhënat e studimit të prezantuar nga IDN, mbi aprovimin që marrin Forcat e Armatosura në Republikën e Shqipërisë, do doja të vija në dukje që ky aprovim është i lartë edhe në vende të tjera. Madje edhe në vende të përfshira në konflikte jopopullore si Shtetet e Bashkuara dhe Britania në Irak.

Por, megjithatë, eksperiencia ndërkombëtare e sondazheve të perceptimit publik të Forcave të Armatosura, ka treguar që ka një hendek të madh midis perceptimit të Forcave të Armatosura në vetvete dhe drejtimit apo menaxhimit të tyre. Për shembull, në qoftë se studimi i IDN-së tregon që më shumë se dy të tretat e shqiptarëve i shohin në mënyrë pozitive Forcat e Armatosura, kjo nuk do të thotë që i njëjti aprovim do të shfaqej po të bëhej një anketim për drejtimin e tyre.

Në Shtetet e Bashkuara edhe në kulmin e protestave kundër luftës në Irak, ku aprovimi i Presidentit Xhorxh W. Bush për menaxhimin e tij të luftës ishte i ulët, perceptimi pozitiv për Forcat e Armatosura vazhdonte të ishte i lartë.

Një specifikë tjetër, që tregon këtë hendek, ka të bëjë me gjetjen e sondazhit, ku shumica e të pyeturve përgjigjen që informacionin për Forcat e Armatosura e marrin nga media. Duke konsideruar që në vitet e fundit mbulimi i medias për Forcat e Armatosura ka qenë kryesisht negativ, përtej anëtarësimit në NATO, me ngjarje të tilla si: shpërthimi i Gërdecit, shpërbërja e ushtrisë gjatë anarkisë së vitit 1997, tragjedia e 11 janarit në kanalën e Otrantos, duket kundërintuitive që të ketë një aprovim të lartë të menaxhimit dhe drejtimit të Forcave të Armatosura.

Ngjarje më aktuale, si për shembull marrëveshja për kufirin me Greqinë, tregojnë që ka një nevojë më të madhe transparence nga

institucionet e sigurisë kombëtare, sidomos kur çështje specifike diskutohen në media dhe bëhen pjesë e debatit publik. Në rastin në fjalë ka pasur një ndrojtje nga Forcat e Armatosura për të ofruar ekspertizë dhe rrjedhimisht transparencë për marrëveshjen, gjë që ka krijuar një atmosferë spekulimi dhe në median shqiptare, e cila nuk është e trajnuar dhe nuk ka gazetarë specifikë të specializuar në mbulimin e çështjeve ushtarake dhe të sigurisë kombëtare.

# V

## *Praktikat më të mira ndërkombëtare, Forcat e Armatosura Shqiptare dhe kontrolli civil: raport mbi situatën aktuale*

---

### **PANELI IV**

---

**BARD B. KNUDSEN**

(EKSPERT I LARTË I DCAF-së)

Në këtë prezantim, do të flas në mënyrë më të detajuar mbi çështjen e Forcave të Armatosura dhe kontrollin civil, ose më saktë, mbi marrëdhëniet civilo-ushtarake. Megjithatë, nuk do të zgjatem shumë, me qëllim që t'i lë kohë mjaftueshëm IDN-së për të prezantuar raportin e saj mbi sondazhin e marrëdhënieve civilo-ushtarake, që u krye në Shqipëri këto muaj, si dhe të lë kohë mjaftueshëm për komentet dhe diskutimet, pas paraqitjes së saj.

Fillimisht do t'i referohem situatës në Norvegji. Besoj, se shembuj nga vende të tjera të vogla europiane mund të kenë interes për ju. Norvegjia, në fund të fundit, ka vetëm 4.7 milionë banorë, që nuk ndryshon shumë nga popullsia e Shqipërisë me 3.1 milionë. Por, për sa i përket hapësirës territoriale Norvegjia dhe Shqipëria ndryshojnë në mënyrë të konsiderueshme: Territori i Norvegjisë është rreth 13 herë më i madh se ai i Shqipërisë. Gjithashtu, Norvegjia ka një kufi të përbashkët me një fuqi të madhe europiane - Rusinë, ndërsa Shqipëria, pas shpërbërjes së ish-Jugosllavisë, ka kufij të përbashkët me vende që janë relativisht të vogla, në një kontekst europian më të gjerë.

Do të fokusohem më tepër në atë që shpesh është quajtur “Praktikat më të mira ndërkombëtare”. Nuk do të pretendoj që Norvegjia është midis më të mirave. Ne kemi problemet tona, gjithashtu, dhe tranzicioni që u krijua pas fundit të Luftës së Ftohtë, nuk ishte gjithmonë i lehtë. Në fakt, mendoj që reforma e mbrojtjes, për shembull, ka qenë një proces i vështirë dhe shpeshherë i dhimbshëm, në të dyja anët e ish-Perdes së Hekurt. Reforma e mbrojtjes ka përfshirë aspekte të rëndësishme të lidhura me marrëdhëniet civilo-ushtarake.

Dje, nxora në pah se ekzistojnë ndryshime të konsiderueshme në qeverisjen e sektorit të sigurisë midis shteteve si në Europë ashtu edhe më gjerë në botë. Këto ndryshime janë pasojë e mungesës së ngjashmërisë në historinë, kulturën, traditën politike dhe në sistemin kushtetues të secilit vend. Pavarësisht kësaj, parimet demokratike përfshijnë ngjashmëri të rëndësishme. Dhe këto ngjashmëri mendoj që duhet t’i emërtojmë si “Praktikat më të mira ndërkombëtare”.

Kur përdorim termin “më të mira”, ne sigurisht që jemi duke bërë një gjykim vlere. Parimet demokratike na pajisin ne me matësin e përshtatshëm për atë gjykim. “Praktikat më të mira”, si rrjedhojë, i referohen mënyrës se si janë përshtatur parimet demokratike, apo do ishte më saktë të thuhej, se si janë zbatuar ato në praktikë. Të gjithë e dimë se ligjet që janë mjaft demokratike në letër, nuk mund të zëvendësojnë zbatimin dhe praktikën, të cilat vënë në jetë tërësisht frymën e ligjit. Qëllimet e mira nuk mjaftojnë, sepse veprimet flasin me zë më të lartë.

Siç edhe themi ne në Norvegji: “Rruga për në ferr është e shtruar me qëllime të mira”. Sigurisht, qëllimet e mira janë një pikë e shkëlqyer nisjeje. Por, pa u shoqëruar nga veprime bindëse, ato nuk janë edhe aq.

Më lejoni të vë në pah disa elemente kyç të marrëdhënieve civilo-ushtarake, se si ato duhet të funksionojnë në një shtet demokratik. Nuk pretendoj që të përfshijë gjithçka, por thjesht t’ju jap disa ide për diskutimin mbi sondazhin e marrëdhënieve civilo-ushtarake këtu në Shqipëri, i cili do të paraqitet pas prezantimit tim. Elementët mbi të cilët unë do të fokusohem janë:

- Kontrolli civilo-politik
- Mundësia për konflikt ndërmjet kërkesave politike dhe këshillave profesionale ushtarake
- Forcat e Armatosura dhe shoqëria civile

### Kontrolli civilo-ushtarak

Çështja e kontrollit civilo-ushtarak shkon deri në zemër të vendimmarrjes politike të sigurisë. Edhe në rast se njësitë kryesore të Forcave të Armatosura janë të pakënaqura me politikat e qeverisë, nuk duhet të vihet në dyshim se kush ka autoritetin e legjitimuar. Forcat e Armatosura duhet t'i jenë 100% besnike qeverisë demokratike të vendit si dhe të mos ndërhyjnë në vendimmarrjen politike të vendit të tyre.

Forcat e Armatosura janë një instrument i politikës së sigurimit. Ata nuk janë një aktor politik i ndarë. Carl von Clausewitz, rreth 200 vjet më parë, e shprehu në këtë mënyrë lidhjen midis tyre: “Lufta nuk është gjë tjetër veçse vazhdim i politikës me mjete të tjera”. Në botën e sotme, parapëlqimi kryesor është që të përdoren mjete të tjera të ndryshme nga lufta, për të arritur objektivat politike. Pavarësisht kësaj, pika kryesore e Clausewitz ngelet e vërtetë: Përdorimi i Forcave të Armatosura u shërben objektivave politike edhe në veprimet paqeruajtëse apo në situatat e tjera, ku gjuajtja lejohet vetëm për vetëmbrojtje. Objektivat politike të një vendi përcaktohen nga qeveria, në bashkëpunim të ngushtë me parlamentin dhe jo me Forcat e Armatosura.

### Mundësia për konflikt ndërmjet kërkesave politike dhe këshillave profesionale ushtarake

Forcat e Armatosura, si një instrument i politikave të sigurisë, gjenden shpeshherë të shtrënguara midis asaj çka është e dëshirueshme politikisht dhe asaj çka është e mundshme ushtarakisht.

Në terma të përgjithshëm, qeveria nuk mund të presë që Forcat e Armatosura të arrijnë disa objektiva politikë të caktuar, nëse: 1) ato janë të pamundura nga ana ushtarake ose 2) Forcat e Armatosura nuk mund ta bëjnë një gjë të tillë të vetme, por kanë nevojë edhe për

përdorimin paralel të instrumenteve të tjera të politikës së sigurisë, në atë çka quhet qasja gjithëpërfshirëse dhe e integruar.

Për të menaxhuar këtë kontradiktë, qasja tradicionale ka shprehur se roli i qeverisë është që të formulojë objektivat politikë, duke përfshirë edhe caktimin e disa detyrave të Forcave të Armatosura, të cilat qeveria pret që ato t'i kryejnë. Më pas, Forcat e Armatosura do të përdorin ekspertizën e tyre ushtarake dhe do të përgjigjen me vlerësimet e tyre se si do të mund të realizohen. Kjo qasje vijuese në analizat përfundimtare, shpesh reduktohet në të ardhurat dhe përmasat e buxhetit. Në të gjithë e dimë përgjigjen ndaj asaj pyetjeje: Forcat e Armatosura normalisht që do të kërkojnë më tepër para se sa qeveria është e përgatitur për t'u dhënë atyre.

Tani, ky aspekt i buxhetimit të qeverisë nuk është vetëm për ushtrinë. Të gjithë sektorët publikë kërkojnë më tepër para se sa është e mundur. Argumenti im këtu është se qasja vijuese nuk është e mirë. Ajo e ndan anën ushtarake së tepërmi nga vendimmarrja politike si dhe veçon anën politike së tepërmi nga realitetet ushtarake.

Kjo është arsyeja se pse tendencat ndërkombëtare gjatë viteve të fundit kanë qenë në drejtim të ministrive të mbrojtjes të integruara. Në Norvegji ne e paraqitëm atë në vitin 2003. Me lëvizjen e shefit të Shtabit në Ministrinë e Mbrojtjes, dhe shtimin nga Ministria me 100 oficerë stafi duke arritur në një personel prej 300 vetash, Shtabi i Përgjithshëm i periudhës së Luftës së Ftohtë, që ishte tepër i madh, u shpërbë. Në vend të saj, u krijua një Staf Mbrojtjeje më i vogël dhe i ri, por pa pasur përgjegjësi për funksionet strategjike të shefit të Shtabit. Këto u zhvendosën në Ministrinë e Mbrojtjes. Si pasojë, reforma shkriu si nivelin politik-strategjik ashtu edhe atë ushtarak-strategjik në një Ministri Mbrojtjeje të integruar.

Ministria e Mbrojtjes së integruar siguron bashkëpunim të ngushtë dhe dialog të përhershëm midis anës civile dhe ekspertizës së tyre me ekspertizën ushtarake. Kështu që, këshilla ushtarake profesionale është një pjesë integrale e procesit të vendimmarrjes politike dhe këshilla që shkon në nivelin politik, në Ministrinë e Mbrojtjes, mbështetet si në konsideratat politike ashtu edhe në ato ushtarake.

Nuk ka arsye për të fshehur që ky “revolucion” ka pasur mjaft pengesa, si p.sh. në rastin e Norvegjisë. Një pengesë ishin ndryshimet në kulturën organizative, një tjetër ishte që ana ushtarake ndjeu që humbi “autonominë” e saj dhe disa prej identiteteve institucionale. Kishte mjaft dyshime për ta nisur atë. Megjithatë, duke qenë se ana civile dhe oficerët ushtarakë filluan ta njihnin njëri-tjetrin më mirë dhe u krijua besimi midis tyre, gjërat filluan të zbuteshin më shumë. Të dyja palët arritën në përfundimin se pala tjetër solli *know-how* si dhe kompetenca në tavolinë, që ata të vetë nuk e zotërojnë. Një tjetër përfitim është se tashmë Ministria e Mbrojtjes është e aftë që të merret me çështje politiko-ushtarake të komplikuara shumë më shpejt se më parë. Në këtë kuptim, Ministria e Mbrojtjes e integruar është shumë më efiçente se sa qasja e mëparshme.

Si përfundim, me kulturën e duhur organizative, Ministria e Mbrojtjes e integruar mund të kombinojë besnikërinë politike me integritetin profesional në një mënyrë mjaft konstruktive.

### **Forcat e Armatosura dhe shoqëria civile**

Në mjaft vende Forcat e Armatosura kanë qenë një pjesë integrale e proceseve historike kombformuese. Kjo trashëgimi ka si aspekte pozitive ashtu edhe negative. Nga ana pozitive, ajo lidh ngushtësisht Forcat e Armatosura me “kombin” - ose njerëzit me memorien e tyre kolektive. Nga ana negative, trashëgimia nga e kaluara mund të vonojë apo vështirësojë reforma të rëndësishme si dhe mund të reduktojë fleksibilitetin e vendit, për të përballuar sfida të reja dhe të ndryshme të sigurisë.

Tranzicioni në shumë prej vendeve europiane, nga ushtri universale të mëdha në Forca të Armatosura më të vogla dhe profesionale, e ilustron argumentin. Por, në Norvegji, ne nuk e kemi flakur tutje rekrutimin ushtarak madje, ju mund të thoni se ne kemi shkuar në drejtimin e kundërt, në kuptimin që ne nuk flasim më për rekrutimin ushtarak të meshkujve të rinj, por gjithashtu edhe të fermave të reja. Megjithëkëtë, ka ndodhur një ndryshim thelbësor. Norvegjia ka kaluar nga një ushtri masive e mobilizuar në një forcë më të vogël, më teknologjike dhe shumë më të aftë. Forcat e Armatosura të Norvegjisë,

prandaj, nuk kanë nevojë për të gjithë rekrutët e thirrur për shërbime ushtarake nëpërmjet rekrutimit universal. Në vend të kësaj, Forcave të Armatosura u lejohet që të përzgjedhin ata kandidatë që mendojnë se janë më të përshtatshëm.

Ky sistem i ri rekrutimi nxiti një debat publik të fortë në Norvegji, ku shoqëria civile ishte tejet e përfshirë. Argumenti kryesor kundër këtij shërbimi ushtarak *de facto* përzgjedhës, ishte se ishte i padrejtë: disa njerëz të rinj - aktualisht, një e treta e të rekrutuarve - duhej që të shërbenin 12 muaj në Forcat e Armatosura, dhe pjesa tjetër që ngelej, duhej që të largohej pa iu dashur të bënin kështu. Ministria e Mbrojtjes u detyrua që t'u jepte përfitime shtesë atyre të rinjve që shërbenin: një bonus financiar pasi të kishin mbaruar në mënyrë të suksesshme shërbimin ushtarak. Por, si rezultoi tashmë si sektori privat ashtu edhe ai publik priren t'i pyesin njerëzit nëse kanë shërbyer në ushtri. Punonjësit e konsiderojnë shërbimin ushtarak si një shenjë që një person i ri i përket ajkës së grupmoshës së tij.

Norvegjia po kontribuon në një sërë veprimesh ushtarake ndërkombëtare, disa prej të cilave kanë të ashtuquajturat rregulla "të fuqishme" të luftimit. Për pjesën më të madhe të njerëzve, veprimet e NATO-s në Afganistan konsiderohen si "luftë". Shoqëria civile e Norvegjisë dhe organizmat politikë, nuk e pranojnë idenë që rekrutët duhet të nxirren jashtë vendit për të shërbyer në një konflikt të armatosur. Kjo është parë si e pranueshme vetëm për trupat oficere profesionale si dhe ushtarët vullnetarë. Kështu, Forcat e Armatosura i përdorin ushtarët e rekrutuar si një bazë rekrutimesh për veprime ndërkombëtare. Këta ushtarë vullnetarë, normalisht shërbejnë për një periudhë trevjeçare dhe përfaqësojnë, në fakt, njësitë themelore ushtarako-profesionale të Norvegjisë. Deri më tani nuk ka pasur ndonjë problem për të rekrutuar numrin e duhur të vullnetarëve. Nga ana tjetër, Forcat e Armatosura janë popullore dhe gëzojnë një pozitë të lartë mes njerëzve të rinj.

Norvegjia ka pasur një numër të lartë ushtarësh të vdekur në disa prej operacioneve ushtarake ndërkombëtare. Thuhet se opinioni publik dhe shoqëria civile nuk kanë për t'i pranuar kurrë fatalitete të tilla. Kjo nuk është vërtetuar. Për sa kohë që qëllimi dhe objektivat politike të luftimeve ushtarake ndërkombëtare të Norvegjisë, konsiderohen si të



drejta moralisht dhe synojnë të bëjnë gjënë e duhur - të krijojnë kushtet për zgjidhjen e konflikteve të dhunshme ose të mbrojtje populsinë civile në një zonë të konfliktit të armatosur - publiku ka qenë mbështetës dhe e ka pranuar idenë e riskut të fataliteteve.

Por, media dhe shoqëria civile në përgjithësi, ashtu sikurse edhe parlamenti, e vëzhgojnë çdo gjë që ndodh me një sy kritik. Ata duan të dinë nëse është bërë maksimumi për të mbrojtur forcat norvegjeze, nëse pajisjet e forcave janë të mira apo jo dhe nëse trupat janë stërvitur si duhet, para se të dërgohen jashtë vendit. Duan të dinë më shumë rreth operacionit në vetvete. Kjo më çon mua në çështjen e një informacioni të përshtatshëm ose hapjes dhe transparencës, dy terma që i përmenda edhe më parë.

Në vendet e hapura dhe demokratike, opinionioni publik dhe shoqëria civile në përgjithësi, kërkojnë informacion - shumë informacion dhe në ndonjë rast informacionin të mjaftueshëm. Si parim, ekziston një marrëveshje në Norvegji që hapja dhe transparenca duhet të balancohen me nevojën për të kontribuar në sigurinë e trupave tona. Kudo që Norvegjia ka pasur Forca Operative Speciale, në Afganistan p.sh., ka pasur interes të madh për të ditur se çfarë ata ishin duke bërë. Nga pala ushtarake, krejt e kuptueshme sipas meje, ka pasur pak entuziazëm për ta siguruar një informacion të tillë. Ministrja e Mbrojtjes, ishte në njëfarë mënyre, e ndarë në dy pjesë. Nga njëra ana, ajo ndiente një presion politik për t'u përgjigjur në mënyrë pozitive, nga ana tjetër ajo mban përgjegjësi para parlamentit për sigurinë e ushtarëve norvegjezë. U arrit një balancë, megjithatë dilema ende vazhdon.

Forcat e Armatosura në vetvete e kanë kuptuar tërësisht këtë dilemë. Gjatë 10-15 viteve të fundit Forcat e Armatosura norvegjeze kanë ndryshuar qëndrimin e tyre, duke kaluar nga një pozicion ku thuhet sa më pak që të ishte e mundur të treguarit të gjithçkaje që mund të thuhet. Por, ka edhe limite. Kur Forcat Operative Speciale norvegjeze rezultuan që ruanin Aeroportin e Prishtinës, në CNN më 1999-n, si pjesë e forcave të NATO-s duke hyrë në Kosovë, publiku norvegjez dhe parlamenti u kapën në befasi. Parlamenti, u konsultua sigurisht mbi kontributin e Norvegjisë në veprimet e NATO-s, por vetëm në terma të përgjithshëm. Ekzistonte një konsensus i gjerë politikë për sa i përket

nevojës për të ndaluar spastrimet etnike në Kosovë, por pak njerëz ishin informuar paraprakisht rreth misionit specifik ushtarak të forcave norvegjeze. Dhe kjo është ajo që duhet të jetë. Gjëja interesante është se opinioni publik e pranoi atë si rrjedhojë.

Informacioni që i jepet shoqërisë civile dhe publikut të përgjithshëm mbi Forcat e Armatosura norvegjeze, mbi politikën e sigurimit të vendit etj., është mjaft i zgjeruar në ditët e sotme. Komiteti i Atlantikut të Norvegjisë është duke luajtur një rol të rëndësishëm. Kështu pra, ekziston një organizatë ombrellë që përfshin bashkimet tregtare si dhe një numër organizatash të shoqërisë civile, e cila quhet “Njerëzit dhe Mbrojtja”. Faqet e internetit mbi Forcat e Armatosura të Norvegjisë janë të zgjeruara, shumë informative dhe të përditësuara në mënyrë konstante. Një organizatë e quajtur Shoqëria Ushtarake Norvegjeze që ka si anëtarë njerëz nga Forcat e Armatosura, civilë që janë zyrtarë publikë, organizata të shoqërisë civile dhe media, organizon në mënyrë të vazhdueshme takime për të diskutuar gjendjen e Forcave të Armatosura, sfidat e reja të sigurimit si dhe çështje të tjera të natyrës ushtarake ose politike-ushtarake. Informacioni është aty, është i dukshëm publikisht dhe është tepër i kuptueshëm.

Çështja thelbësore, sigurisht, është nëse publiku është me të vërtetë i interesuar për gjithë këtë. Politika e Mbrojtjes humbi shumë prej tërheqjes dhe pozitës së saj, në momentin që Lufta e Ftohtë u kthye në histori. Për shembull, kur Norvegjia kishte zgjedhje parlamentare në shtator të këtij viti, politika e mbrojtjes dhe Forcat e Armatosura, u përmendën shumë pak gjatë fushatës elektorale. Strategjia e NATO-s në Afganistan, megjithatë, kishte tendencat të ishte një çështje e diskutuar nxehtësisht.

A është kjo mungesë interesi e mirë apo e keqe? Një mungesë e debatit publik dhe e angazhimit mund të nënkuptojë që njerëzit bien dakord gjerësisht me gjendjen e çështjeve. Ajo mund të nënkuptojë gjithashtu indiferencë. Ose mund të kuptojë thjesht që shumica e votuesve, në një periudhë të caktuar, janë më tepër të shqetësuar për çështje të tjera, si p.sh. krizat financiare, punësimi, reforma e pensionit etj. E rëndësishme, megjithatë, është që për të gjithë ata që janë të interesuar ekziston një informacion i zgjeruar.

## Përfundim

Unë fola shumë për Norvegjinë, por në njëfarë mënyrë, është normale që të ndalesh më tepër tek ajo që njihet më mirë, kur bën një prezantim të tillë. Por, unë mendoj që kam prekur disa çështje të përgjithshme, për të mos thënë universale. Në fakt, mendoj që pjesa më e madhe e çështjeve që ngrita këtu kanë një lidhje të drejtpërdrejtë me Shqipërinë. E kaluara juaj është e ndryshme dhe e tillë është edhe pozita gjeografike. Nga ana tjetër, Norvegjia dhe Shqipëria ndajnë së bashku disa prej sfidave të sigurimit, në NATO dhe së bashku me pjesën tjetër të Europës.

Për ta përmbyllur, Shqipëria ndan, besoj, shumë sfida në lidhje me marrëdhëniet civilo-ushtarake, me pjesën tjetër të Europës. Në veçanti, unë kam diskutuar tre pika kryesore:

- Kontrolli civilo-politik
- Mundësia e konfliktit midis kërkesave politike dhe këshillave profesional ushtarake
- Forcat e Armatosura dhe shoqëria civile

Sfidat në këto fusha nuk duhet që të merren lehtë. Këto janë çështje të rëndësishme. Prandaj, unë ju përgëzoj juve për organizimin e kësaj konference. Ndoshta jo gjithçka është e plotë ashtu sikurse duhet të jetë. Kjo ju takon pikësëpari dhe më tepër juve për ta vlerësuar. Por, sërish, qëllimet nuk mjaftojnë. Veprimi është ai që e çon botën përpara. Shqipëria ka bërë një rrugë të gjatë. Ju uroj gjithë të mirat në vazhdimin e kësaj rruge.

**RAPORT:**  
**PERCEPTIMET E PËRFAQËSUESVE TË FORCAVE**  
**TË ARMATOSURA DHE MINISTRISË SË MBROJTJES**  
**MBI MARRËDHËNIET CIVILO-USHTARAKE**

*(Përgatiti Gjergji Vurmo, nëndrejtor IDN)*

Anketimi u zhvillua në periudhën shtator-tetor 2009 me rreth 150 të anketuar - punonjës të Ministrisë së Mbrojtjes, pjesëtarë të Forcave të Armatosura (Shtabi i Përgjithshëm, Komanda e Doktrinës dhe Stërvitjes, Komanda e Forcave Detare, Komanda e Forcës së Bashkuar dhe struktura të tjera), Akademisë së Mbrojtjes si edhe ish-pjesëtarë të Forcave të Armatosura. (Shih Fig. 1)




Figura 1: Institucionet e përfshira në anketim

Sa i përket demografisë së të anketuarve, më shumë se gjysma e tyre i përkasin grupmoshave prej 26 deri në 45 vjeç (rreth 58.67%), rreth 29.33% grupmoshave prej 46-60 vjeç, ndërsa pjesa tjetër grupmoshave të tjera (deri në 25 vjeç dhe mbi 60 vjeç). Përkatësia gjinore e të anketuarve duket se reflekton problematikën e (mos)përfaqësimit të femrave në institucionet e sigurisë (me vetëm rreth 23%). (Shih Fig. 2)





Figura 2: Përkatësia gjinore

Vlen të theksohet se shumica dërmuese e të anketuarve kanë mbaruar universitare (26.67%) dhe vetëm 2.67% e të anketuarve janë të mosmbaruarve.



Ky anketimi ishte strukturuar për të marrjen e perceptimeve dhe për të bërë një çështje të përgjithshme të përgjithshme më i detajuar, i cili fokusohej në marrëdhëniet e qytetarëve civilë në institucionet e

qytetit për mbrojtjen duke e marrë parasysh faktin se 75% e të anketuarve janë të mosmbaruarve se mbrojtja realizon edhe në kushte të dhëna në kuadër të marrëdhënies së parashtruar më sipër

në lidhje me nivelin e studimeve të përfunduara nga të anketuarit. (Shih Fig. 3)

Figura 3: Raporti i koncepteve të mbrojtjes dhe sigurisë

Përgjithësisht e njëjta tendencë i karakterizon përgjigjet e të anketuarve edhe pyetja e dytë - ***Cilat prej institucioneve të mëposhtme nuk ka lidhje me problemet e sigurisë?*** - ndonëse, hezitime duket se shfaqen ndjeshëm në rastin e Ministrisë së Bujqësisë, Shëndetësisë dhe Ministrisë së Transporteve, ku në total rreth 1/3 e të anketuarve (33.33%) mendojnë se këto institucione nuk kanë lidhje me problemet e sigurisë. (Shih Fig. 4)

Pyetjes “***A mendoni se problemet në fushën e mbrojtjes janë përgjegjësi vetëm e Ministrisë së Mbrojtjes dhe e Forcave të Armatosura?***”, rreth 77% e të anketuarve i përgjigjen negativisht ndërkohë që rreth 23% e tyre mendojnë se problemet e mbrojtjes janë përgjegjësi ekskluzive e Ministrisë së Mbrojtjes dhe e Forcave të Armatosura. Kjo tendencë duket se përforcohet akoma më shumë në pyetjen vijuese “***A mendoni se për çështjet e mbrojtjes duhet inkurajuar më shumë komunikimi dhe bashkëpunimi me aktorë të tjerë jashtë institucionit?***”. Më saktë, 95.33% e të anketuarve (përqindja më e lartë e përgjigjeve ndaj cilësdo pyetje të sondazhit) besojnë te nevoja për bashkëpunim me aktorë të tjerë dhe vetëm 4.67% mendojnë të kundërtën, çka konfirmon tendencat pozitive




Figura 4: Institucione të përfshira në problemet e sigurisë

dhe qëndrimet e mirinformuara të vërejtura në përgjigjet e këtij anketimi.

Duke synuar të thellohemi më tej në këtë aspekt të veçantë, të anketuarve u është kërkuar të vlerësojnë se sa i rëndësishëm është komunikimi dhe bashkëpunimi me aktorët e mëposhtëm në lidhje me çështjet e mbrojtjes, sipas një shkalle nga 1 (aspak i rëndësishëm) në 5 (shumë i rëndësishëm). Si shihet edhe në tabelën e mëposhtme (*Tabela 1*) vlerësimet më të larta për rëndësinë e bashkëpunimit dhe komunikimit jepen për kategoritë e “Komisioni parlamentar të sigurisë” dhe për “media dhe analistët e shtypit” me 4.49 dhe 4.05 respektivisht, ndërkohë që si më pak i rëndësishëm vlerësohet bashkëpunimi me sektorin privat (2.83) apo grupet e interesit (3). Kategoritë e “OJF” dhe “Rretheve akademike” duket se qëndrojnë në mes të këtyre vlerësimeve me 3.29 dhe 3.34 respektivisht. Vlerësimi mesatar i ofruar nga të anketuarit për të gjithë institucionet dhe aktorët e përmendur, sipas përlogaritjeve të bërë arrin nivelin e 3.5.

### Tabela 1: Rëndësia e bashkëpunimit me aktorët e tjerë

1 - aspak i rëndësishëm; 5 - shumë i rëndësishëm

INSTITUCIONI	VLERËSIMI MESATAR
Media dhe analistët e shtypit	4,05
Organizatrat joqeveritare	3,29
Komisioni parlamentar i sigurisë	4,49
Universitetet dhe rrethet akademike	3,34
Biznesi	2,83
Grupet e interesit	3

Vlerësimi i dhënë më sipër në lidhje me rëndësinë e bashkëpunimit me sektorin civil duket se ndjek të njëjtën linjë logjike edhe në përgjigjet e pyetjes pasuese, e cila u kërkon të anketuarve të vlerësojnë kontributin e shoqërisë civile në reformat në fushën e mbrojtjes. Ndonëse më shumë se gjysma e tyre e konsiderojnë pozitiv këtë kontribut, janë rreth 38% e të anketuarve të cilët e vlerësojnë si të pandjeshëm rolin e shoqërisë civile në këtë kontekst. (Shih Fig. 5)




Figura 5. Kontributi i shoqërisë civile në reformat në fushat e mbrojtjes



Siç u përmend edhe më sipër, në pjesën e dytë të tij anketimi u fokusua kryesisht në raportet e ushtarakëve dhe punonjësve civilë në institucionet e përfshira apo në sektorin e mbrojtjes në përgjithësi. Duke filluar me perceptimet e të anketuarve në lidhje me kuadrin ligjor që rregullon marrëdhëniet civilo-ushtarake, duket se opinionet e tyre janë mjaft të ndara. Kështu, rreth 43% e tyre e konsiderojnë të plotë kuadrin ligjor ekzistues që rregullon bashkëpunimin dhe ndarjen e përgjegjësive midis Ministrisë së Mbrojtjes dhe Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura. Ndërkohë, janë gati po aq prej tyre (42%) të cilët mendojnë të kundërtën, ndërkohë që rreth 15% nuk kanë një mendim të caktuar për këtë çështje.

Thuajse njëloj të ndara shfaqen opinionet e të anketuarve në lidhje me pyetjen vijuese - ***“A mendoni se njihet dhe zbatohet drejt e me korrektësi kuadri ligjor ekzistues që rregullon këto marrëdhënie?”***. (Shih Fig. 6)




Figura 6. Njohja dhe zbatimi i kuadrit ligjor mbi marrëdhëniet civilo-ushtarake

Gjithashtu, vetëm 6.67% e të anketuarve e përjashtojnë kategorikisht mundësinë e konfondimit (ndërhyrjes, marrjes së përgjegjësive apo kompetencave të njëri-tjetrit) të roleve dhe përgjegjësive midis punonjësve civilë dhe ushtarakëve në Ministrinë e Mbrojtjes dhe Shtabin e Përgjithshëm. Pjesa dërrmuese e tyre identifikojnë në eksperiencat përkatëse të tilla raste, shpesh (rreth 40%) apo edhe me raste (38%). (Shih Fig. 7)




Figura 7: A ka raste të konfondimit të roleve

Tendenca e opinionëve të ndara të të anketuarve, grupohen kryesisht rreth dy opsioneve, kur pyeten se ***Cili është roli më i drejtë që duhet të luajnë punonjësit civilë, që punojnë në nivelet e larta të vendimmarrjes dhe ekzekutivitetit në sistemin e mbrojtjes?***

Rreth gjysma e të anketuarve (49.3%) e shohin rolin e tyre në formën e një partneriteti me ushtarakët (“Përgatisin së bashku me ushtarakët planet afatgjatë të reformave dhe aktivitetit të mbrojtjes”), ndërkohë që grupimi tjetër më i madh i opinionëve i përket qëndrimit se nivelet e larta civile të vendimmarrjes duhet të “japin misionin politik forcës së armatosur, detyrën për të realizuar dhe kontrollonjë plotësimin e tij”. (Shih Fig. 8)




Figura 8. Cili është roli që duhet të këtë niveli i lartë civil në sistemin e mbrojtjes?

Ndasi të tilla të opinioneve në lidhje me rolin që duhet të kenë nivelet e larta civile në sektorin e mbrojtjes, por gjithashtu edhe në opinionet mbi rastet e konfondimit të roleve midis niveleve ushtarake dhe atyre civile, të anketuarit duket se e “bazojnë” në skepticizmin e tyre në lidhje me ekspertizën e niveleve civile. Kështu, rreth 60% e tyre mendojnë se nivelet e larta civile nuk e kanë ekspertizën e nevojshme për të përballuar përgjegjësitë e detyrave të tyre, ndërsa të kundërtën mendojnë vetëm 22.67% e tyre. (Shih Fig. 9)




Figura 9. Ekspertiza e niveleve të larta civile në fushën e mbrojtjes

Mjaft ngushtë i lidhur me këtë qëndrim rezulton edhe perceptimi i shumicës së të anketuarve (55.33%), të cilët mendojnë se ushtarakët e niveleve të larta nuk e kanë autoritetin dhe kompetencat vendimmarrëse për emërimin në detyrë të personelit në varësi. Kështu 44.67% e tyre mendojnë se ushtarakët nuk i kanë mjaftueshëm këto kompetenca dhe 10.67% mendojnë se nuk kanë aspak kompetenca. Nga ana tjetër, rreth 37.% mendojnë të kundërtën ndërsa 7.3% refuzojnë të përgjigjen. (Shih Fig. 10)

Figura 10. Kompetencat e ushtarakëve të lartë për emërimet e personelit

Praktika e ndërhyrjeve të politikës në problematikën e ekspertizës ushtarake shënon gjithashtu një tjetër aspekt për të cilin janë pyetur të anketuarit, ku mbi  $\frac{3}{4}$  e tyre kanë konfirmuar raste të tilla (të cilat ndodhin shpesh ose nganjëherë). (Shih Fig. 11)

Në po të njëjtin kontekst, të anketuarit u pyetën ***nëse merren në konsideratë mendimet e ekspertëve ushtarakë në të gjithë nivelet në fushën e zhvillimit të Forcave të Armatosura***, ku sërish vetëm 27.33% e tyre i përgjigjen pozitivisht pyetjes, ndërkohë që 56% shprehen “Jo rregullisht” dhe 10% “JO” (6.67% refuzojnë të përgjigjen).




Figura 11: Ndërhyrja e politikës në ekspertizën ushtarake

Shumica e të anketuarve (54%) mendojnë se ka ende nevojë për përmirësime të kuadrit ligjor të nevojshëm për reformimin e Forcave të Armatosura në mënyrë që ato të mund të përmbushin misionin e tyre kushtetues. Nga ana tjetër, rreth 1/3 e tyre mendojnë se ky kuadër ligjor është i plotë.

Gjithashtu, me anëtarësimin e vendit në NATO rreth 44% e të anketuarve nuk vërejnë ndryshim në moralin e Forcave të Armatosura ndërkohë që pjesa tjetër (56%) gjykojnë se ai është përmirësuar. (Shih Fig. 12)




Figura 12.  
Ndikimi  
i Anëtarësimit  
në NATO  
te morali i  
Forcave të  
Armatosura

Mjaft interesante shfaqen opinionet e të anketuarve sa i përket ecurisë së mëtejshme të Forcave të Armatosura. Më saktë, të anketuarit u pyetën: **“Ecurinë e mëtejshme të Forcave të Armatosura, e konsideroni kryesisht për shkak të mbështetjes dhe inkurajimit të...”**. (Shih Tabela 2)

**Tabela 2: Faktorë me ndikim në ecurinë e Forcave të Armatosura**

<b><i>Faktori (institucion / aktor)</i></b>	<b><i>% e përgjigjeve</i></b>
Politikës	<b>5,33%</b>
Publikut / qytetarëve	<b>0,67%</b>
Ushtarakëve	<b>20%</b>
Politikës dhe ushtarakëve	<b>15,33%</b>
Të gjithë sa më sipër	<b>25,33</b>
Anëtarësimit në NATO	<b>21,33</b>
Faktorë të tjerë	<b>5,33</b>
Nuk e di / Refuzim	<b>6,67</b>

## VI

### *Konkluzione dhe rezultate*

---

#### **PANELI V**

---

**ARIAN DYRMISHI**

RAPORT I PANELIT:  
“CILI ËSHTË PËRGJEGJËSI PËR SIGURINË DHE FORCAT  
E ARMATOSURA: SFIDAT PËR ROLET  
DHE PËRGJEGJËSITË PËR MENAXHIMIN E SIGURISË  
DHE MBROJTJES” (KONTEKSTI I (JO)SUKSESEVE  
KONSTITUCIONALE, MËSIMET E NXJERRA DHE IDETË  
PËR SFIDAT E ARDHSHME)

Në këtë panel referuan ish-Presidenti i Republikës prof. dr. Rexhep Meidani, shefi i Shtabit të Përgjithshëm gjeneral brigade Maksim Malaj dhe Arjan Dyrmishi, kërkues për çështje të sigurisë pranë IDN.

**Prof. dr. Rexhep Meidani** prezantoi ndryshimet që kanë ndodhur në mjedisin e sigurisë gjatë dy dekadave të fundit dhe ndryshimet në konceptin e sigurisë, i cili ka evoluar nga një koncept i kufizuar në sigurinë shtetërore drejt një dimensionimi më kompleks, i cili aktualisht është i ndërthurur me sigurinë njerëzore, sigurinë energjetike, atë mjedisore etj., duke pasur në themel parimet e demokracisë. Këto zhvillime, në mënyrë të pashmangshme kanë sjellë dhe modifikimin e rolit të institucioneve përgjegjëse të përfshira në sektorin e sigurisë.

Veçanërisht në prezantimin e tij z. Meidani u përqendrua në nevojën e përmirësimit të kontrollit demokratik të Forcave të Armatosura. Edhe

pse gjatë periudhës përpara anëtarësimit në NATO Shqipëria nuk ka qenë nën ndonjë presion të fortë reformimi të marrëdhënieve ushtarake-civile, ajo e ka plotësuar kriterin e kontrollit demokratik civil të Forcave të Armatosura në përputhje me kërkesat e anëtarësimit në NATO. Por, plotësimi i standardeve të demokracisë dhe të drejtave të njeriut sipas kriterëve të Kopenhagenit edhe në fushën e sigurisë dhe Forcave të Armatosura, është pjesë e kushteve që duhen plotësuar për anëtarësimin Bashkimit Europian. Kështu që për realizimin e një qëllimi të tillë kërkohet një rritje interesi e preokupimi, jo vetëm nga institucionet politike, por dhe nga vetë shoqëria civile.

Si pista kryesore për të ndikuar në përmirësimin e raporteve ushtarake-civile, z. Meidani parashtroi: rritjen e ndikimit civil, rritjen e transparencës për buxhetin e mbrojtjes dhe sigurisë; përmirësimin e mbikëqyrjes parlamentare; si dhe ndryshimin e kulturës së sigurisë dhe të kulturës politike, në marrëdhëniet civile-ushtarake me një fokus më të madh në transferimin konceptual e praktik nga siguria tradicionale te siguria njerëzore.

Ndër problematikat konkrete, z. Meidani parashtroi përplasjet dhe mbivendoset në kompetencat e institucioneve të kontrollit dhe mbikëqyrjes civile si: Komisioni Parlamentar i Sigurisë, Këshilli i Sigurimit Kombëtar dhe Komiteti Ndërministror i Politikave të Sigurisë. Veçanërisht ai u ndal në rregullimin e kompetencave dhe marrëdhënieve të Këshillit të Sigurimit Kombëtar nën Presidentin dhe Komitetit Ndërministror të Politikave të Sigurisë nën Kryeministrin duke mos përjashtuar si alternativë edhe amendimin e kushtetutës.

Për sa i përket kontrollit të kompetencave dhe fuqive të ekzekutivit, si një nga parimet më themelore të demokracisë, z. Meidani theksoi se nga kjo pikëpamje Shqipëria është ende larg të qenit vend realisht demokratik, midis shtetit të së drejtës, në përgjithësi, dhe qeverisjes së paanshme, në veçanti. Këtë dobësi ai e shpjegoi me dobësinë e instrumenteve institucionale të ndërhuara për të kufizuar pushtetet e ekzekutivit dhe konkretisht dobësisë së balancimit dhe kontrollit reciprok të pushteteve të ndryshme si: *Kontrolli parlamentar, Kufizimi politik-partiak, Kontrolli juridiko-ekonomik, Kontrolli sindikalist dhe i biznesit, Kontrolli publik, shoqëria civile, media dhe pjesëmarrja qytetare. Në këtë kuadër*



*ish-Presidenti Meidani u përqendrua më shumë në domosdoshmërinë e ngritjes me ligj të shoqatës (sindikates) profesionale të ushtarakëve shqiptarë mbështetur në një përvojë funksionuese europiane.*

Rezultat të këtyre marrëdhënieve ndërinstitucionale ai paraqiti edhe dobësinë e parlamentit për problematika si në dërgimin e misioneve ushtarake jashtë vendit apo edhe lejimin e trupave të huaja në Shqipëri, në miratimin e buxhetit apo edhe investigimit të situatave nëpërmjet seancave të pyetje-përgjigjeve me anëtarët e kabinetit apo komandantët ushtarakë.

Në fjalën e tij, **gjeneral brigade Maksim Malaj** prezantoi ecurinë e reformave në Forcat e Armatosura në përpjekje për t'ju përshtatur nevojave të reja të sigurisë dhe kërkesave që burojnë nga anëtarësimi në NATO. Ai vuri në pah se vetë anëtarësimi në NATO ka qenë rezultat edhe i transformimit të vazhdueshëm të Forcave të Armatosura dhe përshtatjes së tyre me standardet e kërkuara, përfshi dhe objektivin për ta kthyer atë në tërësisht profesioniste duke filluar nga viti 2010.

Megjithatë çështjet që kanë të bëjnë me kontrollin demokratik në Forcat e Armatosura, marrëdhëniet civile-ushtarake vazhdojnë të ngjallin interes megjithëse kanë kaluar dy dekada nga transformimet rrënjësore në tërë jetën e vendit përfshirë dhe reformën e thellë të Forcave të Armatosura. Gjatë kësaj kohe është arritur që Forcat e Armatosura t'i ushtrojnë përgjegjësitë e tyre sipas kushtetutës dhe ligjeve, me transparencë të plotë dhe duke iu nënshtruar kontrollit të autoriteteve civile të shtetit të cilat kanë drejtuar në fakt tërë këtë proces transformimesh dhe zhvillimesh.

Me gjithë arritjet, gjeneral Malaj vuri theksin se situata e re cilësore kërkon që marrëdhëniet civile-ushtarake në tërësi si dhe realizimi i kontrollit demokratik mbi veprimtarinë e Forcave të Armatosura në veçanti duhet t'i nënshtrohen një analize të gjerë prej të gjithë aktorëve që janë pjesë e këtyre marrëdhënieve. Më të ngutshme ai paraqiti ndërmarrjen e reformave ligjore që të përcaktohet sa më saktë mënyra e ushtrimit të kompetencave në drejtimin dhe komandimin e Forcave të Armatosura, si dhe në menaxhimin e personelit të tyre.

*Me synim që të përballohen sfidat e reja ndaj Forcave të Armatosura, gjeneral Malaj propozoi ndryshime kushtetuese dhe*

*ligjore që të arrihet: ndërveprueshmëria dhe lehtësimi i procedurave në veprimtaritë e përbashkëta me NATO-n; plotësimi dhe saktësimi më mirë kompetencat e autoriteteve shtetërore civile në drejtimin e Forcave të Armatosura; ndarja më saktë e kompetencave midis lidërshiptit politik me lidërshiptin ushtarak në fushat e menaxhimit të personelit ushtarak dhe buxhetit; përputhja e legjislacionit për rregullimin e zbatimit të buxhetit, marrëdhëniet të punës, pronës publike, prokurimeve etj.*

Në prezantimin e tretë të këtij paneli, **z. Arjan Dyrmishi** analizoi problematikat e koordinimit dhe funksionimit të autoritetit të sigurisë kombëtare. Prezantimi paraqiti konceptin dhe eksperiencat ndërkombëtare në këtë aspekt si dhe ecurinë e këtij autoriteti në Shqipëri duke e trajtuar atë në tre periudha të ndryshme. I krijuar si një mekanizëm për të rritur efektivitetin e institucioneve të ngarkuara me sigurinë kombëtare, vende të ndryshme kanë zhvilluar modelet e tyre të organizimit dhe funksionimit të cilat kanë qenë rezultat i sistemit politik, strukturave institucionale pararendëse si dhe nevojave specifike apo stilit të zyrtarëve më të lartë.

Qëllimi kryesor i prezantimit ishte sjellja e argumenteve për të diskutuar me pjesëmarrësit nëse: autoriteti i sigurisë kombëtare është i ndërtuar në përputhje me nevojat e sigurisë dhe organizimin e sistemit politik; a është funksionale mënyra aktuale e organizimit; mbi ç'kriterë mund të vlerësohet; a mbikëqyret dhe si mund të përmirësohet mbikëqyrja.

Sipas prezantimit të z. Dyrmishi, zhvillimi i këtij autoriteti në rastin e Shqipërisë është zhvilluar në tre periudha kryesore dhe ka qenë subjekt i ndryshimeve kushtetuese, ligjore por edhe i mënyrës së qeverisjes nga aktorë të ndryshëm politikë dhe institucionalë. Më tej prezantimi trajtoi më konkretisht këto periudha, por duke u ndalur veçanërisht në periudhën e tretë, me miratimin e kushtetutës në vitin 1998 dhe legjislacionin e miratuar në vijim.

Sipas analizës dhe vlerësimit të bërë në prezantim problematika kryesore aktuale qëndron në mospërputhjen dhe organizimin e sistemit politik me kompetencat kushtetuese të Presidentit dhe Këshillit të Sigurimit Kombëtar dhe komandimit të Forcave të Armatosura. *Kjo mospërputhje ka çuar në një dualizëm midis Presidentit dhe*

*Kryeministrit, i cili së bashku me Këshillin e Ministrave është autoriteti kryesor kushtetues për konceptimin dhe përcaktimin e drejtimeve kryesore të politikës së përgjithshme shtetërore, përfshirë dhe politikën e sigurisë. Kjo situatë, e cila është vënë re që në fillimet e zbatimit të kushtetutës, e ka spostuar gradualisht Këshillin e Sigurimit Kombëtar në një institucion disfunksional, ndërkohë që edhe Komiteti Ndërministror për Politikën e Sigurisë është po aq larg së qeni një institucion drejtues, orientues, e monitorues në mënyrë sistematike të qeverisjes në sektorin e sigurisë. Asnjëri prej këtyre institucioneve nuk ka staf teknik apo sekretariat teknik të mirëfilltë.*

## **GJERGJI VURMO**

### **RAPORT I PANELIT: “SFIDAT PËR NJË KONTROLL EFEKTIV DEMOKRATIK DHE MBIKËQYRJA PARLAMENTARE NË SEKTORIN E MBROJTJES”**

Diskutimet në kuadër të këtij paneli u fokusuan te roli, performanca aktuale dhe sfidat e Parlamentit dhe, veçanërisht të komisionit parlamentar të sigurisë në ushtrimin e funksioneve dhe kompetencave të tij në sektorin e mbrojtjes. Struktura e panelit, eksperiencia e folësve dhe perspektiva e ofruar prej tyre ofruan drejtimit kryesore të cilat ndoqën diskutimet / duke filluar nga perspektiva e institucionit (Komitetit parlamentar të sigurisë), eksperiencia gjermane dhe së fundi, gjetjet e një studimi të pavarur të drejtuar nën udhëheqjen e IDN-së.

**Dr. Leonard Demi**, kryetar i Komisionit parlamentar të sigurisë prej dy mandatesh, nënvizoi disa prej arritjeve kryesore të rolit të Kuvendit në fushën e mbrojtjes dhe veçanërisht Komisionit parlamentar, të cilin për nga vendosja institucionale dhe kuadri ligjor që rregullon veprimtarinë e tij ai e rreshtoi te kategoria e komisioneve të forta parlamentare të sigurisë (me ndikim konstant dhe të fortë në hartimin e ligjeve dhe politikave të sigurisë).

“Veçanërisht në vitet e fundit roli i këtij komisioni është përmirësuar, dhe kjo jo vetëm si pasojë e procesit të anëtarësimit në NATO, por gjithashtu edhe për shkak të rritjes së ndjeshmërisë nga ana e politikëbërësve në lidhje me këtë hallkë të mbikëqyrjes civile dhe kontrollit demokratik. Aktualisht, ky komision funksionon në bazë të një kuadri të plotë rregullator, i cili ka gjetur një ekuilibër të qëndrueshëm midis transparencës demokratike dhe çështjeve sensitive të sigurisë. Zgjerimi i konceptit të sigurisë (ose i të kuptuarit të tij) ka bërë që të zgjerohet edhe vetë fusha e kompetencës së këtij Komisioni.”

Sfidat e veprimtarisë së kësaj strukture parlamentare dr. Demi i lidh jo vetëm me këtë organ-buxheti, ekspertiza dhe stafi mbështetës etj., por gjithashtu edhe tek institucionet e tjera demokratike, dhe para së gjithash, tek institucionet e mbrojtjes dhe të sigurisë veprimtaria e të cilave është objekt i kontrollit dhe mbikëqyrjes. Por jo vetëm kaq. Duke pasur parasysh ndikimin dhe ndërvarësinë e çështjeve të sigurisë me një sërë problematikash të tjera, përfshirja, mbështetja dhe transparenca e institucioneve të tjera mbetet sërish një sfidë e cila ndikon tek efikasiteti i komisionit, veçanërisht në kuadër të rolit të tij në hartimin e politikave dhe ligjeve.

**Z. Walter Kolbow** prezantoi eksperiencën gjermane në kuadër të mbikëqyrjes dhe kontrollit demokratik në sektorin e mbrojtjes, bazuar në katër shtyllat e kontrollit të Forcave të Armatosura. Një aspekt mjaft interesant i kësaj problematike që u soll në vëmendjen e pjesëmarrësve ishte ndikimi i ndjeshëm i mbështetjes së publikut tek opsionet e ndryshme të politikave në fushën e mbrojtjes, çka reflektohet ndjeshëm në debatet parlamentare veçanërisht në lidhje me misionet ushtarake jashtë vendit. Z. Kolbow u ndal gjithashtu edhe tek instrumentet dhe mjetet e parashikuara nga kuadri ligjor në lidhje me rolin e parlamentit gjerman, por edhe të institucioneve të tjera të kontrollit civil sa i përket Forcave të Armatosura, politikave të mbrojtjes apo kontributit jashtë kufijve federalë. Kufizimet e rolit të strukturave parlamentare në ushtrimin e funksioneve të mbikëqyrjes dhe kontrollit demokratik kanë qenë një tjetër fokus i fjalës së tij, dhe veçanërisht ato kufizime që kanë të bëjnë me kapacitetet e komisioneve, ekspertiza dhe mbështetja e punës së tyre.

**Z. Arian Dyrmishi**, studiues i asociuar pranë IDN-së, prezantoi gjetjet e studimit të përgatitur nën drejtimin dhe mbështetjen e IDN-së nga ana e një grupi ekspertësh të pavarur (pjesë e Rrjetit të Menaxhimit të Sigurisë, të ngritur nga IDN-ja). Gjetjet e studimit mbi rolin e parlamentit në kontrollin dhe mbikëqyrjen e Forcave të Armatosura, bazohen në një seri intervistash (anketim) me anëtarë të komisionit parlamentar të sigurisë në dy legjislaturat e fundit të kuvendit (2001-2005 dhe 2005-2009). Synimi i studimit ishte jo vetëm të identifikonte progresin por gjithashtu edhe kapacitetet, sfidat dhe problematikën e përgjithshme të funksionimit të kësaj strukture parlamentare. Interesi i pjesëmarrësve u fokusua veçanërisht te gjetjet që kanë të bëjnë me kapacitetet e komisionit, njohuritë e anëtarëve të tij dhe përqasja e tyre ndaj funksioneve dhe sfidave të kontrollit demokratik dhe mbikëqyrjes së Forcave të Armatosura, aspektet e buxhetimit, roli i komisionit jo vetëm si “mbikëqyrës”, por edhe si “mbështetës” i institucioneve të sigurisë.

## Diskutime

Duke ndjekur reagimin e **dr. Leonard Demit**, i cili u shpreh skeptik ndaj gjetjeve të studimit të IDN-së dhe veçanërisht konkluzioneve në lidhje me perceptimet dhe njohuritë e anëtarëve të komisionit parlamentar të sigurisë, **z. Sotiraq Hroni** nënvizoi nevojën për një qasje të hapur dhe gjithëpërfshirëse nga ana e institucioneve ndaj opinioneve alternative të bazuara në argumente dhe rekomandime konkrete. Duke vlerësuar eksperiencën e IDN-së jo vetëm me komisionin parlamentar, por edhe me institucionet e tjera si Ministria e Mbrojtjes, Forcat e Armatosura, Ministria e Brendshme, Policia etj. si edhe gatishmërinë e tyre për të nxitur konsultimet me aktorë të shoqërisë civile, z. Hroni theksoi se kontributet e aktorëve civilë synojnë përmirësimin e performancës dhe efikasitetit të institucioneve në ushtrimin e kompetencave dhe funksioneve të tyre. Nga ana tjetër, pjesëmarrësit në konferencë (kryesisht përfaqësues të Forcave të

Armatosura) theksuan nevojën për një vëmendje më të madhe në çështjet konkrete që shqetësojnë sot Forcat e Armatosura - si politikat e buxhetimit, menaxhimit të personelit, marrëdhëniet civilo-ushtarake, politikat e arsimit dhe ato sociale të anëtarëve të Forcave të Armatosura, çështjet e prokurimeve dhe armatimi etj. Në këtë kontekst, pjesëmarrësit mirëpritën kontributin e IDN-së, të cilin e vlerësojnë si të vetmin aktor të shoqërisë civile i cili në vazhdimësi ka qenë prezent në proceset reformuese dhe adresimin e sfidave në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë.

## **GERON KAMBERI**

### **RAPORT I PANELIT:**

#### **“TRANSPARENCA DHE HAPJA NDAJ SHOQËRISË, (ROLI I SHOQËRISË CIVILE, MEDIAS, AKADEMIKËVE)”**

Gjatë këtij paneli referuesit dhe diskutantët u përpoqën të theksojnë rolin e domosdoshëm të transparencës nga institucionet e sigurisë në raport me opinionin publik, median dhe shoqërinë civile. Për shkak se nocioni i dikurshëm i sigurisë, i cili e lidhte atë vetëm me institucionet shtetërore, tashmë është kapërcyer, ballafaqimi me aktorë të tjerë në këtë fushë si p.sh. shoqëria civile apo media, i vendos Forcat e Armatosura dhe sektorin e sigurisë përballë marrëdhënieve të tjera të komunikimit.

Në bazë të rezultateve të sondazhit të kryer, u vërejt se perceptimi publik për Ministrinë e Mbrojtjes dhe Forcave të Armatosura mbetet pozitiv, por nga ana tjetër u theksua se paqartësia për rolin e funksionet e tyre në disa raste i përket një mungese strategjie komunikimi nga ana e tyre në drejtim të opinionit të gjerë. Për këtë arsye një nga elementët që duhet të përmirësohet më tej është larmia e formave dhe mënyrave të shpërndarjes së informacionit në raport me veprimtarinë dhe politikat publike që ushtrojnë institucionet e sigurisë kombëtare.

Gjatë debatit u theksua se demokracia në radhë të parë presupozon siguri brenda një kuadri ligjor. Kjo nënkupton vetëdije për përdorimin e të gjitha mjeteve që mundësojnë efikasitetin e ligjit ashtu sikundër edhe përdorimin e forcës si instrumenti i fundit ligjor.

Në vijim të përsosjes së transparencës brenda Forcave të Armatosura është e domosdoshme që stafet ushtarake të drejtimit nëpërmjet lidhjes e bashkëpunimit me personalitetet publike, politike, akademike e mediatike me ndikim në jetën shoqërore e politike të vendit, duhet të përpiqen të marrin mendimin e tyre duke përcaktuar strategji afatgjate zhvillimi e mbështetje. Në këtë mënyrë jo vetëm që forcohet personaliteti i ushtarakut por edhe zhvillohet më tej, duke krijuar mundësi për integrim të shpejtë në shtet e shoqëri.

Për këtë arsye objekt i transparencës, veç të tjerave, duhet të jenë edhe sistemi arsimimit i drejtimit, marrëdhëniet ndërmjet forcave e strukturave, angazhimet operacionale dhe perspektiva e zhvillimit të tyre si edhe mundësitë e financimit e mënyra e prokurimit të fondeve publike që taksapaguesit shqiptarë japin për modernizimin e Forcave të Armatosura.

Një ndër rrjedhojat pozitive në opinionin publik është edhe realizimi i transparencës së veprimtarisë së Forcave të Armatosura që në hapat e parë të ndërmarrjes së një nisme apo vendimi të pritshëm. Përfshirja e medias në këtë “lojë” për realizimin e transparencës dhe hapjes ndaj shoqërisë civile është një nga parimet themelore të veprimtarisë drejtuese në Forcat e Armatosura. Nuk është vetëm interneti apo shtypi i shkruar që realizon transparencën, por duhen përdorur edhe teknika të tjera komunikimi më të drejtpërdrejta në veprimtarinë drejtuese të Forcave të Armatosura që realizojnë bashkëpunimin e strukturave ushtarake me ato civile.

Transparenca ka përmbajtje të dyfishte. Nga njëra ana ajo duhet të jetë e vazhdueshme dhe për të gjitha problemet **brenda përbrenda** Forcave të Armatosura, për motivimin e ushtarakëve dhe punonjësve që shërbejnë në këto forca dhe nga ana e **jashtme** me shoqërinë dhe institucionet e tjera të shtetit për sigurimin e mbështetjes së nevojshme. Për këtë qëllim duhet shmangur ndikimi negativ që ushtron në opinionin publik **informacioni i rëndomtë, rutinë** e me natyrë të

njëjtë. Të tilla fenomene e largojnë vëmendjen e opinionit nga veprimtaria e Forcave të Armatosura. Transparenca në opinionin publik ka vlera kur ajo bëhet me objekt të caktuar dhe në vijimësi për të gjitha problemet që kanë ndikim në mjedisin shoqëror mediatik apo intelektual.

Një ndër treguesit e mungesës së transparencës dhe një fryme “të mbyllur” ndaj shoqërisë civile, medias e akademikëve u cilësua edhe përgatitja e hartimi i legjisllacionit që ka lidhje me Forcat e Armatosura. Mospjesëmarrja e institucioneve të tjera nga sektori civil, veçanërisht nga shoqëria civile e bota akademike dëshmon për një mentalitet që duhet të kapërcehet drejt një forme të re bashkëpunimi. Në këtë mënyrë fryma e këtyre ligjeve do të përmbante jo vetëm vullnetin e dëshirat që burojnë nga vetëdija profesionale e Forcave të Armatosura, por edhe aspekte të qasjes së publikut ndaj këtij sektori me rëndësi në fushën e sigurisë e të mbrojtjes.

Nga ana tjetër mundësia e keqpërdorimit politik të Forcave të Armatosura nga institucione të ndryshme vendimmarrëse e bën edhe me të rëndësishëm transparencën dhe hapjen e tyre ndaj shoqërisë në mënyrë që opinionin të vazhdojë të ruajë e forcojë perceptimin pozitiv të deritanishëm. Ashtu sikurse roli gjithnjë e më i madh i shoqërisë civile, medias dhe institucioneve akademike në fushën e reformave të sektorit të sigurisë duhet të institucionalizohet përmes tavolinave të rrumbullakëta, seminareve e konferencave tematike që hedhin shtratin për hartimin e politikave e garantojnë një mbështetje sa më të gjerë nga publiku.

Njëkohësisht saktësia dhe vlera e informacionit që ofrojnë strukturat e Forcave të Armatosura duhet të dëshmojë seriozitetin dhe transparencën në raport me shoqërinë dhe opinionin publik në tërësi. Një informacion sa më i detajuar dhe më i besueshëm rrit mbështetjen ndaj veprimeve e punës së Forcave të Armatosura duke marrë parasysh edhe sakrificat e mundshme. Për këtë arsye përfshirja e sa më shumë mendimeve intelektuale lidhur me zhvillimet e brendshme të Forcave të Armatosura duhet të jetë një prioritet i veprimtarisë drejtuese të Forcave të Armatosura.

Ky komunikim i vazhdueshëm mes strukturave të Forcave të Armatosura dhe Ministrisë së Mbrojtjes me aktorë të tjerë të shoqërisë



nuk duhet të jetë sezonal e për me tepër të shndërrohet vetëm në një *komunikim në kohë krizash* (si p.sh. rasti i Gërdecit apo emergjencave civile), por duhet të jetë periodik dhe përmes formave të ndryshme.

Në mënyrë të veçantë rritja e transparencës ndaj opinionit merr përparësi të veçantë në kushtet kur taksapaguesit shqiptarë duhet të shpenzojnë rreth 2-3% të GDP-së për fuqizimin dhe modernizimin e Forcave të Armatosura si vend i ri anëtar i NATO-s. Për këtë arsye shkalla e duhur e informimit duke parashikuar edhe rregullat e posaçme në këtë rast mund të sigurojë një vlerësim e mbështetje sa më të gjerë prej tij për domosdoshmërinë e rolit që duhet të luajnë Forcat e Armatosura dhe institucionet e tjera të sigurisë në mbarëvajtjen e vendit.

Në të njëjtën kohë u theksua se edhe shoqëria civile e në mënyrë të veçantë media duhet të përballojë me profesionalizëm çdo nivel të rritur të komunikimit dhe transparencës nga Ministria e Mbrojtjes dhe Forcat e Armatosura në mënyrë që të ofrojnë një analizë të qartë e rrugëzgjidhje realiste ndaj fenomeneve të ndryshme që bashkëshoqërojnë procesin e funksionimit të tyre. Rritja e numrit të ekspertëve të pavarur nga ana e rrjetit të NGO e thinj-tankeve si edhe krijimi i rrjetit të korrespondentëve apo redaktorëve të posaçëm për çështjet e mbrojtjes e sigurisë në media do të përbënte një hap me rëndësi në dobi të një transparence më të madhe e debate më profesionale.

Ndërkohë përmirësimi i burimeve dhe mjeteve të informacionit nga ana e Forcave të Armatosura dhe Ministrisë së Mbrojtjes (si p.sh. përditësimi i vazhdueshëm i faqeve web, buletinet elektronike, konferenca shtypi apo takime me gazetarë e përfaqësues të shoqërisë civile në prag ngjarjesh të rëndësishme, si p.sh. stërvitje ushtarake, apo dërgimi i trupave me misione jashtë vendit etj.) është një ndër treguesit e vullnetit të këtyre strukturave për të kapërcyer sindromën e *“informacionit të mbyllur e gjithmonë sekret”* si dhe për të rritur shkallën e besimit të dyanshëm mes shoqërive civile, medias e akademikëve.

Edhe institucionet akademike e të shoqërisë civile mund e duhet të ndërtojnë modele të komunikimit të ndërsjellë mes përfaqësuesve të Ministrisë së Mbrojtjes e Forcave të Armatosura jo vetëm në raste

ballafaqimesh apo debatesh. Kështu p.sh. leksionet e hapura nga këta përfaqësues për çështje të sigurisë e mbrojtjes me studentë, akademikë apo grupe të tjera interesi mund t'i shërbejnë drejtpërdrejt ndërtimit të një raporti që ka në themel transparencën dhe hapjen e ndërsjellë në marrëdhëniet civilo-ushtarake.

Ballafaqimi i Forcave të Armatosura me mendimin e pavarur të shoqërisë civile për çështjet e sektorit të sigurisë e mbarëvajtjes së politikave të mbrojtjes duhet të përbëjë një dëshmi jo vetëm të komunikimit e hapjes ndaj strukturave të tjera civile të shoqërisë por edhe një mentalitet të ri. Si rrjedhojë, ky qëndrim i drejtuesve ushtarakë të Forcave të Armatosura ndaj pjesës tjetër i shndërron ata në forca intelektuale të përgjegjshme që meritojnë mbështetjen e duhur të opinionit publik.

## **DR. ARSHI ÇELA**

### **RAPORT I PANELIT: “PERCEPTIMET E PËRFAQËSUESVE TË FORCAVE TË ARMATOSURA DHE MINISTRISË SË MBROJTJES MBI MARRËDHËNIET CIVILO-USHTARAKE”**

Bazuar në raportin e paraqitur në këtë panel nga znj. Mariola Qesaraku, duke dëgjuar ekspertin e lartë të DCAF-së Z. Bard Knudsen, si dhe diskutimet e komentet e pjesëmarrësve, mund të konkludojmë se gjithçka u tha ishte e vlefshme jo vetëm në planin konceptual të tematikës, por edhe në planin rekomandues.

Rezultatet e anketimit të kryer me rreth 150 pjesëmarrës si dhe diskutimet e panelit tregojnë se tashmë ka një koncept të qartë mbi çështjet e sigurisë dhe të mbrojtjes dhe se në përgjithësi identifikohen drejt institucionet që kanë përgjegjësi ligjore për këto fusha. Krahas vlerësimit të përgjegjësive të institucioneve shtetërore, vlerësohet mjaft pozitiv dhe roli i shoqërisë civile dhe mediave. Kjo është pa dyshim një arritje në sensin që çështjet e sigurisë dhe të mbrojtjes janë jo vetëm një çështje shtetërore, por edhe një çështje e përbashkët.

Njohja dhe zbatimi i kuadrit ligjor mbi marrëdhëniet civilo-ushtarake, si rezultoi në këtë panel, ndesh ende në vështirësi. Ndërsa mosnjohja lidhet më së shumti me publikimin e ligjeve ose edhe me indiferencën e subjekteve të ndryshme, moszbatimi me korrektësi është një çështje edhe interesash sektoriale. Pranimi se gati gjysma e të anketuarve thanë se ligjet që diktojnë ndarjen e sferës së veprimit civilo-ushtarake zbatohen pjesërisht është domethënës. Kjo lidhet edhe me rastet e konfondimit të roleve, përgjegjësive midis punonjësve civilë dhe ushtarakë. Fakti që 40% e të anketuarve deklarojnë se ndodh shpesh që rolet konfondohen në dëm të kompetencave të ushtarakëve, tregon se autoritetet civile ose edhe nëpunësit civilë të administratës së mbrojtjes, tejkalojnë tagrat e tyre, gjë që dëmton jo vetëm autoritetin komunikues të ushtarakëve, por edhe ekspertizën ushtarake të kërkuar sipas standardeve të Aleancës.

A e kanë ekspertizën e nevojshme nivelet e larta civile për të përballur përgjegjësitë e tyre? 60% e të pyeturve shprehen me "JO". Si doli gjatë debatit kjo nuk ka të bëjë me nivelin intelektual të drejtuesve civilë dhe as me mosdashjen e tyre. Në mjaft raste autoritetet drejtuese civile vijnë nga një karrierë që nuk ka lidhje me çështjet e sigurisë e të mbrojtjes. Ata mund të jenë ekspertë kompetentë në fusha të tjera, ndërsa në sektorët ku drejtojnë kanë mangësi. Gjithsesi, ndërsa mungesa e ekspertizës të niveleve të larta mund të kompensohet, mungesat e ekspertizës të stafit civil të administratës është e patolerueshme. Në shumicën e rasteve civilët e sektorëve të sigurisë dhe të mbrojtjes përzgjidhen me konkurrim sipas ligjit "Mbi statusin e nëpunësit civil" dhe pas miratimit ata gëzojnë statusin e nëpunësit civil.

Presupozohet se para punësimit ata testohen për nivelin e tyre të ekspertizës dhe për më tepër pas punësimit ndjekin seminare dhe kurse kualifikimi brenda dhe jashtë vendit. Si rezulton në ballafaqimet me raste konkrete, një pjesë e mirë e nëpunësve civilë në këto sektorë nuk rriten në karrierë, por vijnë dhe ikin bashkë me titullarët drejtues të institucioneve. Paneli sugjeron që një akt nënligjor mbi karrierën e civilëve në sektorët e sigurisë dhe të mbrojtjes do të ishte i domosdoshëm.

Niveli i ushtarakëve në zotërimin e ekspertizës ushtarake-profesionale nuk ishte objekt diskutimi i këtij paneli. Megjithatë,

ndërhyrja e autoriteteve civile të nivelit politik apo administrativ në ekspertizën ushtarake përbën problem. 48% e të anketuarve deklarojnë se kjo gjë ndodh shpesh. Kjo anomali dëshmon se nuk janë vetëm civilët që kapërcejnë “gardhin”, por janë edhe vetë ushtarakët të cilët nuk i dalin për zot përgjegjësive të tyre. Rastet si ai i Gërdecit tregojnë më së shumti se ushtarakët ose nuk i njohin fushat tyre të ekspertizës ose për më keq “dorëzohen” lehtë ndaj autoriteteve civile e politike. E drejta e tyre për të kundërshtuar urdhrat e paligjshme do të ndihmonte së tepërmi autoritetet civile dhe në të njëjtën kohë do të evitonte pasojat negative që vijnë në raste të veçanta. Në këtë kuadër vlen të përmendet nevoja evidente e krijimit me ligj dhe si praktikë funksionale e shoqatës profesionale të ushtarakëve në detyrë, ashtu si kundër edhe të gjithë ushtritë e tjera të vendeve europiane.

Është pozitiv dhe inkurajues fakti që të anketuarit kanë një mendim të qartë rreth pyetjes mbi rolin e nivelit të lartë civil në fushën e menaxhimit dhe reformimit të sistemit të mbrojtjes. Janë shumë pak ata që mendojnë se autoritetet civile vetëm mbikëqyrin reformat ose i përgatisin vetë ata planet afatgjata të reformave, duke iu lënë ushtarakëve vetëm përgjegjësinë e zbatimit. Shumica e shohin veprimtarinë civilo-ushtarake drejt e qartë duke pranuar supremacinë e kontrollit politik pa e ngatërruar këtë me ndarjen e përgjegjësive e pa veçuar bashkëpunimin e detyrueshëm. Paneli tërhoqi vëmendjen që nivelet e larta ushtarake, në ushtrim të kompetencave të tyre ligjore duhet më me iniciativë të nxjerrin aktet urdhëruese ose udhëzuese për çështjet tekniko-ushtarake dhe të mos “inkurajojnë” autoritetet civile që këto akte t’i nxjerrin ata. Autoritetet e larta civilo-ushtarake përveçse janë eprorë e vartës janë edhe bashkëpunëtorë me përgjegjësi të ndara, por edhe të përbashkëta.

Fryma e diskutimit dhe “oponencës kritike” duhet të jetë prezente sidomos në nxjerrjen e akteve të rëndësishme nënligjore ose të miratimit të programeve e planeve afatgjata të zhvillimit të forcave.

Me gjithë arritjet në fushën e marrëdhënieve civilo-ushtarake si një marrëdhënie institucionale e ligjore, paneli sugjeron se paketa ligjore sidomos tani pas pranimit në NATO nuk është ende e plotë. Legjislacioni që rregullon këto marrëdhënie duhet rishikuar dhe plotësuar jo vetëm

për të korrigjuar ndonjë pasaktësi, por mbi të gjitha për shkak të rritjes së nivelit të veprimtarive dhe cilësisë së tyre. Mendohet se autoritetet ushtarake duhet të kenë akses më të plotë dhe autoritet më të madh në çështje të tilla si vlerësimi i karrierës ushtarake, gradimet, prokurimet e materialeve ushtarake, vlerësimet operationale të kapaciteteve ushtarake etj.

Për shkak të natyrës së tyre specifike e të traditave të trashëguara, marrëdhëniet civilo-ushtarake kurrë nuk mund të jenë perfekte, e megjithatë ato janë një komponent shumë i qenësishëm si për vetë Forcat e Armatosura ashtu edhe për vetë shoqërinë. Këtë synim kishte edhe ky panel diskutimi, që pretendon se kontribuoi në të mirë të përmirësimit të gjendjes. Është e rëndësishme që gjetjet e anketimit të realizuar të diskutohen më në detaje qoftë nga Forcat e Armatosura, qoftë si Ministri e Mbrojtjes për të reflektuar në mënyrë më konkrete me qëllim shëndoshjen e raporteve dhe mirëfunksionimin e institucioneve. Ndoshta, edhe parlamenti mund të reflektoje më tej mbi këto raporte.

## **Kol. JERONIM BAZO**

### **KOMENT PËR PANELIN II: “CILI ËSHTË PËRGJEGJËSI PËR SIGURINË DHE FORCAT E ARMATOSURA: SFIDAT PËR ROLET DHE PËRGJEGJËSITË PËR MENAXHIMIN E SIGURISË DHE MBROJTJES” (KONTEKSTI I (JO)SUKSESEVE KONSTITUCIONALE, MËSIMET E NXJERRA DHE IDETË PËR SFIDAT E ARDHSHME)**

Fillimisht do falënderoja organizatorët, Institutin për Demokraci dhe Ndërmjetësim si dhe personalisht zotin Hroni që na mban të lidhur dhe në bashkëpunim duke përfaqësuar shumë mirë shoqërinë civile dhe OJQ me një komunitet akademik dhe ushtarak si ai i yni. Fillimisht do thosha që gjetjet e zotit Dyrmishi ishin shumë interesante por nuk e shikoj me vend që t'i komentoj direkt, mbase do të duhej të kalonte

pak kohë, dhe njëkohësisht t'i kishim edhe në formë të shtypur, do të ishte me interes. Po e rezervoj veten të mos i komentoj që tani. Por shoh me vend të disa komente të shkurtra dhe shqetësime nga komuniteti ushtarak në këtë tryezë që diskuton për probleme shumë të rëndësishme të marrëdhënieve civile-ushtarake, me impakt po ashtu të rëndësishëm për sigurinë kombëtare në përgjithësi, rajonale e ndërkombëtare. Të gjithë e dinë që çdo lloj shoqërie e sistemi politik vuan në njëfarë mënyre nga konfliktet dhe fërkimet mbi marrëdhëniet civile-ushtarake me përjashtim të diktaturave të mirëfillta ushtarake ku bën më sens, është *non-sequitur*, quhet në gjuhën filozofike ushtarake, dhe nuk përbën sens çështja e marrëdhënieve civile-ushtarake. Të gjithë sistemet e tjera vuajnë një lloj konflikti dhe hendeku, sikurse jemi dhe ne. Sërish i përgëzoj organizatorët që e çelin debatin për marrëdhëniet civile-ushtarake ose më mirë do thosha dhe kriza që ne kemi kaluar në dekadën e fundit është një lloj debati i munguar, e kemi anashkaluar. Madje dhe në botë u bënë gati 40 vjet, që nga koha e Huntigtonit, që nuk ka më pena të shquara që t'i adresohen çështjeve të marrëdhënieve civile-ushtarake. Gjithsesi, janë tre fushat ku vepron kontrolli demokratik ose mbikëqyrja civile-demokratike mbi Forcat e Armatosura. Dy të parat lidhen me çështjen se kush komandon, kush ka autoritetin dhe kush i përdoron, cila/cili është autoriteti që i përdoron Forcat e Armatosura. Këto dy të parat janë të zgjidhura pak a shumë, pra nuk përbëjnë më problem për shoqëritë e sotme, në shek. XXI ku jetojmë, sepse supermacia civile është e pranuar, e kapërcyer, aq më tepër në shoqërinë tonë. Po vijmë te fusha e tretë e ushtrimit të këtij autoriteti ku çështja bëhet e nxehtë dhe fillojnë fërkimet e pashmangshme, kur është fjala për politikën e mbrojtjes. Dhe kur themi politikën e mbrojtjes përfshijnë këtu të tre pushtetet që njohim; legjislativin që kemi sot në këtë seancë, ekzekutivin dhe gjyqësorin duke e lënë disi mënjanë pushtetin e pacertifikuar të medias që bën transparencën. Megjithatë kur flasim për politikën e mbrojtjes i përkthejmë në radhë të parë në Politikën e Buxhetimit (Fuqia e kuletës) që në fund të fundit është ajo që ushtron Komisioni Parlamentar dhe Pushteti Legjislativ nëpërmjet zotit Demi, që kemi sot këtu të pranishëm. Politikën e arsimimit, pensionimit, llojin dhe sasinë e armatimit; të gjitha këto janë pika ndarëse dhe nuk mund të

zgjidhen vetëm pa ekspertizën dhe zërin e fuqishëm të ekspertëve në uniformë. Dhe këtu fillojnë fërkimet, ku një nga këto fërkime të marrëdhënies civile-ushtarake u shfaq dhe mori kulminacionin edhe në kohën e tragjedisë së Gërdecit dhe pas saj. Kështu që është një rast i mirë që ne të thellohemi qoftë dhe duke shfrytëzuar gjetjet më vonë të sondazhit që ka bërë institucioni juaj. Gjithsesi, sikundër premtova dhe në fillim, janë dhe disa shqetësime që ne i ndiejmë në jetën e përditshme të komunitetit ushtarak dhe që lidhen dhe janë shprehje direkte të marrëdhënieve civile-ushtarake. Jemi në një fazë ku studiojmë në ambientet tona, para se të shkojë në nisma ligjvënëse për ligjin e ri të gradave, ligji i ri i autoriteteve, por mënyra sesi ne i diskutojmë është pak shqetësuese sërish sepse kemi bërë një qasje të njëanshme. Aktualisht diskutojmë për ligjin e gradave pa e parë atë në tërësinë e tij, si një paketë të plotë. Çfarë do të ndodhë, në qoftë se ne do të kemi fatin që ta kalojmë Ligjin e Gradave që po punojmë, ai dashje pa dashje do të devijojë nga fryma e përgjithshme ligjore kushtetuese dhe nuk do të jetë unisom me ligjet e tjera më kuadër siç është i Sigurimeve Shoqërore që prek ushtarakët, siç është Ligji i Autoritetit të Pushtetit, Struktura dhe Vizioni ku do të shkojnë Forcat e Armatosura aq më shumë që sot jemi pjesë e NATO-s. Ky është një nga shqetësimet që unë e shoh shumë evident. Nga ana tjetër diskutojmë për strukturën e re në Forcat e Armatosura që nuk është se lidhet drejtpërdrejtë me praninë e Komisionit Parlamentar të Mbrojtjes, por gjithsesi është një zë që duhet të përfshihet, sepse ndjek linjën e ekzekutivit deri te Komandanti i Përgjithshëm. Sërish prekim strukturën e Forcave të Armatosura me qëllimin e mirë për të bërë një balancë të drejtë midis forcë ofruesit (force provider) dhe forcë përdoruesit (force user), që kishin paksa defekte duke shkuar në ekstremet e të dy krahëve. Pra janë disa nga ato shqetësime që unë e shoh me vend t'i hapim, t'i diskutojmë, aq më tepër që shprehin në thelbin e tyre marrëdhëniet civile-ushtarake. Ashtu si shprehemi në Akademinë tonë (thembra e Akilit) është çështja e menaxhimit të personelit në Forcat e Armatosura. Një çështje tepër e ndjeshme dhe evidente, mjaft e prekshme çdo ditë. Ndodh që në mungesë të procedurave të sakta ligjore, akteve normative që rregullojnë menaxhimin e personelit ndodh që në vitin 2009, në shek. XXI përqendrimi i të tilla procedurave për emërimin qoftë edhe të një

nënoficeri, duhet të firmoset deri te ministri i Mbrojtjes. Për një dalje rutinë jashtë shtetit të një oficeri, nënoficeri ose punonjësi civil, firmos ministri i Mbrojtjes. Pra, këto janë probleme të rëndësishme dhe të mprehta që në fund të fundit shprehin krizën dhe problemet në marrëdhëniet civile-ushtarake. Po kaq e mprehtë është çështja e arsimimit ushtarak në Forcat e Armatosura, ajo që quhet PME - Professional Military Education - pjesë integrale e sistemit të menaxhimit të personelit, por sërish është një politikë afatgjate. Ndodhemi aktualisht në një ngërç të panevojshëm, kur arsimi ushtarak ndodhet jashtë Ligjit Kombëtar mbi Arsimin në Republikën e Shqipërisë. Kësisoj nuk jemi as pjesë, nuk jemi as jashtë, veprimë me ligjin e vjetër, çka ka gjetur një zbatim dhe ilustrim jo shumë fatlum në pezullimin që i kemi bërë arsimimit në fushën e para komisionimit të daljes së oficerëve të rinj, d.m.th ndodhemi në një fazë ku është pezulluar veprimtaria e Universitetit Ushtarak Skënderbej. Këto duken si çështje të ditës dhe rutinë, por kur vjen puna për arsimimin, çështja është e ndjeshme. Investimi pozitiv ose negativ vuhet ose i merren të mirat në një kohë afatgjate ku ne mbase nuk do jemi jo vetëm në shërbim, po mbase jo në këtë botë. Kështu që kjo e rrit përgjegjësinë. Pra, të gjitha këto janë tema të prekshme të marrëdhënieve civile-ushtarake, po unë do të përfitoja të theksoja edhe një element të fundit. Aktualisht dhe fatmirësisht Shqipëria është pjesë integrale e aleancës më të suksesshme që quhet NATO. NATO ka hyrë tashmë në një proces mjaft të rëndësishëm për të rishikuar, riformuluar e hartuar Konceptin e Ri Strategjik, që për nga rëndësia hierarkike e dokumenteve mund të zërë vendin e dytë, pas vetë Traktatit të Uashingtonit. Është pikërisht moment, për të qenë më aktivë, pasi është hera e parë që Shqipëria ndodhet në një pozitë kaq të favorshme strategjike qoftë në rajon, qoftë edhe në arenën ndërkombëtare. Është vendi ku bëhet ligji që do të ndikojë në një mënyrë ose tjetër edhe mbi Forcat e Armatosura. E gjej me vend që të hapet diskutimi, të hapet dialogu kombëtar, sepse bëhet fjalë për t'i dhënë konsensusin këtë radhë Konceptit të Ri Strategjik dhe rolin e pazëvendësueshëm dhe të padiskutueshëm të Komisionit Parlamentar për Mbrojtjen, sepse nga ky Koncept i Ri Strategjik do të dalin edhe disa urdhëresa, direktiva që do të na ndikojnë direkt në buxhetet e mbrojtjes, në përdorimin e forcave tona brenda dhe jashtë vendit, kudo ku ta kërkojë Aleanca. Kështu që është vendi që të ndihet fuqishëm edhe zëri ynë. Ju faleminderit shumë, dhe më falni për zgjatjen!